

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА



FAKULTETI I DREJTËSISË
FACULTY OF LAW
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ

STUDIMET PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

DREJTIMI PENAL

TEZA:

**“DHUNA NË FAMILJE NË LEGJISLACIONIN SLOVEN – ASPEKTE KRAHASIMORE
ME RMV”**

KANDIDAT:

Armende Amiti

MENTOR:

Doc. Dr. Vedije Ratkoceri

Tetovë, 2021

FALËNDERIM

Për orientim dhe mbështetje i falemenderohem mentores time Doc. Dr. Vedije Ratkoceri.

Falemenderim i veçantë i shkon edhe Biblotekës Universitare në Maribor veçanërisht z. Miloš Petrovičit për ndihmën e pakursyer dhe dhënien e materialit për bërjen e kësaj teme.

Gjithashtu dua të falenderoj familjen time dhe shoqërinë, e cila në kohën kur e kam shkruajtur temën më kanë qëndruar afër.

Falemenderimi më i madh i shkon babait tim, i cili çdoherë ka besuar tek unë, sidomos edhe atëherë kur unë kam »dyshuar«.

Faleminderit!

» Vështirësitë e jetës disa i lodhin të tjerët i forcojnë, por nuk ka asgjë në këtë botë, që të vras shpirtin e atij që ëndërron të arrij diçka në jetë«

Nelson Mandela

Përmbajtja

Abstrakt	6
Abstract.....	8
Hyrje.....	10
Kapitulli I - Vështrime të përgjithshme mbi dhunën në familje në R.e Sllovenisë	11
1. Historik i shkurtër rreth paraqitjes së dhunës në familje në R. e Sllovenisë.....	11
2. Kuptimi i përgjithshëm i dhunës në familje dhe format e manifestimit të saj.....	15
2.1 Dhuna psikologjike	16
2.2 Dhuna fizike	17
2.3 Dhuna seksuale	18
2.4 Dhuna ekonomike.....	20
2.5 Shpërfillja/ lënia pas dore.....	20
2.6 Ndjekja	20
Kapitulli II – Faktorët që ndikojnë në paraqitjen e dhunës në familje.....	23
1. Ndikimi i faktorëve ekonomik e social	23
1.1. Varfëria.....	23
1.2. Papunësia	24
1.3. Kultura dhe tradita	25
1.4. Ndikimi i alkoolit dhe substancave narkotike.....	26
2. Ndikimi i masmediave.....	27
3. Ndikimi i faktorëve të tjerë	28
Kapitulli III – Dhuna në familje në legjislacionin slloven – aspekte krahasimore me RMV.....	35
1. Kodi penal slloven dhe inkriminimi i dhunës në familje.....	35
2. Kodi penal i RMV dhe inkriminimi i dhunës në familje.....	38
3. Dhuna në familje në ligjet e posaçme	40
3.1 Ligji mbi familjen në RS	40
3.2 Ligji për parandalim dhe pengim të dhunës në familje në RS.....	41
3.3 Ligji për parandalimin dhe pengimin e dhunës në familje në RMV	45
3.4 Ligji i parandalimit dhe i mbrojtjes nga dhuna ndaj grave dhe dhunës në familje i RMV-së	46
4. Strategjitë nacionale dhe dhuna në familje.....	47
4.1 Rezoluta mbi programet nacionale për parandalimin e dhunës në familje në RS...47	

4.2 Strategjitë nacionale për luftimin dhe parandalimin e dhunës në familje në RMV.	50
5. Aktet nënligjore në Republikën e Sllovenisë.....	51
5.1 Rregullorja mbi bashkëpunimin e organeve dhe funksionimin e qendrës për punë sociale, ekipeve multidisiplinare dhe shërbime rajonale në trajtimin e dhunës në familje	52
5.2 Rregullorja mbi trajtimin e dhunës në familje në entet institucionale arsimore	
5.3 Rregullorja mbi bashkëpunimin e policisë me organet dhe organizatat e tjera të zbulimit dhe parandalimit të dhunës në familje.....	53
5.4 Rregullorja mbi rregullat dhe procedurat e trajtimit të dhunës në familje gjatë kryerjes së veprimeve mjekësore.....	55
Kapitulli i IV – Masat për parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje në RS – aspekte krahasimore me RMV	57
1. Roli i policisë në parandalimin e dhunës në familje.....	57
1.1 Roli i policisë sllovene në parandalimin e dhunës në familje.....	57
1.2 Roli i policisë së RMV në parandalimin e dhunës në familje.....	64
2. Roli i prokurorisë në parandalimin e dhunës në familje.....	68
2.1 Roli i prokurorisë sllovene në parandalimin e dhunës në familje	68
2.2 Roli i prokurorisë maqedonase në parandalimin e dhunës në familje.....	69
3. Roli i gjykatave në parandalimin e dhunës në familje.....	69
3.1 Roli i gjykatave sllovene në parandalimin e dhunës në familje.....	71
3.2 Roli i gjykatave maqedonase në parandalimin e dhunës në familje.....	77
4. Roli i organizatave joqeveritare në parandalimin e dhunës në familje.....	78
4.1 Roli i OJQ-ve sllovene në parandalimin e dhunës në familje.....	78
4.2 Roli i OJQ-ve maqedonase në parandalimin e dhunës në familje.....	86
5. Roli i qendrave për punë sociale në parandalimin e dhunës në familje.....	87
5.1 Qendrat për punë sociale në Slloveni.....	87
5.2 Qendrat për punë sociale dhe roli i tyre në RMV.....	95
Shtojcë: Intervistë.....	96
Përfundime dhe rekomandime	102
Literatura e shfrytëzuar.....	105

ABSTRAKT

Familja si qeliza bazë e shoqërisë, është e ekspozuar ndaj shumë faktorëve të vrullshëm ekonomik e social të cilët në një çfar mënyre ndikojnë edhe në shpërbërjen e saj . I gjithë zhvillimi i shoqërisë në familjen tradicionale ka lënë një mbresë të madhe. Ku nga familja me frymë patriarkale, që figura e mashkullit ka përfaqësuar kryesorin në familje është zhvilluar në një familje ku të drejtat në çift janë të barabarta. Kërkimet shkencore thonë që sëmundjet vdekjeprurëse si ajo e kancerit fillon kur në trup fillon e prishet struktura qelizore. Këtë mund ta themi se e njëjta gjë ndodh edhe në trupin e madh të shoqërisë njerëzore. Kur qeliza e saj siç është familja, fillon dhe e prish ADN-në, atëherë trupi i shoqërisë kërcënohet nga një kancer i frikshëm i cili me metastazat e tij herët apo vonë do ta vras të tërë njerëzimin.

Nga vetë mënyra se dhuna në familje ndodh brenda murreve të mbyllura të shtëpisë të shumëta janë rastet edhe pa u zbuluar nga ana e shtetit, kjo vjen si pasojë se viktimat nuk flasin për atë se çka përjetojnë dhe humbja e shpresave se në të vërtetë dikush do të ju del në ndihmë. Shpeshherë viktimat të kësaj dhune janë gratë dhe fëmijët në disa raste të caktuara janë prindërit, personat me aftësi të kufizuar si dhe një numër dukshëm i vogël janë edhe burrat.

Republika e Sllovenisë gjithashtu edhe Republika e Maqedonisë së Veriut janë të pajisura me ligje dhe mekanizma shtetërore në drejtim të parandalimit të dhunës në familje të dy shtetet në mënyra e veta kanë pranuar, ndryshuar dhe ratifikuar ligje dhe konventa të ndryshme ku flasin hapur për parandalimin e dhunës në familje tregojnë se cilat janë format, fazat dhe viktimat më të shpeshta, janë kushtuar shumë libra për planifikimin e parandalimit të këtij fenomeni, janë themeluar shumë organizata joqeveritare të cilat ju ndihmojnë si viktimave ashtu edhe kryesit të dhunës, bëhen trajnime profesionale për të punësuarit profesional, që merren me këtë fenomen, mbi të gjithë mundin që harxhohet nga organet shtetërore duke filluar nga policija, prokuroria, gjykata, qendra për punë sociale, përsëri jemi dëshmitarë të rasteve të shumëta të dhunës në familje apo rasteve të ndryshme në të dyja shtetit.

Pa marrë parasysh përpjekjeve që bëhen, gratë vazhdojnë të përballen me dhuna të ndryshme në familje ku ndikim të madh kanë qëndrimet tradicionale, zakonet patriarkale dhe

rolet historike gjinore. Shtetet janë të pajisura me ligje dhe mekanizma për çrrënjosjen e këtij fenomeni, por shpresat për gratë vazhdojnë të jenë të pakta si në kuptimin e përgjithshëm ashtu edhe krahasuar me burrat.

Ky punim i imi më tepër ofron informacione se si njëri shtet e zgjedh një çështje të caktuar si në teori po ashtu edhe në lidhje me zbatimin e ligjit në praktikë. Në bazë të zbatimit të ligjit në praktikë dhuna në familje është e dallueshme në Republikën e Sllovenisë mundësohen më shumë mundësi rehabilitimi apo trajnim më adekuat ndaj viktimave si pjesëtarë të familjes dhe dhunuesve, dhunuesit asnjëherë nuk i lihen fëmijët nën kujdesje, edhe pse janë një numër i vogël burrat si viktima të dhunës për ta egzistojnë strehimore, ndërkaq në Republikën e Maqedonisë së Veriut zbatimi i ligjit në praktikë është më ndryshe, por ka lëvizje në drejtim të rrugës së drejt.

Fjalë kyçe: legjislacioni slloven, legjislacioni i RMV-së, veprat penale, familja, dhuna në familje, gratë dhe fëmijët si viktima.

ABSTRACT

The family, as the basic cell of society, is exposed to many rapid economic and social factors which in some way affect its dissolution. The whole development of society in the traditional family has left a great impression. Where from the patriarchal spirit family, the male has represented the main figure in the family where couple rights are equal. Scientific research says that deadly diseases such as cancer start when the cell structure in the body begins to break down. We can say that the same thing happens in the great body of human society. When its cell likewise family, starts and breaks down the DNA, then the body of society is threatened by a terrible cancer which with its metastases sooner or later will kill the whole humanity.

From the very fact that domestic violence takes place inside the closed walls of the house, there are many cases even without being detected by the state, this comes as a result that the victims do not talk about what they are experiencing and the loss of hope that someone will actually helps them. Often victims of this violence are women and children in some cases are parents, people with disabilities and a significantly smaller number are also men.

The Republic of Slovenia as well as the Republic of Northern Macedonia are equipped with laws and state mechanisms for the prevention of domestic violence , both states in common forms, have changed and ratified laws and conventions which openly speak about the prevention of this phenomenon, the forms, phases and most common victims, many books have been dedicated for planning and preventing this phenomena, many non-governmental organizations have been established to help both victims and perpetrators of violence, professional training is provided for professional employees, who deal with this phenomenon, above all the efforts spent by state bodies starting from the police, prosecution, court, center for social work, over again we are witnessing numerous cases of domestic violence or different cases in both states.

Regardless of the efforts made, women continue to face a variety of domestic violence where traditional attitudes, patriarchal customs, and historical gender roles have a major impact.

States are equipped with laws and mechanisms to eradicate this phenomenon, but women continue to bein a lower level both in the general sense and compared to men.

This paper of mine provides information on how a state resolves a particular issue both in theory and in relation to law enforcement in practice. Based on the implementation of the law in practice, domestic violence is distinct in the Republic of Slovenia, which provides more opportunities or more appropriate treatment towards victims as family members and abusers. Children are never left under the care of the abusers, even though the number of abused men is small, ther are shelters, while in the Republic of Northern Macedonia law enforcement in practice is different, but there are moves in action towards the right direction.

Key words: domestic violence, violence against women, Slovenian legislation, criminal offences

HYRJE

Çdo hulumtim që bëhet ka për qëllim të vendos në pah disa çështje, që më parë nuk kanë qenë aq të qarta për opinionin e gjerë. Andaj hulumtimet e miya lidhur me këtë punim shkencor do të përfshijnë një horizont bukur të gjerë drejtë shkaqëve që ndikojnë në ***Dhunën në familje***, përfshirë legjislacionin slloven. Qëllimet e përgjithshme apo gjenerale të këtij punimi shkencor të masterit me titull; ***Dhuna në familje në legjislacionin slloven – aspekte krahasimore me RMV***, ka për qëllim që të hulumtojë dhunën në familje në legjislacionin slloven dhe krahasimin me legjislacionin në Republikën e Maqedonisë së Veriut se si zgjidhet një rast dhune në Republikën e Sllovenisë dhe si në Republikën e Maqedonisë së Veriut, çfarë masash përdoren për parandalimin e këtij fenomeni dhe roli i të gjitha organeve dhe organizatave joqeveritare. Për të aritur qëllimin e realizimit të këtij punimi, punimin e kamë ndarë në katër kapitull, të cilët janë të harmonizuar më njëri tjetrin.

Në kapitullin e parë do të flitet më shumë për familjen në përgjithësi, krizat në të dhe familja si vlerë. Në kapitullin e dytë më tepër do të përqendrohemi për dhunën brenda katër mureve, llojet e dhunës, viktimat, kush janë dhunuesit dhe shkaqet që e shkaktojnë dhunën. Në kapitullin e tretë do të flasim për teoritë mbi dhunën në familje, për bartjen e dhunës nga gjenerata në gjeneratë, për inkriminimet e reja të dhunës në familje, Veprat penale të dhunës sipas nenit 299 të Kodit penal si dhe kundërvajtjet me elemente dhune në familje. Ndërsa në kapitullin e katërt rëndësi do të kushtohet ndërhyrjeve në rastet e dhunës në familje, sidomos organet qeveritare e jo qeveritare në luftim me parandalimin e dhunës në familje siç janë: Policia, Qendra për punë sociale, Shoqatat joqeveritare dhe Strehimoret.

Shpresoj që ky punim sa do pak të shërbej për të kuptuar më mirë dhe më drejtë fenomenin e dhunës në familje, edhe pse ky fenomen dita ditës vjen e shtohet.

Prandaj, ky punim shkencor i masterit do të ketë pikërisht qëllimin kryesor se cilat janë faktorët që ndikojnë në dhunën në familje, dhe cilat do të jenë hapat drejtë një zgjedhje më të mirë të çdo mosmarveshje familjare, apo drejtë një parandalimi të këtij fenomeni kaq kompleks dhe kaq i vjetër.

KAPITULLI I PARË

VËSHTRIME TË PËRGJITHSHME MBI DHUNËN NË FAMILJE NË REPUBLIKËN E SLLOVENISË

1. Historik i shkurtër rreth paraqitjes së dhunës në familje në Republikën e Sllovenisë

Dhuna në familje është një fenomen i vjetër, kjo lloj dhune ka egzistuar qysh prej kur ka egzistuar i vetë njerëzimi dhe ky fenomen është prezent edhe tani, mirpo në kohët e më hershme është marr si diçka normale, gjegjësisht asnjëherë nuk është kuptuar si lloj dhune.

Dhuna në familje është një problem i përhapur në shoqërinë bashkëkohore, ku kalon kufijtë e një shteti dhe ndodh në të gjitha shtetet dhe kulturat e mbarë shoqërisë njerëzore.

Ashtu si në gjithë botën edhe në Republikën e Sllovenisë dhuna në familje është konsideruar si çështje private familjare dhe si pjesë normale e jetës bashkëshortore dhe familjare, ku viktimat kanë vuajtur në heshtje, sepse e gjithë dhuna ka ndodhur në mes të katër mureve dhe pas dyerve të mbyllura.

Si viktima të dhunës në familje mund të jenë të gjithë antarët e familjes, por më tepër ky fenomen i dëmton gratë, fëmijët, njerëzit me të meta të ndryshme dhe të moshuarit. Karakteristikë e dhunës në familje është, se ajo përsëritet dhe ndodh shpeshherë, vetëm mënyrat e shfaqjes së saj ndryshojnë. Të gjitha këto i kuptojmë nga deklaratimet dhe përjetimet e viktimave të cilët tregojnë se përjetojnë forma të ndryshme të dhunës, sepse partnerët e tyre përdorin një sërë taktikash të ndryshme në përpjekje për të ushtruar pushtet dhe kontroll mbi ta dhe njëkohësisht dhuna fizike nuk ka ndodh nga një shpërthim i vetëm, por si rregull dhuna fizike ka qenë gjithmonë e shoqëruar me dhunën psikike dhe gradualisht është shkallëzuar dhe ka përfunduar me dhunën fizike. Dhe këtu vijmë me një konstatim, se familja për gratë në rastet e tilla konsiderohet, si vendi më i rrezikshëm, ndërsa partneri bashkëshorti, si personi më i rrezikshëm. Për atë se dhunuesi dhe viktimat janë në lidhje të ngushtë, mund të jenë burri dhe gruaja d.m.th janë edhe partner intim dhe është e vështirë dhuna në mes tyre të ndalohet, sepse duke u nisë nga burrat, një burrë i dhunshën nuk është se mund të vijë nga një grup specifik shoqërorë, dhe e kemi më të lehtë ta dallojmë, por këta dhunues mund

të jenë shumë të shkolluar dhe mund të kenë më tepër se shkollimin e mesëm, ka raste ku kemi të bëjmë edhe me magjistra e doktora shkence, d.m.th është problem universal dhe është i pranishëm gjithëkund mes nesh dhe e hasim te të gjitha shtresat shoqërore: paraqitet te të pasurit, te të varfurit, te të shkolluarit, te të pa shkolluarit, si dhe te njerëzit e shumë respektuar gjithashtu edhe te të marginalizuarit nga shoqëria.

Dhuna në familje shpeshherë tregon faza të ndryshme. E ceka më lartë se dhuna në familje nuk është një ndodhi e cila ka ndodhur një herë dhe ka mbaruar, zakonisht përsëritet në mënyrë ciklike. Dhuna ka periudha qetësimi, ku te kjo fazë vjen në rritje të tensionit dhe pastaj shpërthen dhuna. Fillon me forma të lehta dhe me kalimin e kohës vjen e shkallëzohet dhe bëhet më intenzive dhe më brutale. Dhe periudhat e qetësisë vijnë e shkurtohen, ndërsa shpërthimet e dhunës bëhen më të shpeshta.

Sigurisht që shteti ka për detyrë, që të bëjë më të mirën, që dhunën në familje ta ndalojë, gjegjësisht të ndalojë vazhdimësinë e saj, por në jetën praktike nuk ekzistojnë mekanizma apo ndonjë formulë, që t'a përdorim për parandalimin e dhunës para se të ndodh ajo. Edhe shteti do të ishte më efikas, që atëherë kur ndodh dhuna të jemi në fazat e fillimit, edhe viktimat është më e përgatitur të marr hapa vendimtarë për tu larguar nga rrethi i dhunës, por kur vjen e zgjatet kjo gjendje viktimat çoroditet, dhuna e vazhduar le pasojat në shëndetin mendor e fizik, viktimat humb vetëbesimin dhe e ka të shkatërruar vetëvlerësimin, e sidomos rrethanat në të cilat ndodhet ajo e bëjnë që e gjithë situata t'i duket pa zgjidhje, në rastet më ekstreme mund të vritet nga dhunuesi apo edhe te e keqja tjetër viktimat shtyhen drejtë vetëvrasjes. Dhe këtu duhet që qëndrimi i shtetit të jetë shumë më i vendosur, që do të thotë, shteti të bëjë një ndërhyrje serioze në familje.

Regullimi normativ i dhunës në familje në Slloveni nuk është se ka një traditë të pasur. Suksesi më të madh Sllovenia e ka arritur në vitin 2008, kur ka miratuar Ligjin mbi parandalimin e dhunës në familje (ZPND).¹ Ky ligj për herë të parë në nivelin legjislativ e përcaktoi dhunën në familje, caktoi qëllimin e miratimit të këtij ligji që dhunën në familje ta parandalojë dhe reduktojë në të gjitha format e saj, caktoi marrdhëniet mes dhunuesit dhe viktimës, u caktoi detyra dhe role organeve shtetërore, Qendrës për punë sociale, Policisë, Gjykatave, Prokurorive dhe Organeve joqeveritare mbi shqyrtimin e dhunës në familje në

¹ Zakon o prprečevanju nasilja v družini – ZPND (urani list RS, št. 16/08 z dne 15. 2. 2008)

shoqërinë sllovene, ndërsa viktimës së dhunës në familje, përpos mbrojtjes i ka ofruar edhe ndihmën juridike pa pagesë, trajnimin e punëtorëve profesional si dhe ruajtjen e të dhënave personale të cilat grumbullohen rreth dhunës në familje.

Në bazë të Ligjit mbi parandalimin e dhunës në familje u miratuan edhe katër akte nënligjore të cilat kanë përcaktuar procedurat e shërbimeve profesionale të posaçme si dhe procedurat e bashkëpunimit mes tyre dhe funksionimi i ekipeve multidisiplinare, si bashkëpunimi policor me institucionet tjera.

Kuvendi i Republikës së Sllovenisë në vitin 2009 ka miratuar edhe Rezolutën mbi programet nacionale të parandalimit dhe zvogëlimin të dhunës në familje, e cila ka zgjatur deri më vitin 2014, ku si qëllim kryesorë kjo rezolutë ka vendosjen e qëllimeve, masave dhe varësive kryesorë të politikave për parandalimin dhe zvogëlimin e dhunës në familje. Pas këtij dokumenti janë miratuar edhe katër aktet nënligjore, që në pjesën operative përcaktojnë lidhjen dhe bashkëpunimin e organeve të ndryshme në lidhje me shqyrtimin e çështjeve të dhunës që do të shkruajmë në vijim.

Para miratimit të Ligjit mbi parandalimin e dhunës në familje legjislacioni slloven dhunën në familje nuk e ka njohur si ndonjë kategori e posaçme, por vetëm në rastet kur veprat e dhunës kanë qenë të asaj natyre që dukshëm është bërë fjalë për vepër penale ose po, policia ka ndërhyrë kur kanë prishur rendin dhe qetësinë publike ose po, atëherë kur ka ndodhur ndonjë kundërvajtje. Në vitin 2008 u miratua edhe Ligji penal (KZ-1)² i cili dhunën në familje e përcakton si vepër penale., në vitin 2013 u miratua Ligji mbi detyrat dhe kompetencat e policisë i cili plotësoi kompetencat e policisë që në rastet e shpalljes së urdhërit të bëjë ndalimin nëse ekziston mundësia e mosrespektimit të urdhrit të caktuar.³

Sllovenia me 1 shkurt të vitit 2016 paraqet tekstin për diskutim në seancë për ndryshimin e Ligjit mbi dhunën në familje. Ky ndryshim sjell shumë ndryshime të mëdha sepse gati ndryshon mbi gjysmën e neneve të ligjit aktual në fuqi LPDHN. Pas miratimit të LPDHN (ZPND) Sllovenia ratifikoi dy konventa të rëndësishme të Këshillit të Europës edhe atë: Konventa për mbrojtjen e fëmijëve kundër eksploatimit seksual dhe abuzimit seksual (Konventa Lanzarote) dhe

² Kazenski zakonik KZ-1 (Uradni list RS.nr. 003-02-4/2008-22 Ljubljana, dne 28. maja 2008)

³Zakon o nalogah in pooblastil policije - ZNPPol (Uradni list RS. Nr. 15/13 me datë 18. 2. 2013)

Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit).⁴

Dhunën e gjejmë kudo ... Diagnoza e ushtruesve të dhunës në familje është çrregullim personal, që tregon agresivitetin dhe refuzimin apo mospërfilljen e normave shoqërore. Të shumtët dhunën e lidhin me:

- Faktorët biologjik
- Predispozita gjenetike
- Ndërtimin truporë

Pastaj se sa të dhunshëm mund të jemi rol të madh luan personaliteti ynë, ku ndikojnë: kultura, vendi ku ritemi, edukata familjare, papunësia, shkollimi, mediat e shumë faktorë të tjerë.

Dhuna paraqitet kudo, sepse ne njerëzit jemi pjesë e grupit të vogël dhe të gjërë të bashkësisë, në të cilën ekzistojnë pak a shumë rregulla të definuara se cila është ajo sjellje që është e lejuar dhe cila jo. Ashtu siç ndryshon shoqëria dhe mënyra e jetesës, ndryshojnë edhe rregullat e jetës bashkëkohore. Kur në familje është e pranishme dhuna, viktimës i ulet ndjesia e sigurisë dhe kualiteti i jetesës dhe ndjehet e shkatërruar në të gjitha sferat e jetës.⁵

Shenjat të cilat janë më të shpeshta, që tregojnë se në një mardhënie familjare ka dhunë mund të konkludojmë nga sjellja e viktimës ndaj autorit të dhunës, nëse ajo shfaq frigë dhe vazhdimisht duhet të kujdeset se si do të veprojë, si do të silllet apo si do të flas, që t'i ik situatës shpërthyesë të partnerit. Shumë e kujdesshme tregohet në lidhje me disponimin e vet dhe veprimet e veta me një fjalë i përshtat reagimeve të tij. Dhunuesi viktimën e nënçmon, vështron dhe e fyen, prandaj viktima ndjehet e frikësuar, pashpresë dhe e pafuqishme. Siç e thash edhe më lartë fazat e dhunës janë 3 dhe në të shumtën e rasteve rrjedhin në këtë mënyrë.⁶

⁴ (Zakon o ratifikaciji Konvencije Sveta Evrope o preprečevanju nasilja nad ženskami in nasilja v družini ter o boju proti njima MKPNZND) pranuar me 19. 12. 2014, shpallja me 5. 1. 2015, hyrja ne fuqi 20. 1. 201

⁵ Veç o tem na spletni strani Društva za nenasilno komunikacijo <http://www.drustvo-dnk.si>)

⁶ Doracaku Nasilje nad ženskami Pravne poti v varno življenje žensk in otrok Društva za nenasilno komunikacijo <http://www.drustvo-dnk.si/>

2. Kuptimi i përgjithshëm i dhunës në familje dhe format e manifestimit të saj

Dhuna në familje zhvillohet shpeshherë mes katër mureve e cila mund të zgjas edhe me vite. Dhuna ndodh për shkak të jetës dinamike, njerëzit nuk kanë kohë për njëri tjetrin, bëhen më të neveritshëm dhe mundohen që gjithë mullëfin dhe hidhërimin ta zbrazin te tjetri. Rol të madh luan edhe gjendja sociale e pa përshtatshme, mosmarrveshjet e ndryshme të cilat shpien deri te mosmenaxhimi i kontrollit të vetëvetes.

Dhuna ka shumë fytyra dhe më shpesh ndodh në shtëpi, ku shtëpia njihet si strehimi më i sigurtë për të gjithë anëtarët e familjes, por për fat të keq nuk është gjithmonë ashtu. Ndër viktimat më të shpeshta të dhunës në familje janë shumica gratë, por jo gjithmonë bëjnë denoncimin. Shkaqet mund të jenë të ndryshme, por arsyetim për sjellje të dhunshme nuk ka. Viktima le të mundohet t'i përshtatet autorit të dhunës deri në pafundësi bile edhe sa të dojë, por dhunën për fat të keq nuk do të mund ta mposht, sepse shkak i dhunës nuk qëndron te viktimat, por tek ushtruesi i dhunës. Dhe gjëja më e keqe, që do të ndodh në procesin e dhunës është ajo, se viktimat dalë-ngadalë do ta humb veten.

Ushtruesi i dhunës nuk është i dhunshëm për faktin se ti e ke provokuar, apo se ka pasur një ditë të lodhshme, ose se është i stresuar, apo se është me nerva, ose se i ka rra terri syve, ose është nën ndikimin e alkoolit, apo se e kanë shpifur të tjerët e kështu me rradhë. I dhunshëm është sepse, ai është i bindur se dhuna është në rregull, dhe se ka të drejtë, që duke përdorur dhunë më lehtë do të i'arrijnë qëllimet, gjegjësisht me dhunë dëshiron që të dënojë atë, që i rrezikon dëshirat e tij. Dihet se sa më shumë, që të ju keqtrajtojë, aq më shumë mendon për veten dhe për asnjë tjetër. Prandaj, duhet të ju themi "Ndal arsyjes", që vazhdimisht gratë e thonë, se nuk dua të prishi familjen, apo nuk ndahem se nuk dua që fëmijët të rriten pa babain afër.⁷

Fëmijët, që rriten dhe jetojnë në një familje më frymë dhune mund, që për shkak të këtij shembulli të sjelljes dhe atmosferës së dhunshme nga prindërit e vet në të ardhmen të gjenden në rolin e viktimës apo të ushtruesit të dhunës, d.m.th dhunuesit nuk bëjnë asgjë tjetër veç se i prezantojnë ndikimet e veta brenda familjes te trashëgimtarët.

⁷ Lundy Bancroft Zakaj to počne (Kaj se dogaja v glavah jeznih in nadzirajočih moških 2002)

Format më të shpeshta të dhunës në familje në legjislacionin slloven janë: Dhuna psikologjike, dhuna fizike, dhuna seksuale, dhuna ekonomike, lënija pas dore dhe ndjekja si forma më të reja të dhunës që i njeh legjislacioni slloven.

Forma më e shpeshtë e dhunës në familje është dhuna psikologjike, e cila është edhe më e fshehura, dhe më e rënda për tu dëshmuar dhe në të shumtën e herave dhe e pa evituar si lloj dhune.

2.1 Dhuna psikologjike

Dhuna psikologjike përfshin sulme verbale, si bërtitje, këllitje, shkakim të frikës nëpërmjet trembjes, kërcënim për braktisje, nëse çifti ka fëmijë shpesh bëhen kërcënime lidhur me marrjen e kujdestarisë për fëmijët, kërcënim për dëmtim të vetes, fëmijës apo familjareve të partneres, fyerje (etiketime), izolim nga shoqëria, izolim të dhunëshëm nga familja, miqtë, shkolla, puna. Frikësim, kanosje për dhunë dhe për marrje të fëmijëve janë taktika mjaft të përhapura të përdorura nga dhunuesit, si dhe dëmtimi i sendeve që posedon viktima.

Kjo lloj dhune është më e fshehura dhe më pak e studiuar, madje është një ndër llojet e dhunës më e përhapur dhe njëherit edhe më e vështirë që të definohet. *Desha të ndalem këtu pak të tregoj arsytet se pse kjo lloj dhunë vështirë definohet sipas mendimit tim: fakti qëndron, se si viktima të këtij lloji të dhunës në rrjedhjen e jetës jemi të gjithë, dhe pa dashur gjithashtu, me kalimin e kohës të gjithë e shkaktojmë. Çdo fjalë e pamatur mirë ku e lëndon bashkëbiseduesin tonë, mund të jetë formë e dhunës psikike. Ku si pasojë ka zvogëlimin e vetëbesimit dhe vetëvlerësimin e viktimës.*

Dhuna psikologjike nga të gjithë kuptohet ndryshe dhe për këtë shkak është e rëndë për t'u provuar. Më tepër bëhet fjalë për dëshirën, për dominim në shtëpi, ku jeta duhet të rrotullohet vetëm rreth një personi të caktuar në shtëpi dhe sipas rregullave të tij. Megjithatë nëse mënyra e sjelljes së një partneri “ i cili di, që të luaj mirë dhe fajin t’ja hedh tjetërit kur fjalët din t’i formulojë duke u arsyetuar se nëse diçka, që e ka thënë apo e ka bërë, e ka bërë për shaka ose ishte batutë, dhe mohimet që vijnë nga thënija se t’i më njeh mua unë kështu jam” gjithmonë i’a arrin qëllimit në kuriz të partnerit tjetër për dëshirat, të drejtat dhe

urdhërat e tij, të gjitha këto i përsërit në mënyrë të vazhdueshme mund të themi se kemi të bëjmë me dhunë psikologjike.

Psikologjikisht të dhunshëm mund të jemi me fjalë, me sjellje apo edhe me heshtje. Heshtja është arma më e fortë të dhuna psikologjike, kur njëri nga partnerët me heshtje e dënon partnerin tjetër, dhe me këtë i'a bën me dije se nuk është i/e vlefshme për vëmendjen e tij/saj.

Dhuna psikologjike përfshinë:

- kërcënimin me rrahje;
- përqeshje duke e shiquar në pamje të jashtme viktimën;
- përqeshje lidhur me zakonet e saja, nivelin e ulët të intelegjencës, shoqërisë apo të familjareve të saj, ose edhe të bindjeve fetare të saja;
- izolimi nga shoqëria apo familja;
- kërcënimi i partnerit që do të marr fëmijët;
- ndalimin e posedimit të sendeve që për viktimën paraqesin rëndësi të veçantë;
- shkatërrimin e sendeve që për viktimën kanë rëndësi të veçantë;
- privimi nga paratë;
- kërcënimet nga partneri se do ta dëboj viktimën nga shtëpia;
- kërcënimet nga ana e partnerit se do t'a dërgojnë viktimën në qendrën psikiatrike për rehabilitim;

2.2 Dhuna fizike

Dhuna fizike është përdorimi i çdo force fizike, e cila e lëndon dikë, që fillon nga shuplaka, grushti, tërheqja për flokësh, shkelmime, shtyerje, kafshime, djegje, sulme me armë, rrahja me sende të ndryshme, gjuajtje drejt tjetrit me sende që mund t'i kesh afër, sulmi me thikë, kapja për fyti, dhe vrasja. Çdo dhunë fizike mund të konsistojë në një incident të vetëm ose mund të ndodh në mënyrë të përsëritur, pa dyshim është njëkohësisht edhe dhunë

psikologjike, kufiri mes tyre është aty ku dhuna me fjalë mbaron dhe i bashkëngjitet goditja⁸. Qëllimi i dhunës fizike është që dhunuesi të rris, të përfitoj dhe të dëshmoj forcën e vet mbi viktimën. Në krahasim me dhunën psikologjike këtë lloj dhune më lehtë mund të dëshmohet sepse shenjat nga kjo dhunë janë të dukshme.

Lëndimet fizike janë:

- buzët e çara;
- sytë e nxirë;
- enjtje në fytyrë, qafë e duar;
- kyçe dore të përdredhura

Kjo lloj dhune te partnerët paraqitet në momentet kur partneri i dhunshëm është i sigurtë se viktima nuk do të largohet prej tij, sidomos këto sjellje ndodhin pas martesës, gjatë shtatzënisë, pas lindjes së fëmijut të parë, apo kur partneri e humb punën dhe financiarisht është i varur nga partneri tjetër. Në këtë lloj dhune në të shumtën e rasteve viktimat e dhunës në familje shpesh lëndimet i mbulojnë apo e fshehin me grim dhe nuk kanë një shpjegime real dhe nënvlerësojnë seriozitetin e tyre⁹.

2.3 Dhuna seksuale

Kjo lloj dhune përfshijnë të gjitha format e agresionit seksual, përdhunimin, sulmi seksual, ngacmimin seksual, shfrytëzimin seksual apo aktin seksual ku viktima është e detyruar ta kryej pa dëshirën e vet. Të detyrosh dikë, që të bëjë aktin seksual pa pasur dëshirë, të jetë akti i pasigurt ose degradues, ose përdorimi i taktikave poshtëruese ose të tjera për të ulur, turpëruar, kontrolluar ose kufizuar seksualitetin e personave përbën abuzim seksual¹⁰. Qëllimi i dhunës seksuale nuk është akti seksual dhe arritja e orgazmës, por dëshira e dëshmisë së forcës dhe kontrollit ndaj viktimës. Përdhunuesit në të shumtën e rasteve nuk janë, se kanë dëshirë për aktin seksual, por dëshira më e madhe e tyre është, që viktimën ta poshtrojnë, ta

⁸ Raportimi për dhunën në familje, 2018 – udhëzues për gazetarë, OSBE - <https://www.osce.org/files/f/documents/1/7/404351.pdf>

⁹ Po aty.

¹⁰ <http://njohligjin.al/familja/dhuna-ne-familje/>

turpërojnë dhe t'a vënë në pozitë të keqe dhe të ulët të nënshtrimit. Si viktimat të kësaj lloji dhune mund të jenë gratë, vajzat, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara etj. Nga statistikat e bëra tregojnë se shumica e autorëve të kësaj lloji dhune janë meshkujt edhe atë, personat e njohur. Para shumë kohësh ka vlejtur thënia se burri nuk mund ta përdhunojë gruan e vet, dhe grave të përdhunuara burrat e vëtë i'u kanë konfirmuar se, askush nuk do të besojë, dhe le të pajtohen me përdhunimin, ku ky pohim viktimës i shkakton dëm ende më të madh.¹¹

” Në qoftë se të përdhunon një i panjohur, mund të jetosh me kujtime të tmerrshme. Por nëse të përdhunon burri, duhet të jetosh me përdhunuesin tënd.”¹²

Nga e gjithë kjo mund të konkludojmë se një kujtim mund ta urresh, por nuk mund ta fshish lehtë nga mendja se nuk ka ndodhur.

Në Kodin Penal të Republikës së Sllovenisë në nenin 170 në paragrafin e parë është definuar se” kush e detyron tjetrin nga gjinia e kundërt apo e njejtë në aktin seksual duke e përdorur forcën apo e sulmon drejtpërsëdrejti jetën dhe trupin e tij dënohet me burgim nga një deri në dhjetë vjet ¹³ .

Dhuna seksuale përfshinë:

- ngacmimin seksual;
- e folura me epshngjellës;
- shiqime komente dhe biseda jo të përshtatshme;
- prekje jo të zakonshme;
- incestet ose marrëdhëniet seksuale farefisnore;
- përdhunimi.

Shiquar në të, se në temën përqendrohemi në veprat penale në dhunën në familje, që është e inkriminuar në nenin 191 të Kodit penal (KZ-1), vlen të theksohet se dhuna seksuale nuk është element i kësaj vepre penale, mirpo sipas peshës është e inkriminuar në kapitullin e posaçëm të veprave penale kundër paprekshmërisë seksuale.

¹¹ (Tomas P. Carney, Spolno nasilje T.P Carney založba Amalieti 2010

¹² Filipič Katja, Zakon o preprečevanju nasilja v družini 2008

¹³ Kazenski zakonik, KZ-1 člen 170 Urani list RS, št.91/20 z dne 26. 6. 2020)

2.4 Dhuna ekonomike

Dhuna ekonomike ose financiare përfshin kontrollimin, kufizimin apo përjashtimin e partnerit, që të merret me të ardhurat e familjes. Marrja e pagës, apo mosdhënia e parave, që janë të nevojshme për të blerë ushqim apo trajtim mjekësor, ose pengimi i partnerit që të punësohet është gjithashtu forma e dhunës ekonomike. Kjo lloj dhunë është shumë e përhapur sepse dhunuesi në këtë mënyrë viktimën e mban nën kontroll dhe të pakta janë mundësitë, që viktimat në të ardhmen të vetëdijësohet apo të largohet nga dhunuesi.

2.5 Shpërfillja/lënja pas dore

Ligji mbi parandalimin e dhunës në familje parasheh edhe shpërfilljen si lloj dhune, që do të thotë se lënje pas dore kemi atëherë, kur personi në fjalë le pas dore detyrimin që ka ndaj një personi të caktuar të familjes i cili ka nevojë për të, për shkak të sëmundjes, gjendjes nëse është invalid, moshës, zhvillimit apo të rrethanave të tjera. Ngjarjet më të shpeshta në këtë rast janë personat, që janë të lindur me të meta mendore apo të moshuarit. Detyrimet, që shprehin këtë lloj dhune mund të jenë, nëse viktimës nuk i ofrojmë ushqim, nuk i'a mundësojmë përdorimin e barnave, veshjes etj.

Veprat që përfshijnë në lënjen pas dore ka shumë, por më të shpeshta janë:

- mospregatitja apo mos aftësia për të siguruar kushtet elementare për jetesë;
- mungesa e kujdesit dhe sjellja mizore;
- mungesa e kontrollit dhe e mbrojtjes;
- mospërbushja e detyrimit shkelja dhe kufizimi i të drejtave.

2.5 Zënija e pritës/ndjekja

Ndjekja është e caktuar si veprës penale në nenin 134a. të Kodit Penal -1 edhe atë definohet se kush e ndjek në mënyrë të përsëritur me qëllim të bezdisjes apo të shkaktoj frigë

te tjetri apo kundrejt ndonjë antari tjetër të familjes dënohet me dënimin me para ose me dënim deri në dy vjet. Nëse ndjekja bëhet kundrejt personit të mitur kryesi dënohet me dënim me para apo me dënim me burgim deri në tre vite.¹⁴

Në pikën tetë të nenit tre të Ligjit mbi parandalimin e dhunës në familje ndjekja definohet : “Ndjekja është një veprim i qëllimshëm i padëshiruar dhe i përsëritur ndaj viktimës ndjekja fizike, vëzhgimi, qëndrimi apo afrimi në vendet ku lëviz viktimja, ose formë tjetër e ndërhyrjes në mënyrë të padëshiruar në jetën të viktimës.¹⁵

Shpeshherë ndjekja kombinohet me dhunën psikike, fizike dhe seksuale të cilat duhet të kemi kujdes dhe situata të merret me serioziteti të madh.

Veprat që përfshihen te ndjekja janë:

- kur dhunuesi qëndron përpara banesës së viktimës;
- kur dhunuesi i drejtohet me fjalë viktimës;
- ngjekja nëpër rrjetet sociale;
- ndjekja ose ecja shumë afër viktimës;
- porositja e ushqimit në banesën e viktimës pa dijeninë e saj;
- revokim i kartelës bankare në emër të viktimës.

Të gjitha këto dhuna që i përmendëm kanë këto faza të manifestimit.

Faza e parë: Ritje e tensionit, ku autori i dhunës gjithënjë e më shumë fryhet nga situatat e ndryshme të jetës. Viktimja për atë shkak bëhet më e kujdesshme dhe më tepër i përshtatet bën gjithçka që të tejkaloj shkakun e shpërthimit, por asgjë nuk ndihmon, kushedi çka të bën nuk i ik dot dhunës së tij.


Faza e dytë: Faza e ndodhisë së dhunës, mund të ndodh në çdo lloj forme, që do të thotë, se viktimja dhunën nuk mund ta parasheh se çka do të bën dhunuesi. Dhuna nuk është pasojë e sjelljes së viktimës ashtu siç justifikohet autori i dhunës çdoherë.

¹⁴ Kazenski zakonik (Uradni list RS, št. 50/12 – uradno prečiščeno besedilo, 6/16 – popr., 54/15, 38/16, 27/17, 23/20, 91/20 in 95/21)

¹⁵ Zakona o prprečevanju nasilja v družini – ZPND (Urani list RS, št.68/16 z dnem 4. 11. 2016)

Faza e tretë: Kjo fazë është karakteristike, sepse të le përshtypjen e qetësisimit (në literaturë sllovene e hasi shpesh medeni tedni/muaji i mjaltit). Në këtë fazë dhunuesi mundohet që në çdo mënyrë të zvogëloj kuptimin e dhunës, ose po të gjithë fajin ta kalojë te viktimja. Dhe me këmbëngulje të madhe mundohet ta bind viktimën, se dhuna nuk do të përsëritet më, i kërkon falje, merr përsipër disa detyra familjare, apo ndoshta edhe në rastet ekstreme viktimës i blen edhe dhurata që sa ma shpejtë ta kthej për vete. Dhe kjo sjellje e rëndon edhe më tepër viktimën që të ndërmar hapat e rëndësishme për jetë një ndër to siç është largimi nga dhunuesi.¹⁶

- I gjithë ky rreth i dhunës ndodh brenda ditës, javës apo brenda muajit. Disa nga viktimat përjetojnë dhunë të vazhdueshme edhe pa fazën e qetësisimit.



Diagrami 1. Rrethi i dhunës (Marrë nga doracaku Obran Nina, Nasilje nad ženskami – prav(n)e poti v varno življenje žensk in otrok 2018 DNK)

¹⁶ Doracaku nga Obran Nina, Nasilje nad ženskami – prav(n)e poti v varno življenje žensk in otrok, Ljubljana 2018 DNK.

KAPITULLI I DYTË

FAKTORËT QË NDIKOJNË NË PARAQITJEN E DHUNËS NË SLOVENI

Mbi dhunën në familje është e vështirë të përcaktohen të gjithë faktorët që ndikojnë në dhunën në familje sepse janë të ndryshëm në të shumtën e rasteve ndikon dinamika dhe struktura e familjes, mënyra e zgjedhjes së konflikteve, mungesa e burimeve ekonomike, gjendja emocionale e agresorit dhe shumë faktorë të tjerë, por unë më shumë jam përqendruar në ndikimin e aktorëve ekonomik e social si janë: varfëria, papunësia, kultura dhe tradita, ndikimi i alkoolit dhe i substancave narkotike, ndikimi i masmediave dhe ndikime të tjera.

1. Ndikimi i faktorëve ekonomik e social

1.1 Varfëria

Pa dyshim, që varfëria dhe papunësia janë një ndër faktorët kryesorë të dhunës në familje sidomos shfaqin dyshimin e mosaftësisë, apo se nuk e kam një të ardhur të mirë dhe të sigurt dhe kjo sjell pasiguri në jetesën bashkshortore. Si rezultat i mos plotësimit të nevojave elementare së pari vjen deri te dhuna psikologjike e pastaj vazhdon në llojet tjera të dhunës. Kohën kur e kam shkruajtur temën ka qenë kohë pandemie, ku e gjithë bota ka ngrirë në sferën ekonomike. Sa i përket kësaj krize me të cilën përballlet i gjithë globi, as Sllovenija nuk u shmanget dëmtimeve, që i kanosen shoqërisë në përgjithësi. Populli është disi i stresuar tej mase se nuk dihet një e ardhme e sigurtë. Shumica kanë humbur punën, apo i kanë mbyllur firmat, ndërprerë ushtrimin e zanateve të tyre, kjo padyshim, që shumë familje përballen me të ardhura minimale, dhe mosmenaxhimi i mirë i tyre shpie deri në grindje mes partnerëve. Sidomos, çiftet që kanë humbur punën dhe kanë pas edhe nga një kredi bankare. Nga statistikat e bëra tregojnë se numri i dhunës dhe i divorceve është rritur. Por, varfëria si gjendje e bën, që një partner të tolerojë të pamundurën për shkak të kushteve.

1.2 Papunësia

Marrëdhëniet e pazgjidhura në familje shoqërohen gjithashtu edhe me papunësinë, e cila shkakton një ndjenjë pasigurie dhe pafuqie tek një individ gjë, që çon në sjellje të dhunshme për të arritur qëllimet dhe të drejtat. Thonë se burrat shpesh kryejnë dhunë ndaj partneres së tyre për shkak të situatës së tyre financiare gjatë krizës martesore, ai nuk ka punë dhe ka të ardhura të vogla, që nuk mjaftojnë për mbijetimin dhe për gjendjen në të cilën ndodhen, ai fajëson gruan. Kur njëri nga partnerët humb punën është e rëndësishme, që partnerët të vendosin përparësitë për të jetuar së bashku. Punësimi i mundëson një personi të jetojë me dinjitet dhe papunësia minon personalitetin e një individi dhe kështu edhe harmoninë familjare. Gjë, që kjo mund të çojë në depresion dhe apati midis partnerëve duke ulur cilësinë e partnerit dhe jetën familjare, mund të çojë në divorc, apo edhe nuk kalojnë në divorc, por vetëm dominimi ndaj partnerit tjetër mund të jetë si hallkë për të mos u larguar nga partneri i dhunshëm etj. Kur një partner e humb punën, është detyra e atij, që punon të kujdeset për të dy. Sidoqoftë, kjo mund të jetë një problem kur vetëm një partner nuk është në gjendje të sigurojë të ardhura për gjithë familjen i vetëm. Në vitin 2014, Këshilli Kombëtar i Republikës së Sllovenisë lëshoi një vendim në bazë të Rregullores së procedurës së këshillit kombëtar në bazë të një konsultimi të titulluar Dhuna në Familje - Përgjigjet Sistemike, i cili përcakton se një grua e papunë viktimë e dhunës nuk ka të drejtë për ndihmë sociale financiare, ushtrimi i të drejtave merr parasysh të ardhurat e partnerit. Kushti qëndron në atë se ata janë akoma të martuar. Arsyeja për këtë është rruga e gjatë për marrjen e ndihmës sociale financiare.¹⁷ Bazuar në vendimin e miratuar, ne mund të pretendojmë se shteti gjithashtu kryen një lloj dhune ndaj grave që janë tashmë viktima të dhunës në familje ose që shteti promovon dhunën ndaj grave në familje.¹⁸

¹⁷ (Vendim i Asamblesë Kombëtare të Republikës së Sllovenisë 2014)

¹⁸ Nemanic Dulmin, Janja Dejavniki tveganja za nasilje nad ženskami 2015

1.3 Kultura dhe tradita

Edhe shoqëria sllovene preket po nga problemi i kulturës dhe traditës si rezultat i dhunës në familje. Roli i burrit ka ndikim më të madh në shoqëri, dhe se gruaja është ajo e cila duhet të kujdeset për fëmijët dhe lidhjen barshkëshortore dhe nëse eventualisht ndodh diçka brenda familjes, gruaja është ajo e cila duhet ta zgjedh dhe nuk i bën dëm nëse pak duron të paktën për hatër të fëmijëve. Paramendoni kur këto gjëra mund të ndodhin në R. Sllovenisë e të mos flasim për në R. E Maqedonisë së Veriut. Shpeshherë dëgjoj se një grua e dhunuar nuk largohet nga dhunuesi sepse së pari ajo kujton çastet e lumtura, që ka kaluar me të, edhe pse ekziston dhuna, sepse ka raste kur qetësohen dhe mendojnë se kaluan krizën, apo se partneri i tyre nuk është ashtu i dhunshëm, por është nën ndikimin e faktorëve të jashtëm, ose po partnerja u beson shumë premtimeve të tija në kohën kur kërkon falje dhunuesi, apo janë edhe pritshmëritë e shoqërisë ata, që në martesë duhet të durohet se martesë ka edhe anë të mira edhe anë të këqija. Vallë gruaja duhet të durojë edhe dhunën si anë të keqe të martesës? Pritshmëritë e shoqërisë janë, që gruaja është ajo e cila e mban bashkë martesën dhe nëse ajo ndahet nga burri edhe pse është i dhunshëm, përsëri ajo është fajtores se ajo e prishi martesën, dhe tani le të mbaj faj për të. Faktin se edhe ajo ka të drejtë të jetoj në ambijet ku nuk ka dhunë e mohon dhunuesi në rradhë të parë, por edhe një pjesë e madhe e shoqërisë. Ekzistojnë raste kur nuk largohet gruaja nga dhunuesi edhe pse është e punësuar, shkakun qëndron se paga, që merr mund të mos mjaftojë për nevojat e saj dhe të fëmijëve që mund të ketë, apo edhe ndikon ajo ndjenja e frikës për tu përballur vetë me të ardhmen duke dëgjuar vazhdimisht nga dhunuesi se nuk mundesh të mbijetosh pa mua, t'i nuk mundesh pa mua asgjë, t'i pa mua je askushi.¹⁹

E çka mund të thuhet për një grua në Maqedoni, e cila nuk është as e punësuar, as e siguruar, dhe më e keqja nuk trashëgon asgjë nga familja, të paktën nuk ka as përkrahjen e prindërve. E të mos flasim për sjelljen e një burri të dhunshëm në shoqërinë e shetit të Maqedonisë së Veriut, mirë thotë znj. Maja Plaz se Patriarkali është ende gjallë ²⁰ dhe se nuk

¹⁹ Priročnik za delo z ženskami in otroki z izkušnjo nasilja 2016, Ljubljana: Društvo SOS telefon za zenske in otroke – zrtev nasilja) Izdaja ob 25. obletnici delovanja Društva SOS telefon

²⁰ Plaz Maja, Doracaku (Priročnik za delo z ženskami in otroki z izkušnjo nasilja 2016, 126, Ljubljana: Društvo SOS telefon za zenske in otroke – zrtev nasilja)

duhet t'i mbyllim sytë nga ky realitet qoftë ai nga kultura apo nga tradita, sepse "sytë e mbyllur nuk e shohin ligësinë". Së pari ndaj këtij realiteti i mbyll sytë partneri/partnerja, familja dhe kështu me rradhë deri te shteti. Në Slloveni të paktën vajzat trashëgojnë pasurinë nga familja dhe kanë përkrahjen e prindërve të tyre si do që të jenë vajzat, por në Maqedoni dihet shumë mirë se ku e ka vendin vajza, dhe nëse ndodh diçka vajza është ajo e cila vulozet për tërë jetën. Për trashëgimi dhe përkrahje më mirë as edhe të mos flasim. Prandaj, është shumë e rëndësishme, që edhe kur marrin guximin dhe kërkojnë ndihë viktimat e dhunës në familje duhet, që në Qendrat për punë sociale të kemi punëtorët profesional të përgatitur mirë për informimin sa ma adekuat, që mund t'ju ofrojnë për zgjedhjen e problemit dhe mbrojtjen sa më të mirë të tyre nga dhuna në familje.

1.4 Ndikimi i alkoolit dhe substancave narkotike

Marrëdhënia midis përdorimit të alkoolit dhe dhunës në familje është e ndërlikuar. Sllovenia është vend i pasur në të cilën kultivohen vrreshta rrushi dhe alkooli është me një çmim të volitshëm, kështu që, mund ta blejnë të gjitha shtresat e shoqërisë. Sidomos përdoret më tepër në pjesën e Shtarskës pjesa e Mariborit, Celje, Ptujit dhe Sllovenska Bistricës. Proverba popullore, që vlenë në Republikën e Sllovenisë është: »Voda za zbraz, vino za dušo« (uji për fytyrë, vena për shpirtin). Një nga mitet idetë e rreme që i kanë shumë njerëz për dhunën në familje është se alkooli është një shkaktar i madh i dhunës në familje; në të vërtetë, nuk është alkooli ai që shkakton dhunë në familje, ndonëse disa bashkëshortë dhunues e përdorin alkoolin si pretekst për t'u bërë të dhunshëm. Ndonëse përdorimi i alkoolit nga dhunuesi mund të ndikojë në ashpërsinë e dhunës në familje, apo në lehtësinë me të cilën bashkëshorti dhunues i justifikon veprimet e veta, bashkëshorti dhunues nuk bëhet i dhunshëm për shkak të alkoolit. Me fjalë të tjera, të pirit e alkoolit nuk bën, që bashkëshorti dhunues të humbasë kontrollin, përkundrazi, dhuna në familje përdoret për të ushtruar pushtet dhe kontroll mbi një person tjetër, pra nuk përfaqëson humbje të kontrollit²¹.

²¹ Dhuna ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri, 2019 : <https://www.al.undp.org/content/dam/albania/NewPublications/Dhuna%20ndaj%20Grave%20dhe%20Vajzave%20studimi%202018.pdf>

Alkooli është shpeshherë shkaktar i grindjeve në një partneritet, partnerët e të cilave konsumojnë tepër alkool gratë e tyre u janë nënshtruar më shpeshë dhunës fizike. Dhe në këso raste shumica e mentaliteteve të çifteve e arsyetojnë veten apo partnerin, se pinte dhe prandaj vepronte ashtu, ose se po të mos ishte i dehur nuk do të sillej kështu. Pra, alkooli rrit gjasat e sjelljes agresive dhe vepron si ndërmjetës. Ndryshime të tilla psikologjike janë për shembull²²: aftësia e zvogëluar për të zgjedhur alternativa ndaj reagimit të dhunshëm, - perceptimi i ndryshuar i sjelljes së të tjerëve (sjellja e të tjerëve interpretohet në mënyrë më provokuese nga individët në një gjendje të dehur), shqetësimi i zvogëluar për pasojat e mëvonshme të veprimeve agresive.

Manuali për punë me gratë dhe fëmijët që përjetojnë dhunën (Linja e telefonit SOS për gratë dhe fëmijët viktime të dhunës 2014)²³ thotë, se alkooli dhe dhuna janë të lidhura, pasi shumë burra konsumojnë alkool para se të kryejnë dhunë ndaj një partneri, dhe alkooli është vetëm një justifikim për dhunë për të mos kujtuar veprën e kryer. Kështu, mbizotëronte mendimi se ekzistonte një lidhje indirekte midis tyre, se alkooli ishte i pranishëm në rastin e dhunës, dhe më pas sjellja e autorit të veprës u bë pa ndjenja. Raporti Përfundimtar i projektit mbi rezultatet e punës hulumtuese për projektin "Incidenca e dhunës dhe reagimi ndaj dhunës në sferën private dhe në partneritet" brenda një programi që janë bërë kërkimet në Slloveni gjat viteve 2006-2013"²⁴ vëren se 52% e autorëve të dhunës janë ata që pinë tepër ose kanë qenë të dehur gjatë dhunës.

2. Ndikimi i masmediave

Raportimi mbi dhunën në familje është pa dyshim në interesin publik. Informatat për dhunën në familje karakterizohen si "të dhëna të ndieshme" dhe kërkojnë mbrojtje dhe klasifikim të veçantë. Paralajmërimet, që i bëhen publikut për mangësitë e mosfunksionimit të sistemit, ku me këtë zbulohen, në lidhje me mangësitë e punës së organeve shtetërore dhe

²² Filipčič Katja Nasilje v družini, Bonex, Ljubljana 2002)

²³ (Priročnik za delo z ženskami in otroki z izkušnjo nasilja 2016, 126, Ljubljana: Društvo SOS telefon za zenske in otroke – zrtev nasilja) Linja e telefonit SOS për Gratë dhe Fëmijët Viktime të Dhunës 2018)

²⁴ Raporti përfundimtarë, 2008

ndihma në interesin e publikut si dhe të viktimës në përgjithësi. Raportimi duhet të jetë i përgjegjshëm dhe në pajtim me parimet profesionale etike. Informatat duhet të garantojë privatësinë e viktimës dhe pjesëmarrësve të tjerë. Mediat shpeshherë shpërndajnë stereotipet mbi ushtruesit e dhunës dhe viktimës dhe as që e studiojnë historinë e ngjarjes në thellësi. Gjatë përshkrimit të ngjarjes së dhunës në familje shpeshherë kërkojnë shkaqet individuale për shkaktimin e dhunës, dhe anashkalojnë aspektin shoqëror ku xhelozia dhe alkoolizmi shpeshherë kuptohen si rrethana lehtësuese për të justifikuar dhunën ndërkoh që e kalojnë përgjegjësinë dhe fajin nga kryesi tek viktima. Alkoolizmi dhe xhelozia janë faktorë rreziku për dhunën, por nuk janë shkaku i saj. Dhuna nuk duhet të paraqitet si një problem i individit, sepse kjo e shtynë atë në sferën private dhe kështu mohon përgjegjësinë e shoqërisë ose të gjithë atyre që vëzhgojnë dhunën dhe nuk marrin masa. E rëndësishme është se dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave është pasojë e kontekstit shoqërorë, në shembullin dhuna e partnerit ndaj partnerit tjetër do të thotë për mos respektimin e barabartësisë në çift. D.m.th është pasojë e një marrdhënie të pabarabartë midis gjinive.²⁵

Mediat duke raportuar siç duhet, i dërgojnë një mesazh të qartë publikut në përgjithësi, se dhuna është e papranueshme dhe përgjegjës për dhunë janë vetëm ata të cilët dhunën e ushtrojnë, dhe se me të drejtë viktimat kërkojnë ndihmë për ndalim të dhunës në familje.²⁶

3. Ndikimi i faktorëve të tjerë

Fjalori i Gjuhës Letrare Sllovene (SSKJ i vitit 2000)²⁷ fjalën xhelozia e përkufizon si "frika e dikujt për të humbur dashurinë, dashurinë e një personi". Duke u nisur nga psikoanalizisti më i njohur në botë Sigmund Frojdi xhelozinë e gjurmon që në moshën e fëmijërisë. Kur të gjithë dëshirojmë të duhemi nga prindërit tanë dhe me ardhjen e vëllaut apo të një motre më të vogël se na, ne fillojmë t'i përjetojmë tundimet tona se mos vallë babai dhe mami nuk na duan tani si më parë se tani foshnja e porsalindur ka vëmendje më të madhe se na. Me një

²⁶ Marrë nga doracaku "Kako poročati o nasilju v družini in nasilju nad ženskami" Priročnik za medije. Društvo SOS telefon za ženske in ortoke – žrtev nasilja. Ljubljana. 2016

²⁷ (Slovar slovenskega knjižnega jezika – Fran, SSKJ i vitit 2000)

fjalë fillojmë të ndihemi si të lënë pas dore ose si të braktisur. Ose po, kur jemi më të ritur nga një vërejtje, që mund të na e bëjnë prindërit menjëherë e nxjerrim në pah atë xhelozinë tonë dhe e tregojmë në atë mënyrë, që prindërve ju themi ndoshta mua nuk më doni aq sa vëllaun apo motrën. Xhelozia është një emocion që nënkupton frikën e humbjes së diçkaje që zotëron personi. Në këtë rast, është personi ai, që do, dhe kultivon ndjenja të forta. Frika e humbjes rezulton në zemërim, trishtimin dhe hakmarrjen ndaj personit të cilit ai kultivon "dashuri" sepse, sipas besimit të tij të gabuar, nuk i kthehen ndjenjat në të njëjtën mënyrë. Do të thotë, që nëse një i dashur nuk i kthen të njëjtat emocione, që ai ose ajo i mban ndaj tij, ai ose ajo është i bindur se ai ose ajo do ta lërë atë për arsye të dikujt tjetër ose për arsye të tjera dhe për pasojë do të kryejë akte dhune ndaj tij ose saj.²⁸ Xhelozia është gjithashtu një nga faktorët e rrezikut për dhunë, që ndodh kur kryesi nuk mund më të përmbaj zemërimin dhe posesivitetin e tij. Një person xheloz ka një luhajtje të theksuar të vetëvlerësimit, frikën e refuzimit të partnerit, marrëdhëniet e tij ndërpersonale i nënshtrohen paqëndrueshmërisë, ka një ndjenjë të zbrazëtisë. Në këtë kontekst, ekzistojnë një grup autorësh, që zbulojnë se xhelozia buron që nga fëmijëria sepse prindërit nuk i kushtonin vëmendje fëmijës. Një person i tillë gjithmonë do të ketë një ndjenjë frike dhe turpi që partneri i tij/ saj do të largohet prej tij/saj. Prandaj, ai/ajo kryen veprime xhelozie kundër tij/saj, të cilat mund të çojnë në veprime të dhunshme²⁹. Sondazhi Dhuna ndaj grave ose Si të arrihet toleranca zero, e kryer nga Instituti i Shkencave Mjekësore në Lubjanë në 2003, tregoi se dhuna në familje ndaj grave përbënte deri në 50.4% të burrave xhelozë, që ushtronin kontroll të tepruar mbi partnerët e tyre dhe ata kryejnë sjellje të dhunshme ndaj tyre.³⁰ Njerëzit xhelozë kanë një konkurrent imagjinar, që i bën ata të ndjehen të kërcënuar në lidhje me partnerin e tyre. Ata kanë frikë se do të humbin dashurinë dhe vëmendjen e partnerit të tyre, dhe se ky i fundit do t'i braktis ata. Kështu që partneri partnerin tjetër fillon ta kufizojë në daljet e tyre, kufizon shoqërimin e partnerit me të tjerë miq, aktivitetet e kohës së lirë, veshjen dhe fikësohen në veprimet që i bëjnë. Shumë herë, burrat e fajësojnë viktimën për sjelljen e tyre të dhunshmet e bindin dhe e lidhin shumë ngushtë se rezultati i shpërthimeve të tyre është pikërisht xhelozia.

²⁸Dejavnik i tveganja za nasilje nad zenskami, Nemanic Dulmin, Janja 2015)

²⁹ Ambrož, M (2003) Novo (odkrito) nasilje – psihično nasilje (med partnerjema) Revija za kriminalistiko in kriminologijo

³⁰ Jernej Letnar Črnič, Pasti svobode izrazanja, 2003

Ka mjaft probleme, por unë do të thoja që problemi themelor në një marrëdhënie është mos komunikimi në çift. Çiftet, njerëzit në përgjithësi, nuk dinë të flasin, nuk dinë të flasin për ndjenjat, emocionet e tyre, për ato që përjetojnë në një marrëdhënie.

Çiftet shpesh mendojnë në fillim të një marrëdhënie kur janë të dashuruar se gjithçka është e shkëlqyeshme dhe e mrekullueshme, por kur ata fillojnë të jetojnë së bashku, ka gjithmonë situata në jetën e përditshme që bëhen konfliktuoze vetëm sepse ne jemi njerëz të ndryshëm. Partnerët mund të kalojnë shumë mirë bashkë, por nuk janë kopje e njëri-tjetrit. Dhe në jetën e tyre së bashku, ata përballen me pikëpamje të ndryshme, nganjëherë edhe me përvoja të ndryshme. Nëse nuk dini si të flisni dhe t'i zgjidhni problemet aty për aty, gjërat fillojnë të ndërlikohen, konfliktet bëhen gjithnjë e më të thella, dhe kur kriza është vërtet e rëndë, ato zakonisht shtohen dhe duken si pa zgjidhje, në raste të tilla çifti duhet të merr hapa të rëndësishëm drejt kërkimit të një ndihme nga njerëzit ekspert. Se sa të suksesshëm do të jenë partnerët në të ardhmen, varet nga ata. Dhe ka raste kur problemet zgjidhen, por pyetja qëndron se sa duan dhe sa të gatshëm janë çiftet të harxhojnë energji dhe sa punë duhet të investojnë në zgjidhjen e problemeve. Gjithashtu koha se sa ka zgatur problemi midis tyre luan një rol shumë të rëndësishëm sepse gjatë kalimit të kohës problemet grumbullohen. Dhe kur gjithçka është e ngarkuar, është e vështirë t'a zgjidhësh dhe përsëri ta vendosësh në vendin e vet. Komunikimet apo kërkuarja ndihmë nga ekspertët, që u janë në ndihmë çifteve janë shumë të mira nëse çiftet në fillim të jetës së tyre kërkojnë ndihmë kur lindin keqkuptimet e para të vogla. Në atë kohë, ekziston një mundësi e madhe, që marrëdhënia e tyre të përmirësohet, që gjërat të zgjidhen dhe ata mësojnë se si të komunikojnë hapur për çfarëdo çështje në marrëdhënie. Kjo do të thotë, që ata mësojnë të flasin për ndjenjat, dëshirat e tyre, për ato që i shqetësojnë dhe i brengosin. Por më e rëndësishme është se ata ka mundësi edhe të mos u afrohen ndjenjave dhe veprimeve të tilla siç janë xhelozia dhe grindjet apo përballjen me to mund ta tejkalojnë në mënyra më të lehta. Zgjidhja e konfliktit apo zvogëlim i grindjeve qofshin ato në partneritet apo edhe familjar, gjithashtu mund të mësohen. Për ta kapërcyer xhelozinë nevojitet një strategji, që përmban elemente të nevojshme për të përballur këtë gjendje emocionale, sidomos atëherë kur kuptohet se xhelozia nuk ka një bazë llogjike.³¹

³¹ Ostati ali oditi? Kdaj je čas, da prekinem partnerski odnos 2. del Martina, Partnerski odnosi (internet)

Ne mund të kemi marrëdhënie cilësore në nivele të ndryshme, qofshin ato partnerë apo marrëdhënie familjare. Familja primare është thelbësore për mënyrën se si ne dimë të jetojmë partneritetin tonë në jetë. Të marrim shembull, një fëmijë i vogël familja e të cilit është e gjithë bota e tij dhe prindërit e të cilit janë perënditë e tij. Kjo është gjithçka, që një fëmijë në ato momente di. Ai nuk është zhvilluar ende mendërisht, aq sa të jetë në gjendje të mendojë për gjërat të krahasojë apo edhe të vëzhgojë nga jashtë. Ajo që ai sheh dhe njeh në shtëpi, çfarëdo që po ndodh është e vetmja gjë që ai di. Nëse ai jeton në një familje ku prindërit e duan njëri-tjetrin dhe fëmijët gjithashtu, ky është mesazhi më i mirë, që fëmija mund të marrë nga prindërit e tij, por nëse një fëmijë përjeton një klimë negative në shtëpi, sheh grindje, dhunë, poshtërim dhe fytyrje, është një imazh i një familjeje që pa vetëdije, por jashtëzakonisht thellë ankorohet në shpirtin e tij. Si përkthyes që marr pjesë në rastet e dhunës në familje shpesh herë i pyes gratë se atëherë ku ndodhin zënkat në mes jush si çift ku janë fëmijët? Prindërit shpesh më thonë, që fëmijët janë akoma aq të vogël sa që sigurisht nuk do t'i mbajë mend grindjet tona, ose që fëmijët nuk dinë asgjë, sepse ata nuk po grinden para tyre. Një mendim i tillë mendoj unë se është plotësisht i gabuar. Ajo që po ndodh midis prindërve ndjehet nga fëmijët e moshës së vogël, madje edhe kur ato janë foshnje. Kjo ka të bëjë kryesisht me mirëqenien e nënës, sepse foshnja ka qenë në simbiozë (Bashkëjetesë e vazhdueshme e dy qenieve të gjalla) me nënën për një kohë të gjatë, kështu që ndjenjat e saj transmetohen tek fëmija. Të gjitha këto ndjenja do të absorbohen nga shpirti i fëmijës dhe do të vendosen në pandjenja. Sa po ky fëmijë të hyjë në marrëdhënie me seksin e kundërt, kjo në mënyrë të pavetëdijshme do të dalë në shesh diku dhe do t'i shkaktojë atij probleme.

Modelet e partneritetit mund të trashëgohen, por çfarë ndodh nëse takoni partnerë që vijnë nga botë krejtësisht të ndryshme? Sidomos luftën në çift e kemi se kush të mbizotërojë, ai i cili siguron më shumë të ardhura për familjen? Burrë, grua apo ka ndonjë kriter tjetër?

Unë nuk mendoj se ekziston një kriter gjinor, apo se ajo mvaret nga të ardhurat më të mëdha se kush i bije në shtëpi nëse i siguron burri apo gruaja. Ka të bëjë më shumë me tiparet e personalitetit të individit. Gratë shpesh janë lidere në një marrëdhënie. Por këtu ka më shumë mundësi dhe është e vështirë të thuash se kush do të dominojë marrëdhënien. Kjo varet shumë nga familjet nga vijnë partnerët dhe çfarë modelesh kanë marrë si fëmijë. Sigurisht, individët nuk takohen kurrë rastësisht, por ata gjithnjë tërheqin nga diçka e njohur, por e padukshme nga partneri i tyre. Kur takojmë një partner të mundshëm në jetë, ne gjithmonë

duam t'a tregojmë veten në versionin më të mirë. Nxjerrim veten në sipërfaqe me cilësitë tona pozitive dhe zakonisht i fshehim të metat tona, ato për të cilat jemi të vetëdijshëm besoj se e tërheqim veten ashtu siç e fshehim. Deklarata se kemi një ndjenjë, që e njohim këtë person për një kohë të gjatë ose se jemi shumë rehat me të, është e lidhur ngushtë me këtë që them në rast.

Sa të sigurtë jemi në njerëzit kur flasim për marrëdhëniet, seksualitetin? A zvogëlohet tema e sinqeritetit me kalimin e moshës ndërsa plakemi, ose anasjelltas?

Shumë njerëz nuk ishin mësuar të flasin hapur, aq më pak të flasin për emocione, sepse emocionet fatkeqësisht janë ende një temë tabu në familje. Kështu, shumë akoma sillen sipas modeleve të mësuara. Të gjithë bëmi dakord se si sillemi brenda familjes, ku të gjithë kemi një rol për të luajtur, në atë mënyrë që ne të tregojmë dashuri. Një njeri është i sigurtë kur ai zotëron prirjen për t'u ballafaquar me tjetrin duke i vënë në pah të gjitha detajet e rëndësishme për diskutim.

Sot flitet shumë më tepër për aventurat, janë çoroditur rinia sepse është koha e Facebook-ut dhe Instagramit? *A është ndrimi i partnerëve seksualë një modë e kohës moderne dhe çfarë do të thotë për zhvillimin emocional të një individi?*

Këtu mund të them se gjërat e tilla kanë ekzistuar, që nga kohërat më të lashta dhe nuk është çështje mode. Një sjellje e tillë ka ekzistuar gjithmonë, por ndonjëherë gjërat kanë qenë më të fshehta dhe jo aq publike sa janë sot. Sidoqoftë, nëse ekziston një marrëdhënie dashurie midis partnerëve, është e kuptueshme që ata janë besnikë ndaj njëri-tjetrit. Në qoftë se jo diçka tjetër ke të lidhur të paktën një kontratë morale me të. Thjesht, nëse marrëdhënia e tyre emocionale është mjaft e thellë, nëse janë mjaft të afërt, ata nuk kërkojnë aventura jashtë marrëdhënies, pasi thjesht nuk e ndiejnë nevojën për një gjë të tillë. Në fillim të një partneriteti, ne nuk i vërejmë disa gjëra bazohemi vetëm në pasion, por kur ftohet ai pasion, kur qetësohet, kur tërheqja seksuale, e cila është baza e dashurisë ulet pak, partneri/ja papritmas nuk është aq i/e mirë sa duhet. Ka shumë të meta, që nuk na pëlqejnë dhe neve na duket se partneri/ja ka ndryshuar. Nuk është se partneri/ja bëri diçka ndryshe, por pamja jonë për të ndryshoi, ndërsa sytë tanë u hapën. Prindërit janë shumë të rëndësishëm për zhvillimin emocional të një individi. Prindër gjënë më të mirë, që mund ta bëjnë për fëmijët e tyre është, që fëmijën e tyre t'a pranojnë ashtu siç është, t'i ofrojnë ngrohtësi emocionale, ushqim

emocional, mbështetjen dhe dashurinë, dhe gjënë më të rëndësishme që mund të bëjnë është t'a lavdërojnë fëmijën. Kështu që një fëmijë, që në moshë të vogël ndjen dashuri, ndjen se prindërit e duan sepse është i tyre dhe jo sepse është një nxënës i shkëlqyeshëm në shkollë apo se është i suksesshëm. Njerëzit të cilët nuk e marrin këtë ndjenjësi në mënyrë të mjaftueshme janë në gjendje të kequshqyer emocionalisht. Kur të rriten, ata mendojnë se e dinë se çfarë është dashuria, por në të vërtetë për dashurinë nuk kanë lidhje. Dashurinë ata e kërkojnë në mënyra të ndryshme, përfshirë edhe përmes dhunës.

Ne nuk mund t'a injorojmë dhunën në marrëdhënie. Pse ndodh dhuna, çfarë e shtyn një person që të jetë i dhunshëm?

Zemërimi i parë dhe dhuna e mëvonshme ndodhin për herë të parë, sepse njeriu nuk i ka sqaruar çështjet themelore që kanë të bëjnë me veten dhe të tjerët. Një arsye tjetër e dhunës janë pritshmëritë në një marrëdhënie, të cilat mund të jenë joreale. Dhuna mund të ndodhë gjithashtu, sepse një nga partnerët është një person emocionalisht shumë i papjekur, me vetëbesim të dobët dhe vetëvlerësim shumë të ulët. Të gjitha këto janë arsye, që inkurajojnë një person të prirur për dhunë. Një ndikim shumë i rëndësishëm në këtë është se ky partner, qoftë mashkull apo femër, ka përjetuar dhunë nga prindërit e tij si fëmijë ose ka parë një marrëdhënie të dhunshme midis familjarëve. Ne po flasim për dhunë verbale, emocionale ose fizike. Ekziston një mundësi e mirë që një person t'a përsërisë këtë model më vonë në marrëdhëniet e tij/saj. I gjithë ky problem është shumë i vështirë për tu zgjidhur, por jo plotësisht i pazgjidhur. Problemi më i madh është, që njerëzit e dhunshëm nuk janë të gatshëm të bëjnë asgjë për veten në lidhje me përmisimin e tyre, sepse ata kapen pas mekanizmit mbrojtës, se gjithëçka është në rregull me ta, që të tjerët janë fajtorë për atë se ata janë të dhunshëm, që një burrë goditi partneren e tij sepse ajo e provokoi atë, apo nuk ju bind atij dhe gjëra të ngjashme. Nuk ka asnjë justifikim për dhunën dhe nuk duhet të tolerohet në asnjë rrethanë. Por, pse një partner, që përjeton dhunë e ka kaq të vështirë të vendosë të largohet nga personi që po abuzon me të?

Për disa arsye. Një shkak shumë i rëndësishëm, veçanërisht tek gratë, është frika. Frika se partneri abuziv do t'i ndjekë ata, do të hakmerret, se do të përkeqësohet situata edhe më shumë sesa ishte, do të zemërohet me fëmijët. Ky është presion i rëndë psikologjik për një grua, që përjeton dhunë, sepse ajo gjithë kohën është shumë e frikësuar, duke jetuar vazhdimisht me frikë. Shpesh këto janë gra, që natyrisht janë rritur me një ndjenjë inferioriteti,

varësia janë të papunësuarat kanë pasur mundësinë të shohin dhunën dhe ta përjetojnë atë në familjen primare. Këto janë arsyet kryesore pse ato nuk arratisen, dhe kanë një imazh shumë të dobët për veten e tyre. Disa e pranojnë rolin e viktimës si rolin e tyre të jetës. Ajo është viktimë dhe si e tillë konfirmohet tek njerëzit përreth saj përmes rolit të viktimës. Të gjithë e mëshirojnë, në këtë mënyrë ajo tërheq vëmendjen, ajo bëhet e rëndësishme në një farë mënyre tjetër, në vend, që të përpiqet të ndryshojë veten dhe jetën e saj. Sjelljen e një partneri të dhunshëm nuk e ndryshon dot, kushedi sa të përpiqesh. E vetmja zgjidhje është, që të kërkosh ndihmë të ngrish zërin dhe t'u tregosh situatën njerëzve që ju besoni së pari dhe të drejtoheni pranë organeve kompetente dhe organizatave të ndryshme, që ju ndihmojnë viktimave të dhunës në familje. Nëse një gruaje i ofrohet ndihmë e mjaftueshme për të forcuar veten e saj emocionalisht, ajo ka mundësi të heqë qafe gjendjen e ferrit në të cilën ndodhet.

Programet e tilla zbatohen në shtrehimore, si dhe shoqata të ndryshme për të ndihmuar viktimat e dhunës në familje. Me ndihmën e tyre, shumë gra mund të shpëtojnë jetën dhe fëmijët e tyre.

KAPITULLI I TRETË

DHUNA NË FAMILJE NË LEGJISLACIONIN SLOVEN – ASPEKTE

KRAHASIMORE ME RMV

1. Kodi penal sloven dhe inkriminimi i dhunës në familje

Deri në miratimin e Kodit penal në vitin 2008 në legjislacionin penal sloven dhuna në familje nuk inkriminohej me këtë emër. Përmendja e parë me këtë emër ka ardhur me Ligjin mbi ndryshimin dhe plotësimin e Kodit penal (KZ-A)³², i cili ishte i miratuar më vitin 1999. Në paragrafin e parë të nenit 299, përcaktohej » Kushdo që keqtrajton tjetrin në publik ose në bashkësinë familjare i shkakton dhunë dhe e kërcënon sigurinë e tij, dhe i shkakton frigë dënohet me burgim deri në dy vjet (KZ-UPB1, neni 299). Ky ndryshim mundësoi ndjekje të dhunës në familje sipas detyrës zyrtare³³. Këtu ligjvënësit i është dukur e rëndësishme që dhuna në publik të shqyrtohet si dhuna në familje dhe nuk ka caktuar shqyrtim të veçantë apo sanksione më të rrepta për dhunën në familje. Dhe nga kjo kuptojmë se qëllimi i ligjvënësit për ndryshimin e Kodit penal ka pasur synim përmisimin e mbrojtës së antarëve më të rrezikuar të familjes siç janë gratë dhe fëmijët³⁴.

Intresante ka qenë edhe kuptimi kundrejt përdhunimit në ligjin penal. Deri në vitin 1977 në Slloveni vlente se, femra në lidhje martesore nuk mund të ishte e dhunuar nga bashkëshorti i saj. Atëherë Ligji në fuqi i FLRJ-së në nenin 179 ka dënuar femrën që nuk ka jetuar në bashkësi martesore me të dhe e ka detyruar të ketë mardhënie seksuale dhe ka përdorur forcë ose po, e ka kërcënuar me sulm kundrejt jetës dhe trupit³⁵. Pastaj Ligji penal i SRS i vitit 1977 përdhunimin dhe veprat e kësaj natyre i ka inkriminuar nëse vepra ka qenë e kryer kundrejt personit me të cilën jeton kryesi në bashkësi martesore apo në bashkësi jashtëmartesore.

Ky ligj nuk i ndanë antarët e familjes në veçanti, por i emërton si bashkësi familjare, ose po si një bashkësi familjare që zgjat më shumë. Si dhunë në familje është e përshkruar para se gjithash dhuna fizike dhe në kuptim të caktuar dhuna psikike. Vërejmë që edhe për të njëjtën vepër penale qoftë ajo se a është në bashkësi familjare apo nga një bashkim i cili ka zgjat më

³² (KZ-A), Uradni List R.S 23/99 i cili ishte i miratuar më 8. 4. vitin 1999

³³ (Katja Filipčič, Nasilje v družini 2005).

³⁴ (ČAS, 2006, 117)

³⁵ (Katja Filipčič, Nasilja v družini, 2005, 516)

shumë, por që janë ndarë, për kryersin e veprës penale ekziston dënimi më i butë, edhe atë 3 vite burgim në vend që të ishte i dënuar 5 vite. Qeveria si propozuese e këtij ligji nuk dha asnjë arsyetim (Qeveria e vitit 2008), për atë nuk është e qartë se pse konsiderohet për të njëjtën veprë penale dënim më i lehtë në qoftë se kryhet ndaj ish-partnerit/bashkshortit.

Në nenin 192 përshkruan neglizhencën dhe trajtimin mizorë ndaj fëmijëve. Kjo veprë penale ndodh kur një prind, kujdestar, shkel seriozisht detyrimet e tij ndaj fëmijës, e detyron fëmijën të punoj punë të rëndë, që nuk është e përshtatshme për moshën e tij, ose e detyron në lypsari, e detyron të bëj veprime të dëmshme apo edhe mund të abuzojë me të dhe ato veprime mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin e tij. Për këtë veprë penale parashihet dënimi me burgim prej tre deri në pesë vite burgim. Në vazhdim në nenin 193 parashihet shkelje e obligimeve familjare, ku dënohet me burgim prej dy vitesh për lënije pasdore të obligimeve familjare dhe me këtë veprë penale familjes i shkakton dëme të mëdha dhe le pasdore anëtarin e familjes i cili nuk mund të kujdeset për veten e tij. Për këtë gjykata ka masën e mbrojtjes së viktimës, ku në paragrafin e dytë të këtij neni, gjykata mund të lëshoj dënimin me kusht obliguesit që të plotësojë obligimet, detyrat dhe mirëmbajtjen e familjareve. Veprën tjetër mund ta rradhisim në veprat penale ekonomike, ku flet për mospagimin e shpenzimeve jetësore për fëmijët, dënohet prej një viti gjegjësisht deri në tre vite. Edhe këtu gjykata ka masën mbrojtëse për viktimën e cila mund të detyroj kryesin që të paguaj rregullisht shpenzimet jetësore dhe ty shlyej obligimet e mëparshme. Ndërsa në nenin 173 përcakton se mësuesi, edukatori, kujdestari prindi, prifti, mjeku ose po ndonjë person tjetër, i cili me keqpërdorimin e pozitës së vet, abuzon seksualisht me një person i cili nuk i ka mbushur ende 15 vjet dhe i cili i është besuar për mësim, kujdesje, dënohet me burgim prej tre deri në dhjetë vite. Forma të reja të veprave penale në lidhje me dhunën në familjei i ka sjell novela e tretë e Kodit penal KP-1, e pranuar në vitin 2015. Ligji mbi ndryshimi dhe plotësimin e Kodit penal (KZ-1C)³⁶, ku si veprë penale e njohu edhe lidhjen e detyrueshme martesore, dhe ndjekjen. Ai i cili në mënyrë të dhunshmet apo nga shfrytëzimi i pozitës që mund të ketë, të detyroj tjetrin të lidhë martesë me të, ose po detyrimin që të lidh ndonjë lidhje tjetër që është e përafërt me lidhjen martesore, sipas nenit 132 të Kodit penal KZ-1C kryerësi dënohet me burgim nga 3 deri më 5 vjet, dhe nëse kjo veprë është e bërë kundrejt personit të mitur apo personit me të meta. Në vijim në nenin 134 është paraparë se, kushdo që, përmes ndjekjes së përsëritur dhe

³⁶ (Kazenski Zakonik -1C Uradni list RS,št. 54/15 me datë 20 .7. i vitit 2015)

përpjekjeve të vazhduara ndërhyjnë për të vendosur kontakte të drejtëpërdrejta ose edhe nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit dhe me këtë shpreh që personi ndaj të cilit janë drejtuar këto ndjekje të ndjehet i frikësuar apo i rrezikuar dënohet me dënimin me para ose me dënim me burgim deri në dy vjet.³⁷

Arritjet më të suksesshme në Kodin penal janë bërë me datë 01. 11.2008 në Republikën e Sllovenisë kur hyri në fuqi Ligji Penal cili u miratua me datë 20. 05. 2008 dhe u shpall me 04. 06. 2008³⁸, ku për herë të parë ka sjell formë të re të veprës penale - dhuna në familje. Deri te ai ndryshim vepra e dhunës në familje ka qenë e inkriminuar në nenin 299 të Kodit penal si veprë penale e dhunës. Edhe atë neni 191 është definuar kështu:

- 1) Kushdo që keqtrajton tjetrin në bashkësinë familjare ose i shkakton dhimbje të tjera, poshtëron, e kërcënon atë duke sulmuar jetën ose trupin e tij, duke ja kufizuar lëvizjen nga vendbanimi, duke e ndjekur duke e detyruar të punoj ose të heq dorë nga puna e tij, ose duke i kufizuar me forcë të drejtat e tij të barabarta në shoqëri ai dënohet me burgim deri në pesë vjet.
- (2) Kushdo që kryen veprimin nga paragrafi paraprak dënohet në të njëjtën mënyrë në ndonjë periudhë më të gjatë kohore.
- (3) Nëse vepra e kryer nga paragrafi i parë është kryer kundër një personi dhe kryesi ka jetuar në bashkësi martesore ose në një marrëdhënie të mëparshme, që është prish, dhe që veprimi ka qenë i lidhur ngusht me të, kryesi dënohet me dënimin me burgim deri në tre vjet³⁹.

³⁷ Po aty.

³⁸ (Kodi penal, Uradni list RS, št. 55/08, 4. 6. 2008)

³⁹ (Kodi penal i RS, KZ-1 U.I.RS, neni 191)

2. Kodi penal i RMV-së dhe inkriminimi i dhunës në familje

Ndryshimet rrënjësore në legjislacionin e RMV-së për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje filluan në vitin 2004 me amendamentimin dhe ndryshimin e Kodit Penal dhe Ligjit mbi familjen, ku u miratuan nene përkatëse që në mënyrë eksplicite kanë të bëjnë me dhunën në familje. Prej këtu edhe filluan ndryshimet rrënjësore të politikës shtetërore dhe shoqërore për njohjen pikë së pari të dhunës në familje, dënimin e kryerësve, vetëdijesimin e viktimave për denoncim të dhunës në familje, realizimin e kampanjave të ndryshme mediatike e kështu me radhë. Ndryshime edhe më të rëndësishme në legjislacion nga kjo sferë ndodhën në vitin 2006 dhe 2008 e sidomos në vitin 2014 kur edhe u miratua ligj i posaçëm për rregullimin e dhunës në familje “Ligji për parandalim, pengim dhe mbrojtje nga dhuna në familje” i cili hyri në fuqi nga 1 janari i vitit 2015. Duhet të theksohet se me miratimin e Ligjit të posaçëm, u shfuqizuan nenet përkatëse të Ligjit mbi familjen që kishin të bënin me dhunën në familje, mirëpo që të kemi një pasqyrë të rregullimit të kësaj çështjeje do ta komentojmë edhe atë se çfarë ka përmbajtur kjo pjesë e ligjit. Ligji për parandalim, pengim dhe mbrojtje nga dhuna në familje ishte në fuqi deri në vitin 2021, kur u shfuqizua me rastin e hyrjes në fuqi të ligjit të ri mbi dhunën në familje – *Ligj për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje*.

Në frymën e harmonizimit të legjislacionit pozitiv të Republikës së Maqedonisë së Veriut me legjislacionin e Unionit Evropian (si rezultat i synimit të integritetit të vendit tonë në UE) si dhe duke u bazuar në deklaratat dhe konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë që kanë të bëjnë me dhunën në familje dhe mbrojtjen e viktimave të saj, Kodi Penal i RMV-së ka bërë një hap të rëndësishëm sa i përket rregullimit inkriminues të dhunës në familje me ndryshimet e vitit 2004⁴⁰. Dhuna në familje nuk është inkriminuar si vepër e posaçme penale por është e inkriminuar në kuadër të veprave penale ekzistuese në legjislacionin penal, me përcaktimin e dënimeve më të rënda dhe të ndjekjes penale sipas detyrës zyrtare kur vepra penale është kryer në kuadër të dhunës në familje, pra dhuna në familje dallohet si një lloj i veçantë i krimit⁴¹.

Kështu në nenin 122 pika 21 dhuna familjare definohet si: *“Me dhunë familjare nënkuptohet maltretimi, fyerja e vrazhdë, kërcënimi i sigurisë, lëndimi trupor, dhuna gjinore*

⁴⁰ Ratkoceri V, 2016 – Law regulation of domestic violence in Republic of Macedonia from independence until today, II. Türk Hukuk Tarihi Kongresi Bildirileri (2 Cilt - Takım), 617- 625

⁴¹Po aty.

*apo dhunë tjetër psikike apo fizike me të cilën shkaktohet ndjenjë e pasigurisë, kërcënim apo frikë, ndaj bashkëshortit/bashkëshortes, prindërve apo fëmijëve apo personave të tjerë që jetojnë në bashkësi të përbashkët, si dhe ndaj bashkëshortit/bashkëshortes së mëparshëm/me apo personave të tjerë që kanë fëmijë të përbashkët apo gjenden në raporte të afërta personale*⁴². Ky ndryshim ishte i domosdoshëm si në aspektin preventiv ashtu edhe në atë represiv, pra, ishte i domosdoshëm dhe i rëndësishëm ashpërsimi i represionit penalo-juridik me qëllim të luftimit sa më të suksesshëm të dhunës në familje në shtetin tonë. Para se të bëheshin këto ndryshime çështja e dhunës në familje trajtohej në kuadër të veprave të tjera të përgjithshme penale në Kodin Penal të RMV-së⁴³.

Në Kodin Penal janë inkriminuar të gjitha format e manifestimit të dhunës në familje: dhuna fizike, dhuna psikike dhe dhuna seksuale. Dhuna fizike inkriminohet në veprat penale si marrja e jetës, dëmtimi ose shkelja e integritetit trupor, lëndimet trupore, lëndimet e rënda trupore etj. Format e dhunës psikike inkriminohen në veprat penale si detyrimi, heqja e lirisë në mënyrë të paligjshme, rrezikimi i sigurisë kurse forma e dhunës seksuale sanksionohet përmes veprës penale përdhunim, marrëdhënie seksuale me një person me nevoja të veçanta, sulm seksual ndaj një fëmije dhe ndërmjetësim në kryerjen e prostitucionit⁴⁴.

Veprat penale të parapara në Kodin penal⁴⁵ të sanksionuara posaçërisht për rastet kur kryhen si pasojë e dhunës në familje janë: vrasja (neni 123), vrasja në çast (neni 125), lëndime trupore (neni 130), lëndimi i rëndë trupor (neni 131), detyrimi (neni 139), privim i kundërligjshëm nga liria (neni 140), rrezikimi i sigurisë (neni 144), ndërmjetësim në ushtrimin e prostitucionit (neni 191) dhe vepra penale sulm seksual ndaj të miturit që nuk ka mbushur 14 vjet (neni 188). Me ndryshimet në fjalë, Kodi penal përcakton se gjithmonë kur do të kryhet ndonjëra nga veprat e lartpërmendura penale gjatë dhunës familjare, konsiderohet si formë më e rëndë e veprës penale, ndërsa sanksioni është më i madh nga forma themelore e veprës së njëjtë penale⁴⁶.

⁴² Kodi penal i RM-së :Tekst integral, i përpunuar në gjuhën shqipe me udhëzime dhe sqarime,treguesi alfabetik, Doc. Dr. Afrim Osmani, Furkan, Shkup, 2010, f. 123

⁴³ Ratkoceri V, 2016 – Law regulation of domestic violence in Republic of Macedonia from independence until today, II. Türk Hukuk Tarihi Kongresi Bildirileri (2 Cilt - Takım), 617- 625

⁴⁴ Po aty.

⁴⁵ Kodi Penal i RM-së, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.7/08.

⁴⁶ Ratkoceri V, 2016 – Law regulation of domestic violence in Republic of Macedonia from independence until today, II. Türk Hukuk Tarihi Kongresi Bildirileri (2 Cilt - Takım), 617- 625

3. Dhuna në familje në ligjet e posaçme

3.2 Ligji mbi familjen në Republikës së Sllovenisë

Në Republikën e sllovenisë çështja e dhunës në familje rregullohet me ligj të posaçëm për të cilën edhe do flasim më tej, kurse sa i përket Ligjit mbi familjen këtu më shumë janë të rregulluara disa çështje sa u përket psh fëmijëve dhe raportit të tyre me prindërit.

Ligji mbi failjen në Republikën e Sllovenisë parasheh në nenin 5 të drejtat dhe obligimet e prindërve për kujdesin, mirëritjen, zhvillimin, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të lidhur nga martesë ose jashtë martesë janë të njëjta. Në vijim në nenin 5a ceket se prindërit dhe shoqëria duhet t'ju ofrojnë familjarëve mbështetjen e nevojshme, për tu kujdesur për fëmijët, për të parandaluar keqtrajtimet dhe braktisjet e tyre. Në pjesët tjera të ligjit parashihet çështjet e lidhjes së martesës, në nenet në vazhdim ceket regjimi pasurorë martesor i bashkëshortëve dhe ndarja e pasurisë në rast të prishjes së mardhënies martesore. Ndërsa në vazhdim në nenet (102, 103, 105, 105a, 106,106a) flitet për të drejtat dhe obligimet e prindërve dhe fëmijëve ndaj njëri tjetrit. Ndërsa në nenet 123 dhe 124 të Ligjit mbi Familjen flitet për obligimin e prindërve në lidhje me ushqimit deri në moshën 26 vjeçare, edhe nëse fëmija mund gjatë kësaj kohe të jetojë në një lidhje martesore apo jashtëmartesor dhe bashkëshorti apo partneri nuk është në gjendje të kujdeset për të, janë të obliguar të kujdesen prindërit si dhe të drejtës së besuarit të fëmijës njërit ishbashkëshort (normal këtu vendoset në bazë të një psikologu ku sipas metodave të tyre dhe gjendjes familjare vendoset se ku do të jetë më mirë të qëndroj fëmiju)⁴⁷.

3.3 Ligji mbi parandalimin dhe pengimin e dhunës në familje në Slloveni

Për shkak të natyrës, se dhuna në familje, që kryhet më tepër në ambiente të mbyllura apo nga shprehja e shumë përsëritur brenda katër mureve ka një pasojë më vete, kemi një numër të lartë të errët sepse ekzistojnë ende shumë raste të pa denoncuar, gjë që len të

⁴⁷ (Družinski zakonik, Uradni list RS št. 15/17 me datë 31. 3. 2017)

kuptojmë se nuk kemi shumë njohuri rreth gjendjes në të cilën ndodhemi, institucionet me këtë realitet përballen atëherë kur dhuna mes antarëve në familje ka qenë e pranishme një kohë shumë të gjatë, ose edhe në rastet kur reagimi i tyre ka qenë shumë i vonuar, kur pasojat kanë qenë të natyrës fatale. Në bazë të dispozitave të Rezolutës mbi programin nacional të parandalimit të kriminalitetit për periudhën e viteve 2007-2011, në Republikën e Sllovenisë me 01. 02. 2008 është miratuar Ligji mbi parandalimin e dhunës në familje, me datë 15. 02. 2008 është bërë shpallja, ndërsa ka hyrë në fuqi me 1. 3. 2008.⁴⁸ Ky është një ndër ligjet e para i cili rregullon veprimin e përgjithshëm të institucioneve shtetërore dhe shoqatave, bashkëpunimi reciprok mes tyre si dhe përcakton masat për parandalimin e dhunës në familje, mbrojtjen e viktimave dhe gjithashtu parasheh edhe dispozita për rehabilitimin e autorëve të akteve të dhunës në familje. Ligji përbëhet prej gjashë pjesëve dhe në nenin e 1 përcakton qëllimin e ligjit dhe definimin e dhunës në familje, detyrimin e organeve kompetent edhe organeve joqeveritare, masat që ju shqiptohen dhunuesve dhe ndihma që ju jepet viktimave të dhunës.

Në nenin e 2 të këtij ligji janë të përcaktuar antarët e familjes. Pjestarë të familjes sipas këtij ligji janë:

- Bshkshorti/tja ose bashkjetuesi/ja, apo ishbashkshorti/ja, apo ishpartneri/ja bashkëjetues;
- Të afërmit në vijë të drejtë,
- Të afërmit në vijë të tërthortë deri në në brezin e katërt,
- Personi në krushqi në vijë të drejtë,
- Personi në krushqi në vijën e tërthortë deri në brezin e dytë,
- Adaptuesi dhe i adaptuari
- Birësuesi dhe fëmija i birësuar në familjen birësuese,
- Kujdestari,
- Personat të cilët kanë fëmijë të përbashkët,

⁴⁸ (Zakon o preprečevanju nasilja v družini, ZPND Uradni list RS. št. 16/08 me datë 15. 2. 2008)

- Personat që jetojnë në amvisri të përbashkët,
- Personat të cilët janë në marrëdhënie partneriteti, jo doemosdoshmërisht të shoqëruar me bashkëjetes,

Si pjesëtarë të familjes sipas këtij ligji konsiderohen edhe personat nga paragrafi i parë tek të cilët ka mbaruar marrëdhënia (Ligji mbi parandalimin e dhunës në familje, neni 2 ZPND Uradni list RS, št. 16/08 me datë 15. 2. 2008).⁴⁹

Ndërsa në paragrafin e parë të nenin e 3 të Ligjit mbi parandalimin e dhunës në familje kemi të bëjmë me përcaktimin e dhunës edhe atë dhunën e përcakton në këtë mënyrë: Dhuna në familje është çdo veprim me forcë drejtuar ndaj pjesëtarit tjetër të familjes apo në lidhje intime ose lidhje kujdestare, që cenon integritetin fizik, psikik e ekonomik, lënija pas dore e anëtarit të familjes pa marrë parasysh moshën dhe gjininë.⁵⁰

Në vijim të neit të 3 janë të përcaktuara format e dhunës :

Dhuna fizike është çdo veprim i përdorimit të forcës fizike kundrejt anëtarit tjetër të familjes i shkakton dhimbje, frigë, apo nënvlerësim pa marrë parasysh se a janë shkaktuar pasojat.

Dhuna seksuale përfshinë imponimin apo detyrimin ose përpjekjen për të detyruar kontakt ose sjellje seksuale pa pëlqimi e personit.

Dhuna psikologjike përfshinë shkaktimin e frikës ndërmjet trembjes, kërcënimit për dëmtim fizik të vetes, partnerit, fëmijëve, kërcënim për marrjen e kujdestarisë së fëmijëve, izolim i dhunshëm nga miqë, familja, shkolla, puna etj.

Dhuna ekonomike përfshinë vënien në varësi ekonomike, moslejimin e punësimit , mos dhënie e parave për ushqim të mjaftueshëm ndaj personit në mardhënie familjare.

Lënija pas dore e antarëve të familjes përfshinë moskujdesin apo lënijen pas dore të antarëve të familjes në rast sëmundjeje, invaliditeti apo moshe ose rrethana tjera të personale.

Ndjekja definohet si formë e dhunës ku kryerësi i dhunës bën kontakte të padëshiruara të përsëritura qëllimisht, ndjekje fizike, ndërhyrje, vëzhgim, ndalim ku viktima lëviz, ose formë tjetër e ndërhyrjes në jetën e padëshiruar të viktimës.

⁴⁹(Neni 2 i ZPND Uradni list RS, št. 16/08 me datë 15. 2. 2008).

⁵⁰ (Neni 3 i ZPND Uradni list RS, št. 16/08 me datë 15. 2. 2008).

Ligji mbi parandalimin e dhunës në familje në nenin e 4 përcakton se fëmijët gëzojnë një mbrojtje të veçantë sepse, në qoftë se janë prezent aty ku ndodh dhuna automatikisht i numron edhe ata si viktimë të dhunës. Dhe nëse kuptohet se fëmija është viktimë e dhunës në familje duhet urgjentisht të bëjmë paraqitjen pranë Qendrës për sigurim social, Policisë apo Prokurorisë së shtetit. Në vazhdim në nenin 5 përcakton detyrat dhe obligimet e institucioneve që janë të obliguar të ndërmarrin hapat dhe procedurat konkrete për mbrojtjen e viktimës. Ndërsa neni i 6 i Ligjit mbi parandalimin e dhunës në familje flet se nëse kemi dijeni se dikundi ushtrohet dhunë në familje cilët janë të detyruar të bëjnë paraqitjen. Në nenin 7 të këtij ligji është përcaktuar se viktima mund të ketë ka të drejtë të zgjedh personin i cili do ta shoqërojë në procedura. Dhe se ky shoqërues viktimës i jep mbështetje dhe ndihmon të gjejë një zgjidhje për situatën në të cilën ndodhet. Shoqëruesi duhet të jetë i moshës madhore dhe nuk duhet të ketë një të kaluar si dhunues në familje. Në nenin 8 të Ligjit mbi parandalimin e dhunës në familje është përcaktuar se viktima ka të drejtën e një mbrojtësi i/e cila në bazë të rregullave të veçanta mbron interesin e viktimës. Në nenin 9 të Ligjit mbi parandalimin e dhunës në familje kemi të bëjmë me mbrojtjen e të dhënave personale dhe me informimin e viktimës nga personat zyrtarë për të drejtat e veta. Në nenin 10 të Ligjit mbi parandalimin e dhunës në familje përcaktohet roli i organeve, dhe organizatave joqeveritare rreth punës se si të informohen mes veti dhe se si duhet të veprojnë në rastet e dhunës. Gjithashtu parasheh edukim dhe trajnimet e nënpunësve profesional në organizata shtetërore dhe në organizata joqeveritare se si të veprojnë dhe përballen me rastet e kësaj natyre. Një trajnim i tillë u bëhet edhe gjykatëse dhe prokurorëve publik të cilët merren në mënyrë të vazhdueshme me problematikën e dhunës në familje.⁵¹ Në nenin në vijim në nenin e 11 të Ligjit për parandalimin e dhunës në familje me kërkesë të ministrisë kompetente për punë familje dhe çështjeve sociale në bashkëpunim me ministritë e tjera ka përgatit programin nacional për parandalimin e dhunës në familje, ku pastaj me propozimin e qeverisë parlamenti e pranon për periudhën gjashtë vjeçare. Këtu qeveria duhet ende të pranojë edhe planin aktiv, ku këto plane janë akte interpretuese të programeve nacionale, që për një fushë të caktuar përcaktojnë aktivitetet për periudhën dy vjeçare. Dhe Qeveria çdo dy vjet i raporton Kuvendit për punën e bërë. Gjithashtu në maj të vitit 2009 Kuvendi i Republikës së Sllovenisë miratoi Rezolutën mbi

⁵¹ LPDHF neni 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11

programin nacional të parandalimit të dhunës në familje 2009-2014⁵². Në nenet në vazhdim përcaktohen detyrat e Qendrës për sigurim social, plani se si t'i ndihmohet viktimës, masat mbrojtëse, nëse fëmija është viktimë e dhunës në familje përveç masave në lidhje me këtë ligji ndërmerr edhe masa në pajtim me Ligjin për familje për rregullimin e raporteve të prindërve dhe fëmijëve, mbykqyerjen mbi ushtrimin e të drejtës prindërore dhe kujdestarisë. Koordinimet mes organeve, që shqyrtojnë rastet e dhunës në familje dhe formimi i ekipeve multidisiplinare ku në hollësi do të shpjegojmë në vazhdim të përshkrimi i Rregullores mbi bashkpunimin e organeve dhe funksionimi i Qendrës për punë sociale, ekipeve multidisiplinare dhe shërbimeve regjionale të shqyrtimi i dhunës në familje.

Në Ligjin mbi parandalimin e dhunës në familje nuk janë të parapara dënimet penale, sepse këta janë të rregulluara me Ligjin e procedurës penale dhe me Kodin penal të Republikës së Sllovenisë. Ku ligji thotë, se organet dhe organizatat janë të detyruara që të kryejnë procedurat dhe të zbatojnë masa, që janë të nevojshme për mbrojtjen e viktimës shiqar nga aspekti i kërcënimit dhe mbrojtja e interesave të saj. Zbatimi profesional i ligjit çon/shpie deri te një trajtim më të përshtatshëm të dhunës në familje dhe rrjedhimisht në zvogëlimin e saj. Hulumtuesit kanë terguar, se me zbatimin e masave penalo juridike nuk e zvogëlojmë dhunën në familje, por dhunën e zvogëlojmë me bashkpunimin e organeve dhe organizatave të ndryshme me punë profesionale dhe të azhurnuara.

3.4 Ligji mbi parandalimin dhe pengimin e dhunës në familje në RMV

Ky ligj është miratuar më 17. 09. 2014 Gazeta zyrtare e R. Maqedonisë së Veriut nr. 138/2014 dhe ndryshimet i ka pasur në vitin 2015.⁵³ Ky ligj rregullon veprimin e përgjithshëm të institucioneve dhe shoqatave për parandalimin dhe pengimin e dhunës në familje si dhe bën mbrojtjen dhe sigurimin e viktimës. Ky ligj ka për qëllim parandalimin e dhunës në familje, në të gjitha format e saj, me masa të përshtatshme ligjore, të familjareve që janë viktimë e dhunës në familje, ndërmarrjen e masave për parandalimin dhe mbrojtjen e viktimave të

⁵² ReNPPND0914 të dhunës në familje 2009-2014 (ReNPPND0914, Uradni list RS, št 16/08 e shpallur më 27. 5. 2009, ka hyrë në fuqi me 1. 6. 2009)

⁵³ Ligji mbi parandalimin dhe pengimin e dhunës në familje në RMV (Gazeta zyrtare e R. së Maqedonisë së Veriut nr. 138/2014)

dhunës në familje, respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, jetës integritetit personal, mosdiskriminimit dhe barazisë gjinore. Në nenin e tretë të këtij ligji përcaktohet se çka kuptojmë me nocion dhunë në familje, pastaj se çfarë kuptimi kanë shprehjet e përdorura në këtë ligj siç janë: kryerës i dhunës, viktimë e dhunës, marrdhënie e afërt personale, dhunë trupore, fizike, psikike, seksuale përgjim, dhunë ekonomike dhe dhunë në bazë gjinore. Në nenin e pesë të këtij ligji përcaktohen se cilat janë organet kompetente që kryejnë veprimtari nga sfera e mbrojtjes sociale, mbrojtjes së fëmijëve, punëve të brendshme, shëndetësisë, punësimit dhe arsimit, ndërmarrin masa për mbrojtjen e viktimës dhe pengimin e dhunës. Në vazhdim përcaktohen shoqatat të cilat ofrojnë mbrojtje viktimave dhe që janë të regjistruara për ofrimin e shërbimeve në pajtim me Ligjin për mbrojtje sociale. Në nenin në vazhdim përcaktohet urgjenca e veprimit që do të thotë se personat zyrtarë që janë të punësuar në institucionet në të cilat kryejnë veprimtari nga sfera e mbrojtjes sociale, shëndetësisë, mbrojtjes së fëmijëve dhe arsimit, si dhe gjykatat në procedurat për dhunë në familje detyrohen të veprojnë urgjentisht mbi interesat dhe nevojat e viktimës, e sidomos kur viktima është fëmijë, person i moshuar, dhe person me aftësi të kufizuara. Ky ligj gjithashtu parashes se viktima ka të drejtë të zgjedh një shoqërues që do ta shoqërojë në procedura dhe në veçanti e thekson detyrimin personave zyrtarë për informimin më të mirë që ti japin viktimës në lidhje me të drejtat e veta dhe për masat mbrojtëse. Në nenin në vazhdim ky ligj përcakton se kush janë të detyruar të bëjnë paraqitjen e dhunës në familje dhe për miratimin e Strategjisë nacionale për parandalimin, pengimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, për periudhë prej pesë viteve nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Për formimin e trupit nacional koordinativ kundër dhunës në familje me mandat prej pesë viteve. Mast për mbrojtjen e viktimës nga Qendra për punë sociale, detyrat e policisë, gjykatës etj.

Ky ligj nga viti 2021 është shfuqizuar, me çrast në RMV është miratuar ligj i ri për dhunën në familje për të cilin edhe do të flasim shkurtimisht në vijim.

3.5 Ligji i parandalimit dhe i mbrojtjes nga dhuna ndaj fgrave dhe dhuna në familje

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", ndërsa do të fillojë të zbatohet pas tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ky ligj ka gjithsej XIII pjesë dhe 112 nene⁵⁴:

I Dispozitat e përgjithshme

II Parimet themelore

III Institucionet kompetente dhe politikat e integruara

IV Grumbullimi dhe mbrojtja e të dhënave

V Preventivë nga dhuna në bazë gjinore ndaj femrave dhe dhuna në familje

VI Mbrojtja e femrave viktime të dhunës në bazë gjinore dhe viktimave të dhunës në familje

VII Masa për mbrojtjen e viktimave

VIII Masat urgjente dhe të përkohshme për mbrojtje

IX Mbrojtja gjyqësore

X Shërbime për femra viktime të dhunës gjinore dhe dhunës në familje

XI Mbikëqyrja mbi zbatimin e këtij ligji

XII Dispozitat për kundërvajtje

XIII Dispozita kalimtare dhe të fundit

Qëllimi i Ligjit të ri: Qëllimi i ligjit është parandalimi dhe pengimi i dhunës me bazë gjinore ndaj femrave dhe dhunës në familje, mbrojtja efektive e viktimave nga çdo formë e dhunës me bazë gjinore ndaj femrave dhe viktimave të dhunës në familje duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare). Qëllimi i ligjit bazohet në parimin e barazisë dhe eliminimin e stereotipeve për rolet gjinore⁵⁵.

⁵⁴ Ligji i parandalimit dhe i mbrojtjes nga dhuna ndaj femrave dhe dhuna në familje, Gazeta zyrtare e RMV-së

⁵⁵ Po aty.

4. Startegjitë nacionale dhe dhuna në familje

4.2 Rezoluta mbi programet nacionale për parandalimin e dhunës në familje në R. E Sllovenisë

Rezoluta mbi programet nacionale për parandalimin e dhunës në familje në Republikën e Sllovenisë është miratuar më 27. 05. 2009 është shpallur më 01. 06. 2009 (Gazeta zyrtare e RS, 41/09)⁵⁶. Kjo rezolutë përmban vlerësimin e gjendjes dhe përcaktimin e problemeve në aspektin e dhunës në familje, e cila shpreh angazhimin serioz dhe përgjegjësinë për trajtimin me sukses të dhunës në familje.

Kjo rezolutë ka këto qëllime:

- Të zvogëlojë dhunën në familje dhe në shoqëri në përgjithësi.
- Të rris ndjeshmërinë ndaj çështjes së dhunës në familje;
- Të sigurojë veprim të koordinuar të autoriteteve dhe organizatave joqeveritare;
- Të nxisë diversitetin, qasjen e barabartë të zhvillimit cilësor të programeve të ndihmës për viktimat;
- Të nxisë diversitetin, qasjen e barabartë të zhvillimit cilësor të programeve të ndihmës për autorët e dhunës;
- Të sigurojë që fëmijët, të rinjtë dhe të rriturit të bëhen të ndërgjegjshëm për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre themelore të njeriut dhe të arsimohen për jetën për një shoqëri pa dhunë;
- Të nxisin ndërgjegjësinë te ata, që janë të ekspozuar ndaj dhunës në familje mbi format e mundshme të ndihmës dhe të sigurojnë qasje të saj nëpër tërë shtetin;
- Të sigurojnë burime të rregullta dhe të mjaftueshme financiare për furnizimin e programeve të ndihmës.

⁵⁶.Rezoluta mbi programet nacionale për parandalimin e dhunës në familje të R.S. 2009 (Gazeta zyrtare e RS, 41/09)

Dhuna në familje paraqitet pa marrë parasysh gjendjen ekonomike dhe sociale, gjininë, moshën, përkatësinë etnike, bindjet fetare, traditën dhe shumë rrethana tjera të anëtarëve të familjes. Disa rregulla kishin të bënin me segmente të ndryshme të dhunës në familje, mirpo, deri në miratimin e Ligjit mbi parandalimin e dhunës në familje në vitin 2008 sfera ligjore në këtë aspekte ishte një zbrazëti e errët. Nga statistika e bëra më tepër tregojnë, se ndaj dhunës në familje janë më të ekspozuara gratë. Në Republikën e Sllovenisë thuhet se, çdo e pesta grua është e dhunuar e çdo e shtata grua e përdhunuar. D.m.th është një problem i përgjithshëm, i cili ndërhyt në të drejtat e themelore të njeriut. Programi nacional është një dokument, që përfshin një gamë të gjerë të çështjeve të dhunës në familje. Ai i kushton vëmendje të veçantë dhunës ndaj grupeve më të ekspozuara siç janë: fëmijët, gratë, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe njerëzit që nuk janë në gjendje të kujdesen për veten e tyre për shkak të rrethanave të ndryshme. Dokumenti merr parasysh nevojat specifike të viktimave dhe rrethanat e tyre personale. Duke e pasur parasysh se dhuna në familje ndodh në hapësira private, ku si pasojë ka qëndrimin më të lehtë për të mbetur e fshehur dhe më e vështirë për tu identifikuar se sa dhuna që ndodh në vendet publike. Në qoftë se duam ta këpusim zinxhirin e dhunës, nuk mjafton që të reagojmë vetëm atëherë kur dhuna shpërthen, por duhet të veprojmë para kohe, të dimë të dallojmë format e dhunës në mënyrë preventive.

Problemet më të zakonshme në përcaktimin e shkallës dhe llojeve të dhunës në familje janë:

- ndjeshmëri e pamjaftueshme shoqërore ndaj kësaj dhune;
- mospërputhje në raportimin e akteve të dhunës (për shkak të turp, frikës, vetëfajësimit, aksesit të dobët në shërbime dhe frikës së reagimit), si rezultat i së cilës shumë raste nuk zbulohen dhe nuk ndëshkohen;
- funksionimi i pakoordinuar i shërbimeve kompetente dhe ndërlidhja joadekuate e regjistrave të tyre;
- përgjigje shumë e ngadaltë e shërbimeve kompetente në raste individuale;
- të moshuarit në përgjithësi kanë frikë dhe turp të raportojnë dhe t'u pranojnë autoriteteve kompetente se janë viktimat e dhunës në familje, pasi janë të varur fizikisht nga autorët e dhunës për të përmbushur për nevojat e tyre fizike;

- Mospërputhja midis autoriteteve kompetente në përpjekjen për të rritur ndërgjegjësimin dhe ndjeshmërinë në lidhje me dhunën në familje;
- mbulim i pabarabartë i territorit sllloven me programe ndihme për personat me përvojë të dhunës në familje dhe me programe për kryerësit e dhunës;
- alokim joefikas i fondeve në nivel kombëtar dhe lokal për financimin e integruar të programeve për njerëzit që përjetojnë dhunë në familje.

Në nivelin kombëtar, forma të ndryshme të ndihmës janë në dispozicion të viktimave (QPS, OJQ, telefonat SOS), por mundësia e tyre (veçanërisht programet e OJQ-ve) janë shpërndarë në mënyrë të pabarabartë nëpër zona. Çështja e disponueshmërisë së programeve të ndihmës është veçanërisht e rëndësishme për:

- personat me aftësi të kufizuara: ata dyshojnë se të tjerët do t'i besojnë ata (ndoshta sepse asnjëri nuk beson, se askush nuk do të kryente dhunë ndaj një personi me aftësi të kufizuara), ata mund të kenë vështirësi në komunikim ose të kenë akses fizik në shërbime që mund t'i ndihmojnë ata, varen nga ndihma anëtarët e tjerë të familjes;
- banorët e zonave bujqësore: kanë vështirësi në qasjen në shërbimeve kompetente për shkak të izolimit gjeografik (problemi i lëvizjes dhe kontrolli nga autori i dhunës);
- në gjendje të pafavorshme sociale: qasje më e dobët në shërbime për shkak të mungesës së parave;
- emigrantët dhe të huajt (të cilët mund të jenë viktimat e burrave nga komuniteti i tyre): për shkak të njohurive të kufizuara të gjuhës, dijes, kulturës dhe shërbimeve që i kanë në dispozicion;
- personat statusi i qëndrimit i të cilëve është i lidhur ngushtë apo mvaret nga statusi i partnerit. (ReNPPNDO914 Uradni list RS, št. 41/09)57

Edhe për slllovent si popull mund të themi se janë tolerues ndaj dhunës në familje, prandaj kjo rezolutë ka për qëllim që rastet e dhunës të mos mbesin në heshtje, por të bëhet denoncimi për atë. Sidomos kur kemi të bëjmë me fëmijët si viktimat e dhunës në familje, ndoshta të

57 Rezoluta mbi programet nacionale për parandalimin e dhunës në familje të R.S. 2009 (Gazeta zyrtare e RS, 41/09 (ReNPPNDO914 Uradni list RS, št. 41/09)

gjithë fëmijët nuk do të kenë rastin që të shkojnë tek psikologu apo te mjeku, por ekziston një vend ku do të shkojnë të gjithë e ato janë çerdhet, shkollat. Kjo rezolutë punon në të që të futet në kurikulat e arsimit tema e dhunës në familje dhe fëmijët të kenë informata mbi dhunën në familje dhe format e saja. Rezoluta tregohet edhe pak a shumë kritike edhe ndaj mediave dhe mënyrat se si e shpjegojnë një rast dhune. Shpesh dëgjojmë se kohëve të fundit dhuna në familje është në ritje, por ka të tillë që mendojnë se dhuna nuk është në ritje por është ritë vëmendja mediatike ndaj këtij fenomeni.

Špela Veselič (Društvo SOS telefon) ka thënë se sipas përvojave të tyre dhunë nuk ka më shumë tani se në të kaluarën. Arsyeja se tani shohim më shumë dhunë është se më shumë flitet në lidhje me të, dhe se njerëzit nuk e pranojnë si diçka normale. Sepse shoqëria është e ndarë në të fortët dhe të dobët ndaj këtij fenomeni. Disa ndaj kësaj tregojnë forcë e disa dobësi, ku disa tregojnë mbizotërim e pjesa tjetër nënshtrim. Ashtu edhe kjo shpjegohet në marrdhëniet familjare. Sepse tema e dhunës në familje është temë delikate për të cilën duhet të flitet, shumënjëherë për të, edhe heshtim. Dhuna shpeshherë mund të jetë edhe me pasoja tragjike, nëse nuk e parandalojmë para kohe. Shoqëria duhet shumë qartë t'i tregoj dhunuesit se veprimet e tij janë të pa tolerueshme, dhe të bindet se nuk ka vepruar si duhet, sepse dhuna fillon me fyerje, e pastaj vazhdon me një shuplakë dhe mbaron me dhunën fizike, kështu që dhunën duhet ta ndalojmë që në fillim. Pastaj organet shtetërore janë të detyruara, që të bashkëpunojnë në mes veti dhe çdo paraqitje të dhunës t'a marrin shumë seriozisht.

4.3 Strategjitë nacionale për luftimin dhe parandalimin e dhunës në familje në RMV

Strategjia nacionale për parandalimin e dhunës në familje ka për qëllim zhvillimin e një sistemi gjithëpërfshirës për parandalim të dhunës në familje në Republikën e Maqedonisë së Veriut⁵⁸. Përpilimi i këtij dokumenti strategjik mbështetet në mbrojtjen nga dhuna në familje dhe paraqet një vazhdimësi të përkushtimit të qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për një zgjidhje sa më efikase të fenomenit të dhunës në familje.⁵⁹ Kjo strategji është vënë në pajtueshmëri me të gjitha ligje, që Qeverija e Republikës së Maqedonisë së Veriut i ka vënë

⁵⁸ Strategjia nacionale e RMV-së për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna në familje 2012-2015 :

https://mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/nasilstvo_strategjia_alb.pdf

⁵⁹ Po aty

për të çrrënjosur dhunën në familje. Kjo Strategji nacionale është përpiluar nga një grup punues i cili ka qenë i dominuar nga Organi koordinativ nacional për monitorim dhe vlerësim të zbatimit të Strategjisë nacionale për mbrojtje nga dhuna në familje. Ky grup punues përbëhet nga përfaqësues të institucioneve nacionale të organizatave joqeveritare dhe organizatave ndërkombëtare dhe është përpiluar në bazë të mësimave dhe përvojave të fituara nga të gjitha institucionet nacionale, organizatat joqeveritare dhe ato ndërkombëtare në zbatimin e aktiviteteve të Strategjisë nacionale për mbrojtje nga dhuna në familje 2008-2011⁶⁰. Ku hapi shumë i rëndësishëm për përpilimin e strategjisë ishte analiza e gjendjes momentale në lëminë e parandalimit luftës dhunës në familje ku ka përfshirë edhe disa aktivitete:

- Shqyrtimin e kornizës rregullatore dhe legjislaturës nacionale;
- Dokumentit strategjike dhe politike që ndërlidhen me dhunën në familje;
- Shqyrtimin e gjendjes rreth zbatimit të planeve aksionare vjetore të Strategjisë nacionale për mbrojtje nga dhuna në familje 2008-2011;
- Shqyrtimin e raporteve vjetore, procesverbaleve nga takimet punuese të OKN-së,
- Vlerësimin e statusit të zbatimit të Strategjisë 2008-2011, përfshirë edhe identifikimin e pengesave dhe sfidave. (Strategjitë nacionale për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna në familje (Strategjitë nacionale për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna në familje 2012-2015)⁶¹.

5. Aktet nënligjore në Republikën e Sllovenisë

5.2 Rregullorja mbi bashkëpunimin e organeve dhe funksionimin e qendrës për punë sociale, ekipeve multidisiplinare dhe shërbime rajonale në trajtimin e dhunës në familje

Kjo rregullore ka hyrë në fuqi me datë 21. 04. 2009⁶². Kjo rregullore përcakton procedurën e mbashkëpunimit të informimit dhe dhënies së ndihmës mes organeve shtetërore mes organeve tjera në sferën e sigurisë, shëndetësisë, edukimit, shkollimit organizatave

⁶⁰ https://mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/nasilstvo_strategjia_alb.pdf

⁶¹ Strategji nacionale për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna në familje 2012-2015

⁶² (Uradni list nr. 31/09 I miratuar 14. 4. 2009 i shpallur me 20. 4. 2009 ka hyrë në fuqi me datë 21. 04. 2009)

joqeveritare, përbërjen dhe mënyrën e punës të ekipeve multidisiplinare për trajtimin e çështjes së dhunës në familje, rolin e Qendrës për sigurim social me këto raste, organizimi i koordinatorëve regional, ndihma që ju jepet viktimave të dhunës si dhe trajnimet e punëtorëve profesional për kryerjen e detyrave të caktuara .

5.3 Rregullorja mbi trajtimin e dhunës në familje në entet institucionale arsimore⁶³

Kjo rregullore përcakton sjelljen e punonjësve në institucionet arsimore publike dhe institucionet arsimore private që zbatojnë programe, ku hetojnë se ndodh dhunë ndaj një fëmije në familje, forma të ndihmës për një fëmijë viktimë të dhunës, si dhe bashkëpunimi e EIA me organet shtetërore, mbajtësit e autoriteteve publike dhe ofruesit e shërbimeve publike në rast të dhunës ndaj një fëmije në familje.

Në bazë të kësaj rregullorjeje në përputhje me ligjin rregullojnë organizimin dhe financimin e arsimit.

Një mësues ose një punonjës tjetër i EIA, që ka vërejtur ndryshime të një fëmijë, që mund të ketë pasojat e dhunës, ose po fëmija i ka treguar, që ai/ajo është viktimë e dhunës, mësuesi ose punonjësi tjetër i EIA duhet që menjëherë:

- të informoj këshilltarin e EIA ose, në mungesë të tij, drejtorin ose ndihmësdrejtorin,
- të informoj qendrën kompetente për punë sociale, jashtë orarit të punës së QPS, shërbimet e intervencës policinë; nëse pasojat janë që vërehen tek një pjesëmarrës i rritur në arsim sipas programeve, ai këshillohet të vizitojë mjekun dhe të informohet për mundësitë e ndihmës dhe organet që mund t'i ofrojnë ndihmën,
- vetë ose me një këshilltar bën një regjistrim të ngjarjes, vëzhgimeve, informacioneve të marra ose bisedës me fëmijën. (Pravilnik o obravnavi nasilja v družini za vzgojno-izobraževalne zavode Uradni list RS, št. 104/09)⁶⁴

⁶³ (Uradni list RS, nr.16/08 i miratuar 10. 12. 2009, i shpallur 18. 12. 2009, ka hyrë në fuqi 02. 01. 2010)⁶³

⁶⁴ (Pravilnik o obravnavi nasilja v družini za vzgojno-izobraževalne zavode Uradni list RS, št. 104/09)

5.4 Rregullorja mbi bashkëpunimin e policisë me organet dhe organizata tjera të zbulimit dhe parandalimit të dhunës në familje⁶⁵

Kjo rregullore përcakton rregullat dhe procedurat e informimit dhe bashkëpunimit të policisë me organet dhe organizatat tjera mbi trajtimin e rasteve të dhunës në familje për një bashkëpunim të koordinuar me Qendrën për sigurim social si dhe rregullon trajnimin e policëve dhe kriminalistëve në fushën e dhunës në familje (neni 1 i Rregullores mbi bashkëpunimin e policisë me organet dhe organizata tjera të zbulimit dhe parandalimit të dhunës në familje⁶⁶).

Në nenin e dytë të kësaj rregulloreje janë paraparë rregullat se si duhet të veprojnë policët dhe kriminalistët në pajtim me rregulloret, që rregullojnë procedura penale, kundërvajtje dhe veprat penale si dhe autorizimet e policisë për trajnimin e rasteve të dhunës në familje, në nenet në vijim është përcaktuar se si duhet të bëhet informimi i QPS-së dhe koordinimi i veprimeve që do të ndërmeren

Në nenin e tretë të kësaj rregullore është paraparë mënyra e informimit edhe atë policia e përcjell njoftimin mbi dhunën në familje në Qendrën për sigurim social më së voni mrenda tre ditëve. Njoftimin e dërgon personalisht, nëpërmjet telefonit, me shkrim ose në mënyrë elektronike e cila duhet të përmbaj:

Njoftimi me shkrim përmban:

- të dhënat mbi kohën e marrjes së paraqitjes gjegjësisht njoftimit,
- të dhëna mbi paraqitësin,
- të dhënat mbi viktimën e pretenduar,
- të dhënat mbi autorin e dyshuar të dhunës,
- përshkrim të shkurtër të aktit të dhunës,

⁶⁵ (Uradni list RS, nr. 16/08 i miratuar 19. 3. 2010, i shpallur 26. 3. 2010 ka hyrë në fuqi 27. 3. 2010)

⁶⁶ (neni 1 i Rregullores mbi bashkëpunimin e policisë me organet dhe organizata tjera të zbulimit dhe parandalimit të dhunës në familje Uradni list RS, nr. 16/08 i miratuar 19. 3. 2010, i shpallur 26. 3. 2010 ka hyrë në fuqi 27. 3. 2010)

- çdo informacion shtesë ose vëzhgim ekspert nga i cili mund të konkludohet se është kryer dhuna në familje,

- emrin dhe mbiemrin e personit që kemi kontaktuar.

Policia mund t'i propozojë QPS-së thirrjen e një ekipi multidisiplinar për trajtimin e dhunës në familje nëse vlerëson:

- është e domosdoshme një bashkëpunim i drejtëpërdrejtë dhe koordinimi i organeve dhe organizatave për të garantuar sigurinë e viktimës ose për të shkëmbyer informacione dhe sqaruar rrethanat e nevojshme për mbrojtjen e viktimës, dhe

- që ekzistojnë gjasat e përsëritjes së sjelljes së dhunshme me mundësisë së pasojave të rënda ose se dhuna ka vazhduar për një kohë të gjatë ose kur ndaj kryesit është lëshuar urdhëro ndalimi sipas dispozitave që rregullojnë autorizimet e policisë.

Nëse policia ka propozuar thirrjen e një ekipi dhe siguria e viktimës nuk rrezikohet drejtëpërdrejt, policia do të vazhdojë aktivitetet e saj në konsultim me QPS ose anëtarët e ekipit, por nëse bëhet fjalë se është në rrezik jeta dhe shëndeti i viktimës dhe se policia konstaton se duhet të bëhet intervenim i menjëhershëm, vepron menjëherë në pajtim me rregullat të cilat e rregullojnë procedurën penale, veprimeve dhe autorizimeve të policisë edhe pa u konsultuar me QPS. Polici dhe hetuesi që merren me parandalimin dhe hetimin e veprave penale në sferën e dhunës në familje duhet të trajnohen rregullisht për të paktën tre ditë në vit. Policët dhe hetuesit të cilët herë pas here merren me raste të dhunës në familje duhet të trajnohen të paktën një ditë në vit. Shefat e njësive policore janë të detyruar të sigurojnë trajnim për policët dhe kriminalistëve sipas paragrafit të e parë dhe të dytë të këtij neni. Përmbajtja e trajnimit përcaktohet nga program i përcaktuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë.

Trajnimet organizohen nga Administrata e Përgjithshme e Policisë në bashkëpunim me njësitë e tjera të policisë. Në zbatim marrin pjesë polic dhe kriminalist, të cilët kanë përfunduar me sukses programin e përshkruar të trajnimit për parandalimin e dhunës në familje. (Pravilnik o

sodelovanje policije z drugimi organi in organizacijami pri odkrivanju in preprečevanju nasilja v družini, Uradni list RS, št.16/08).⁶⁷

5.5 Regullorja mbi rregullat dhe procedurat e trajtimit të dhunës në familje gjatë kryerjes së veprimeve mjekësore⁶⁸

Kjo rregullore përcakton rregullat dhe procedurat, mënyrën e njoftimit dhe bashkëpunimin e organeve për veprimin e koordinuar të punëtorëve shëndetësorë në zbatimin e shëndetësore në lidhje me trajtimin e viktimave të dhunës në familje. Kjo ka të bëjë me:

- njohjen e dhunës në familje,
- rregullat dhe procedurat për trajtimin e viktimave të dhunës,
- edukimi i profesionistëve shëndetësorë në fushën e dhunës në familje.

Në nenin 2 të kësaj rregulloreje kemi të bëjmë me atë se dhuna në familje konsiderohet të jetë një problem i rëndësishëm shëndetësor në të cilin viktimat e dhunës vuajnë pasoja afatshkurtra ose afatgjata të shëndetit fizik ose mendor. Kur merren me dhunë në familje, punonjësit shëndetësor trajtojnë viktimat e dhunës me respekt dhe dhembshuri, ku deyra primare është shëndeti i tyre, përfshirë mbështetjen psikologjike, këshillimin, sigurimin e informacionit mbi format e tjera të ndihmës për viktimat e dhunës dhe procedurat për informimin në lidhje me dhunën në familje. Një punëtor shëndetësor i cili mëson në punën e tij për rrethanat në bazë të të cilave mund të konkludohet se është kryer dhuna në familje duhet të njoftojë qendrën kompetente për punë sociale më së voni brenda 24 orëve, përveç nëse viktima e dhunës kundërshton shprehimisht dhe nuk është dyshim për kryerjen e një vepre penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare. Njoftimi bëhet me shkrim, në mënyrë elektronike ose nëpërmjet telefonit. Pavarësisht nga paragrafi paraprare në rastet urgjente kur jeta e viktimës së dhunës ose fëmijëve të saj është në rrezik, punëtori shëndetësor

⁶⁷ (Pravilnik o sodelovanje policije z drugimi organi in organizacijami pri odkrivanju in preprečevanju nasilja v družini, Uradni list RS, št.16/08).

⁶⁸ Uradni list RS, nr.16/08 i pranuar 21. 2. 2011 i shpallur 24. 05. 2011 ka hyrë në fuqi 8. 6. 2011)

menjëherë do të njoftojë policinë në numrin e telefonit 113 ose qendrën kompetente për punë sociale. Në rast të dhunës në familje ndaj fëmijëve, punëtori shëndetësor duhet të njoftojë qendrën kompetente për punë sociale, policinë ose prokurorinë e shtetit jo më vonë se 24 orë. Njoftimi bëhet me shkrim, në mënyrë elektronike ose nëpërmjet telefonit. Njoftimi me telefon nga paragrafët e parë, të dytë dhe të tretë të këtij neni do të dorëzohet nga punonjësi shëndetësor me shkrim jo më vonë se tre ditë pas njoftimit, gjithashtu njoftimin ja përcjell edhe mjekut amë apo pediatrit që e ka të zgjedhur fëmija. Njoftimi me shkrim i referuar në këtë nen do të dorëzohet në formën e përcaktuar në Shtojcë, e cila është pjesë përbërëse e këtyre rregullave. Edhe sipas kësaj rregullore parashihen trajnime për punonjësit e shëndetit ku mbahen seminare profesionale, se si të trajtohen rastet e dhunës në familje dhe ato i vërteton Këshilli i shëndetit.

KAPITULLI I KATËRT

MASAT PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E DHUNËS NË FAMILJE NË R. E SLOVENISË – ASPEKTE KRAHASIMORE ME RMV

1. Roli i Policisë në parandalimin e dhunës në familje

1.1 Roli i policisë slovene në parandalimin e dhunës në familje

Veprat penale në kornizat e dhunës në familje, që i shqyrton policia në Republikën e Sllovenisë janë: dhuna në familje sipas nenit 191 të Kodit penal si dhe lënja pas dore dhe sjellja brutale ndaj personave të mitur sipas nenit të 192 të Kodit penal. Paraqitjen në polici mund ta bëj çdokush – viktimja, fëmija, dëshmitari, organizata joqeveritare, punonjësit në institucionet shtetërore dhe private. Kur bëhet fjalë për paraqitjen e dhunës të detyruar janë të gjithë, por më të ngarkuarit me këtë detyrim janë punonjësit në çerdhet, shkollat, organizatat shëndetësore, sipas rrugës zyrtare duhet ta bëjnë personat zyrtarë.

Nëse në rrethin tuaj vuani ju apo fëmija juaj dhunë trupore, psikike, seksuale, ekonomike ose edhe përndjekje, bezdisje të përsëritura, do të duhej të drejtoheni në stacionin policor më të afërt⁶⁹. Policia gjatë paraqitjes përpilon shkresën zyrtare dhe është e detyruar të ndërhyj sa ma shpejt në çdo rast të dhunës⁷⁰. Polici gjatë pyetjeve që i parashtron viktimës mbledh informacion dhe material nga shyqimi i vendit të ngjarjes, ndalimin e lëvizjes së ushtruesit të dhunës apo edhe mbajtjen në polici më shumë se 48 orë. Pastaj paraqitjen me të gjitha dëshmitë e mbledhura do të ja dërgon prokurorisë në shqyrtim.

E rëndësishme është, që viktimja të jetë e vetëdijshme për mbledhjen e dëshmive, sepse me këtë lehtësohet puna e procedurave gjyqësore. Mënyra më e lehtë e dëshmimit të dhunës në familje është forma e dhunës fizike. Sugjerohet se nëse ka ndodhur dhuna fizike në familje viktimja detyrohet të vizitohet nga mjeku, sepse shkresat apo evidencat e mjekut janë shumë të rëndësishme për shqyrtimin gjyqësorë. Nëse pasojat e dhunës janë të dukshme në pjesët e trupit atëherë viktimja le t'i fotografojë apo filmojë të gjitha dhe t'i ruaj si dëshmi.

⁶⁹ E drejta e viktimave për ndihmë dhe mbrojtje nga dhuna, 2013: https://www.interventionsstelle-wien.at/download/?id=gewaltschutzfolder_alb.pdf

⁷⁰ Po aty.

Për dallim nga dhuna fizike, dhunën psikike është shumë e vështirë ta dëshmosh. Si përfundim sugjerohet që viktimat t'i mbledh të gjitha dëshmitë me përmbajtje dhune, sidomos të mbaj shënime të ndodhive të dhunshme, të ruaj dërgimin e SMS-ve filmimet dhe inçizimet e mundshme t'i regjistrojë të gjitha datat, mundësisht të ketë edhe dëshmitarë dhe të gjitha këto të paktën t'i ketë në momentin kur të bëj denoncimin në polici. Por, nëse viktimat është e moshës madhore dhe e vendos vetë a do të bëjë vizitën te mjeku, ndërsa kur bëhet fjalë për fëmijët doemos duhet të vizitohet nga mjeku.

Detyrimet e policisë në rastet e dhunës në familje janë:

- Të marrë menjëherë në mbrojtje viktimën e dhunës
- Të informoj viktimën për mundësitë që i ofron ligji (ndihmë ligjore, mjekësore, psikologjike, si dhe masat mbrojtëse).
- Të analizojë faktorët e rrezikut që mund të çojnë në përshkallëzimin e dhunës
- Të lëshojë Urdhërin me Masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme, në rastet kur rezulton se rreziku që i kanoset viktimës është i lartë.
- Të plotësojë formularin Kërkesë-padi për Urdhër Mbrojtje/Urdhër të menjëhershëm Mbrojtjeje, kur i kërkohet nga viktimat.
- Të hetojë, të mbledh prova dhe dokumentojë dhunën, si dhe të vendos para përgjegjësisë ligjore autorin e dhunës
- Referon rastin pranë QPS për mbrojtjen e fëmijëve, dhe informon qendrën e durimit ku mëson fëmijë.

Në rastet urgjente kur bëhet fjalë për dhunën në familje policia në mënyrë të pavarur mund të shqiptojë masën e ndalimit për tu afruar shtëpisë apo personit të caktuar, që viktimës t'i garantoj siguri dhe të parandaloj dhunën në vazhdimësi. Rreth shqiptimit të kësaj mase policia informon edhe QPS dhe qendrat e edukimit ku mund të mësojnë fëmijët e moshave të mitura. Këtë urdhër policia së pari e shqipton gomarisht, pastaj brenda gjashtë orëve urdhërin e paraqet në mënyrë me shkrim. Urdhri i parë i ndalimit zgjatë gjithsej 48 orë. Pastaj në mënyrë të pavarur e vërteton gjyqtari hetues dhe në lidhje me vendimin e vetë jep vendim të posaçëm ku masën e policisë e zgjatë për 15 ditë.

Sipas ligjit të policisë, policia ka të drejtë të vendos një urdhër ndalimi personit të caktuar për shkak se ka konstatuar se ka ndodhur dhunë në familje apo ka hetuar se ekziston dyshimi se dhunuesi ka kërcënuar viktimën. Policia në këtë rast i jep autorit të dhunës një urdhër në të cilin përcaktohet fushëveprimi i masës. Me një fjalë në qoftë se policia dyshon se autori i dhunës ka kryer veprë penale apo kundërvajtje me shenja dhune dhe për këtë ekzistojnë shkaqet se do të ketë kërcnime për jetë, për sigurinë personale apo për lirinë e fëmijëve apo edhe të njeriut, duhet të jap urdhër mbrojtje i cili duhet të përmbaj:

- afatin sa do të zgjasë,
- për cilat persona është caktuar,
- vendi ku autori i dhunës nuk duhet të afrohet,
- ndalim i çdo lloj bezdisjeje apo kontakti nëpërmjet telefonikt në mënyrë SMS- si apo nëpërmjet postës ekektionike.

Si vendi që nuk guxon autori i dhunës t'i afrohet merret edhe banesa ku jeton viktimën, vendi i punës ku punon viktimën, ku shkollohet apo ku lëviz çdo ditë. Distanca vendoset për më së shumti 200 metra, si dhe nuk guxon të vijë në kontakt as edhe nëpërmjet mjeteve të komunikimit të fëmijëve deri te viktimën. Policia ka të drejtë të lëshoj urdhër ndalimin autorit të dhunës në familje, që në vendin e ngjarjes, ku autori i dhunës është i detyruar të dorëzoj çelësat e banesës dhe të lagrohet prej aty. Vendimet e policisë pastaj i sheshon gjyqtari apo gjyqtarja hetuese dhe ata mund që masën ta vërtetojnë, ta ndryshojnë apo edhe ta hedhin poshtë, por nëse e vërtetojnë masën e zgjasin për 15 ditë, masën që e ka lëshuar policia. Detyra e policisë është, që kur e lëshon urdhrin e ndalimit paqetë duhet ta informojë Qendrën për punë sociale, e informon edhe punonjës në entin e edukimit dhe shkollimit, ndërsa punonjësit në çerdhe dhe shkollë e informoni vetë në lidhje me urdhër mbrojtjen që keni dhe përmbajtjen e tij dhe ju e bëni shpërndarjen e kopjev nga urdhri i mbrojtjes. Nëse autori i dhunës e bezdis apo i afrohet menjëherë duhet ta informoni policinë dhe ata do ta largojnë nga vendi i caktuar. Gjatë kësaj kohe policia e ka për detyrë të bëjë mbykqyerjen dhe nëse autori i dhunës në familje vazhdon t'a shkel masën e lëshuar ai dënohet me gjobë prej 300 – 800 Euro. Policia ka të drejtë, që autorin e dhunës i cili në vazhdimësi e shkel urdhrin janë të detyruar që ta mbajnë mbyllur deri në 12 orë. (Faqja zyrtare e Policisë së RS.gp.policija@policja.si)⁷¹ Shkelja dhe vazhdimi i këtij urdhri në procedurat e veprimeve të

⁷¹ (Faqja zyrtare e Policisë së RS.gp.policija@policja.si)

dhunëshme sipas Ligjit mbi parandalimin e dhunës në familje do të paraqitet si rrethanë rënduese. Për të pasur një sigurim më të mirë dhe më afatgjatë ju duhet të bëni propozim për të zgjatur urdhrin mbrojtjen përpara gjykatësit apo gjyqtarës hetuese 3 ditë para se të skadojë afati i masës. Sidomos atëherë kur e shihni se kryersi i dhunës do të vazhdojë tju kërcënojë edhe pas skadimit të 10 ditëve për të cilat është vendosur urdhri i ndalimit. Dhe gjatë kësaj kohe deri sa zgjat masa, ju mund të merreni informata për të kaluar sa më mirë këtë situatë, ti merrni më me qetësi hapat në të ardhmen të pushoni nga dhuna si dhe të përgatiteni për fillim të procedurave të caktuara në të ardhmen. Duke ju dërguar dëshmi bindëse se shkelësi i masës ju kërcënon gjyqtarit dhe gjyqtarës mund ti propozofsh për vazhdimin e masës e cila zgjatë deri më 60 ditë, por ky propozim duhet të bëhet më së voni 3 ditë para skadimit të afatit të masës.

Dëshmitë duhet të jenë:

- Mosrespektimi i masës së ndalimit të afrimit sidomos gjatë sigurisë që e ka hetuar policia (për atë është e rëndësishme që nëse autori i dhunës e shkel urdhrin patjetër të ljamërohet policia),
- gjoba e shqiptuar nga mosrespektimi i masës së ndalimit,
- caktimi i paraburgimit të urdhëruar për shkak të mosrespektimin e masës së ndalimit,
- konstatimi i bezdisjeve nëpërmjet mjeteve të teknike (telefonit, kompjuterit)
- friga juaj e madhe nga kërcnimet e mëparshme
- kërcënimet e dhunuesit, të dedikuara për ju, por që u janë thënë personave të tretë,
- mosbashkëpunim i autorit të dhunës me Qendrën për sigurim social.

Në qoftë se ndodhin bezdisjet nëpërmjet telefonit në formë SMS-si apo thirje mos u merrni me atë se çka ju flet, por mjafton që telefonin ta hapni dhe ta mbani të hapur lidhjen së paku 5 sekonda para se ta ndërpritni thirrjen, sepse në këtë mënyrë ruhet thirrja në bazën e të dhënave dhe thirrjet të ruhen se këto janë dëshmi shumë të rëndësishme të dëshmimi se autori i dhunës ka shkelur masën e caktuar. Te shkeljet e masës së ndalimit merren edhe trysnitë që i bëhen viktimës nëpërmjet personave të tretë (personat e tretë mund të jenë

miqët tuaj, bashkpunëtorët tuaj, familjarët tuaj) ku nëpërmjet tyre përcjell porosi se çka do të bëj juve kur të mbaroj masa e caktuar.

Propozimin e masës së ndalimit është mirë, që ta shkruaj punëtori profesional i Qendrës për sigurim social, këshilltarja në organizatën joqeveritare e cila ka përvoja më të mira për këtë shkresë dhe në qoftë se keni të ardhura të mjaftueshme mund të lutni dhe një avokat apo avokate të ju ndihmojë në të shkruarit.

Zgjatja e masës së ndalimit të afrimit personit ose vendit të caktuar.

Siç e kemi cekur edhe më lartë paraqitja e dhunë në familje bëhet në stacionin policor më të afërt, i cili është kompetent për vendbanimin tuaj ose po në stacionin policorë ku ndodheni në vendin e ngjarjes. Ndodh që, në stacionin policor ku ka ndodhur ngjarja nuk kanë kompetencë territoriale për zgjedhjen e çështjes së viktimës, anda policët do të refuzojnë viktimën duke i shpjeguar se nuk kanë kompetencë territoriale për çështjen e tyre. Për denoncimin duhet të shkruahet një shkresë/shënim zyrtarë e jo procesverbal policor. Kjo mund të ju ndodh, që të njëjtin veprim ta bëjnë edhe në stacionin policorë i cili ka kompetencë territoriale për vendbanimin tuaj. Mirpo, ju duhet të insistoni me ngulm dhe t'i thoni polices apo policit i cili do të merret me çështjen tuaj të përpiloj një procesverbal, sepse shkresa zyrtare nuk do të thotë se ke bërë paraqitjen për veprën penale d.m.th procesverbal mbi pranimin e ankesës gojore. Pastaj, ata e dërgojnë në stacionin policorë i cili ka kompetencë territoriale për çështjen tuaj. Ky dokument mund të ju ndihmojë në procedurat e mëtejme, kushtu që, duhet të kërkonit që një kopje t'ju sigurojnë edhe juve dhe bashkë me dëshmitë e tjera t'i ruani që të mos i humbisni apo tu dëmtohen nga dhunuesi. Paraqitjen e veprës penale mund ta bëni edhe nëpërmjet telefonit në mënyrë anonime apo në faqen zyrtare të policisë nëpërmjet shkrimit me postë me letër të rekomanduar, por mund ta bëni paraqitjen e veprës penale të dhunës në familje edhe në prokurori dhe policia atë paraqitje do ta shqyrtoj kur të i'a dërgoj prokuroria. Gjatë paraqitjes në polici mund të ju shoqërojë një person, që ju më tepër i besoni dhe se, ai person mund të jetë punonjës në Qendrën për sigurim social i cili ju ofron mëshjetje psikike.

Që policija të j'u ndihmojë në mënyrë sa ma adekuate dhe të marr masa për ju dhe sigurinë tuaj i nevoiten sa ma shumë të dhëna nga ju dhe nga problematika e juaj në detaje.

Policisë i duhen shumë të dhëna, por më të rëndësishmet janë këto:

- përshkrimin e shkurtër me autorin e dhunës, sidomos faktet si jeni njohur dhe si ka qenë lidhja juaj në fillim,
- kur kanë filluar të paraqiten ndryshimet në lidhjen tuaj,
- kur ka filluar të paraqitet dhuna në lidhjen tuaj (ajo psikike, seksuale, ekonomike e fizike),
- si ka ndodhur kur autori i dhunës ka qenë i dhunshëm për herë të parë, dhe këtu duhet të bëhet një përshkrim në detaje (kur, ku si ka ndodhur dhuna dhe nëse ka pasur dëshmitarë),
- Informatën mbi dhunë ndaj fëmijëve gjegjësisht a ka ndodh dhuna në prezencë të tyre, si dhe përshkrimin e reagimit ndaj dhunës nga ana e tyre,
- përshkrim detal të rastit të dhunës së fundit (kur,ku, si, pse ka ndodhur dhuna dhe a ka pasur dëshmitarë)
- informata nëse autori i dhunës posedon ndonjë armë,
- nëse ka ndonjë raport mjekësorë, filmime, incizime dhe fotografim të lëndimeve trupore, (edhe policija vetë mund të bëj fotografime nëse lëndimet trupore janë të dukshme natyrisht me pëlqimin tuaj),
- shkrimet e ndryshme nëse keni në telefon me përmbajtje kërcënuese nga ana e autorit të dhunës,
- të dhëna mbi rastet e dhunës në të kaluarën, apo edhe ndërhyrjet e mëparshme të policisë, denoncimeve të mëpashme, gjykimet, dënimet në të kaluarën si dhe shqiptimin e masës momentale,
- përshkrimin e gjendjes se si ju jeni ndjerë në momentin kur ka ndodhur dhuna (p.sh e pa mbrojtur, e frikësuar, nuk ke mund të bëjë rezistencëetj)

Te momentet e dhënies së të dhënave rëndësi shumë të madhe ka se cilës gjini i takon viktimia dhe është mirë, që personi i cili i parashtron pyetjet të jetë i të njëjtës gjini, sepse kështu viktimia më së shpejti fiton besimin tek punonjësi i policisë dhe shprehet më lirshëm, sidomos kur janë prezente të gjitha format e dhunës. Dhe për fund nëse nuk jeni i/e kënaqur me punën e policisë mund të ankoheni ndaj punonjësit të policisë brenda 45 ditve, dhe ankesën e bëni

në Stacionin policorë apo Njësinë policore ku edhe e keni bërë paraqitjen e veprës penale të dhunës në familje. Dhe nëse edhe me këta nuk jeni të kënaqur ankimin tuaj mund ta drejtoni në Ministrinë e punëve të brendshme Njësia për ankim. Atëherë kur bëni paraqitjen e veprës penale mbi dhunën në familje duhet të paraqitni edhe propozimin për kërkesën juridiko pronësore, sepse si viktimë e dhunës në familje keni të drejtën në dëmshpërblim në pajtim me Ligjit mbi dëmshpërblimin ndaj viktimave të dhunës në familje. Këtë kërkesë e parashtron viktima ose të afërmit e viktimës në afat prej 6 muajve, por nëse lëndimet kanë qenë të asaj natyre që nuk ka qenë e mundur të parashtrorjë kërkesën atëherë mundet deri në tre muaj nga dita, që pasi kanë kaluar arsyet e mosparaqitjes edhe atë më së voni pesë vet nga dita e ndodhjes së veprës penale. Parashtruesit duhet të jenë shtetas të Sllovenisë apo shtetas të ndonjërit nga vendet e Bashkimit Europjan dhe këtë kërkesë e gjeni në faqen zyrtare të Ministrisë së drejtësisë. (priloga Nasilje! Kaj lahko storim? Špela Veseljič. Ljubljana društvo za nenasilno komunikacijo 2007)⁷²

Denoncimi penal

Policia pas pranimit të paraqitjes së veprës penale bisedon më të dyshuarin e kryerjes së veprës penale si dhe me dëshmitarët nëse ka dhe në bazë të dëshmive të mbledhura përpilon denoncimin penal.

1.4 Roli i policisë së RMV në parandalimin e dhunës së në familje

Ndodh që viktimat e dhunës në familje më së pari ta kontaktojnë stacionin më të afërt policorë me anë të një kërkesë në zonën ku banon apo ndodhet. Dhe organet e policisë kanë për detyrë të regjistrojnë raport të shkruar, si dhe të fillojnë hetimet. Duke mos qene një ngjare, që ndodh vetëm në shoqërinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, krimet që kanë të bëjnë me dhunën në famije, dhunën ndaj gruas apo antarëve të tjerë familjarë, nuk trajtohet me serioziteti sa duhet si llojet e tjera të krimeve nga ana e policisë. Mungesa e seriozitetit në trajtimin e këtyre çështjeve brenda familjes është një ndër pengesat kryesore në zvogëlimin e këtij fenomeni apo në parandalimin e pasojave që ndodhin nga ky fenomen. Për mënjanimin e rrezikut të drejtëpërdrejtë në rastet kur vleresohet se është shumë e nevojshme, apo kur ekzistojnë dyshime se një individ familjar po sulmohet apo dhunohet,

⁷² Priloga Nasilje! Kaj lahko storim? Špela Veseljič. Ljubljana društvo za nenasilno komunikacijo 2007

punonjësi i policisë mund të hyjë me forcë në një banesë private edhe nëse hyrja refuzohet nga pjesëtarë të tjerë të familjes. Arritja e forcave të policisë në vendin e ngjarjes së veprës penale është e rëndësishme sepse ato bëjnë vlerësimin e shenjave të domosdoshme të dhunës. Regjistrimi dhe identifikimi i këtyre shenjave kërkon një përgjegjësi të veçantë. Një vlerësim serioz dhe i kualifikuar i këtyre shenjave mund të pengojë pasoja më të rënda, pasi këto janë provat kyçe që organet e prokurorisë përdorin për të ngritur një akuzë ndaj dhunuesit.

Edhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut kur viktimë ose dikush tjeër bën denoncimin për dhunën në familje punonjësit e policisë vetë e vlerësojnë peshën e rastit dhe në bazë të vlerësimit i marrin këto të dhëna:

- së pari e vërteton kohën e thirrjes,
- merr të dhëna mbi personin i cili thëret në telefon,
- parashtron pyetjet Çka dhe kur ka ndodhur?
- kërkon t'i përshkruhet ngjarja,
- pyet a ka ndonjë të lënduar, mos ndoshta ka nevojë për ndihmën e shpejtë mjekësore,
- a janë të pranishëm dëshmitarët, sidomos nëse ka fëmijë dhe a mund të strehohen dikundi,
- pyet për vendndodhjen e viktimës, autorit të dhunës etj.

Gjithashtu vlenë se nëpunësi i policisë i cili e prano thirrjen duhet, që thirrjen e pranuar ta evidentojë në librat përkatës të ngjarjeve ditore. Të shënojnë emrin dhe mbiemrin se kush e ka pranuar thirrjen, kush ka shkuar në intervenim, kohën e thirrjes dhe të dhënat personale të atij, që ka bërë denoncimin, do të pyes për raportin viktimës me autorin e dhunës etj.

Gjatë shkuarjes në vendin e ngjarjes mundësisht shkojnë dy nëpunës policorë të gjinive të ndryshme dhe kanë për detyrë, që të ndërmarrin masa për mbrojtjen e viktimës të dhunës në familje dhe pengimin e sërishëm të autorit, që të kryej dhunë. Së pari sigurohen a posedon autori i dhunës ndonjë armë, që të sigurojnë apo të përgatiten me pajisje mbrojtjeje. Bisedat i zhvillojnë veçmas si me viktimën ashtu edhe me autorin e dhunës. Të tregohet profesionist në punën e tij dhe ta informoj viktimën për të gjitha të drejtat dhe shërbimet për mbrojtjen e

saj. Të lajmërohet në linjën SOS 15700 ose në numrin 15315. (Protokolli i përbashkët veprimi në raste të dhunës në familje, 2010)⁷³. Gjithashtu edhe me autorin e veprës penale zhvillohet e biseda dhe ai pyetet për për atë se a ka pasur në të kaluarën ngjarje të tilla e informojnë atë mbi masat e ndërmora kundër tij, për paralajmërim, paraburgim apo ndalim. Gjithashtu policët janë të detyruar të kontrollojnë vendin e ngjarjes dhe të konfiskohen armët nëse autori i dhunës i posedon. E në qoftë se autori i dhunës nuk pajtohet duhet që patjetër të merret një urdhëro për kërkim nga gjykata kompetente. Nëse viktimja është fëmijë, i mitur ose person me të meta, patjetër duhet të jetë prezent nëpunësi policorë inspektor i delikuencës së të miturve dhe përfaqësuesit të QPS. Masa e përkohëshme për mbrojtje largimi i kryerësit nga shtëpia dhe ndalimi për t'iu afruar shtëpisë shqiptohet në kohëzgjatjen prej së paku 10 dhe deri më 30 ditë. E nëse autori i dhunës nuk lagohet në mënyrë vullnetare nëpunësit e policisë janë të detyruar ta largojnë me forcë. Dhe ky lirim i dhunuesit në një kohë të shkurtër dhe pa marrë asnjë dënim nuk e ka zgjidhur asnjëherë problemin, por vetëm e ka përkeqësuar situatën edhe më shumë për viktimën, sepse ajo përsëri duhet të jetojë me dhunuesin. Gjithashtu, lirimi i menjëhershëm i dhunuesit nga policia ka përbërë rrezik për viktimat e dhunës dhe ka ulur besimin e tyre për t'iu drejtuar organeve të policisë në rastet e përsëritura të dhunës⁷⁴. Policia duhet ta pajisë viktimën me vendimin për kryerjen e një ekspertimi mjekoligjor. Këtë duhet ta kryejë menjëherë edhe në rastet kur mendon se ka ndodhur një akt, i cili mund të ndiqet vetëm nëpërmjet akuzës private, në gjykatë. Në qoftë se gruaja raporton krimin dhe policia nuk e merr seriozisht këtë raport të saj, ajo mund të hapë proces penal kundër policisë. Gjithashtu, ajo mund të bëjë ankesë në zyrën e Avokatit të Popullit për dhunim të të drejtave të saj. Por edhe kur ndodh që organet e policisë janë në dijeni se dikundi në familje ndodh dhuna dhe atë antarët e saj nuk e denoncojnë, ligji ka dhenë të drejtë policisë për të ndërhyrë. Policia sipas ligjit ndërhyrë edhe në këto raste të dhunës në familje. Në rradhë të parë ligji dënon ashpër aktet e tilla, prandaj punonjësit e policisë duhet të ndërhyjnë për të respektuar ligjin.

Ky respekti ndaj ligjit cilësohet si një ndër arsytet e para për ndërhyrjen e policisë në çdo kundërvajtje penale, dhe me të drejtë, kjo ndërhyrje ka si synim zbatimin e parimit të barazisë

⁷³ Protokolli i përbashkët veprimi në raste të dhunës në familje, 2010 RMV

⁷⁴ Dhuna në familje – përgjegjësitë që ka policia e shtetit për parandalimin dhe reduktimin e saj, 2008: http://www.undp.or.jp/undpandjapan/widfund/pdf/Albania_Manual%20for%20Policy%20Officers%20in%20Albania.pdf

para ligjit. Punonjësit e policisë duhet të ndërhyjnë për të vënë dhunuesit përpara drejtësisë. Punonjësit e policisë sidomos ato të emergjencës janë kontakti i parë me viktimën, këto punonjës të policisë duhet të jenë të trajnuar në mënyrë speciale dhe të mirëfillte, sepse këto kanë ndikim të madh mbi sjelljen dhe mënyrën se si ndihet emocionalisht viktimja në rastet e tronditjes. Normal, që kur viktimja merr në telefon punonjësit e policisë ndoshta ajo tërë jetën e vetë e ka imagjinuar këtë përballje dhe nuk ka pasur guximin e duhur dhe tani kur i'a arrin qëllimit, ajo shpreson që të ndihet e çliruar tregon të gjithë mllëfin e akumuluar dhe kërkon siguri pas bisedës dhe do që të jetë e sigurtë në ndjekjen e rrugës së duhur për të raportuar rastin. Nëse punonjësi i policisë nuk është i trajnuar mirë ndodh, që për raste të kësaj natyre, ndihmën që mund t'ju japin këtyre viktimave është jo e mirëfilltë apo minimale dhe mund, që te viktimat të lënë përshtypjen e frikës dhe mbi të gjitha ndodh, që në të ardhmen të mos raportojnë raste dhune në familje pasi kanë përshtypjen se përfshirja e policisë ka mundësi t'a përkeqësojë situatën e krijuar.

Punonjësi i policisë i cili merr telefonatën duhet:

- Të shtjelloj me hollësi çdo telefonatë që përfshin një rast të dhunës në familje, e cila sapo ka nisur apo është në zhvillim e sipër, personat që telefonojnë mund të jenë të pambrojtur dhe dhunuesi mund të jetë nën efektin e ndonje substance alkoolike ose narkotike me të cilin nuk mund të arsyetohet, prandaj shtjellimi i rasteve të dhunës në familje në zhvillim e sipër është shumë i rëndësishëm.
- Pas njoftimit të policisë për incidentin e ndodhur, punonjësit e emergjencës duhet të veprojnë në kohë sa më të shkurtër për të dërguar patrullat në vendin e ngjarjes.

Telefonatat e rasteve të dhunës në familje mund të jenë nga vetë viktimja dhe na le për të kuptuar që, viktimja që raporton incidentin mund të jetë në gjendje të rënduar psikologjike dhe punonjësi i policisë duhet të ketë parasysh se mund edhe të mos marr të gjitha përgjigjet e duhura nga viktimja. Punonjësi duhet të vlerësojë telefonatën për rastin e dhunës në famije si rast urgjence për ndihmë të menjëhershme dhe më pas të marrë të gjitha masat për njoftimin dhe dërgimin në vendin e ngjarjes të grupit hetimor për kryerjen e veprimeve procedurale.

- Në qoftë se viktimë ndjen pa siguri te punonjësi i policisë shkaku se nuk e konsideron në mënyrë serioze telefonatën dhe situatën e ndodhur, ajo jo vetëm që nuk do vazhdojë më tej telefonatën, por do të humbë besimin do të zhgënjehet nga përgjegjësia e policisë dhe do t'i hudhë poshtë të gjitha idetë se policia të ndihmon, apo ke ku të gëshë mbështetje në rastet kur ndodh dhuna në familje. Policia ndodhet aty për të ndihmuar, duhet të tregojë kujdes për sigurinë e viktimës, ta ndihmojë atë të heqë frikën dhe të jetë më e gatshme për të bashkëpunuar me të gjithë. Të mbajë gjithmonë parasysh se viktimës mund t'i jetë thënë në mënyrë të përsëritur e të vazhdueshme nga dhunuesi se, nëse ajo do të kërkojë ndihmë askush nuk do ta dëgjojë atë. Polici duhet që të jetë bazament bindës për viktimën se siguria e saj është prioritet për policinë dhe se viktimë nuk është fajtorë, por fajtorë është ai i cili e ka ushtruar dhunën.

Dhe e gjithë rrjedha e procedurës se si t'i parashtrijë pyetjet punonjësi i policisë kurrë raportojnë rastin e dhunës në familje kur bëjnë hetimin dhe gjatë si dhe marrja në pyetje e të dyshuarit, marrja në pyetje e dëshmitareve, intervistimi është i ngjashëm me atë të policisë në R. e Sllovenisë.

2 Roli i Prokurorisë në parandalimin e dhunës në familje

2.1 Roli i prokurorisë sllovene në parandalimin e dhunës në familje

Numri më i lartë i denoncimeve rreth dhunës në familje në Republikën e Sllovenisë ka qenë në fund të vitit 2008 dhe po atë vitë pësoi ndryshimi i Kodi Penal në fushën e dhunës në familje. Në këtë kohë u paraqitën edhe shumë akte ligjore, u miratua edhe Ligji mbi parandalimin e dhunës në familje, shoqëria informojë me të madhe filloj dhe të bëhet më pak tolerante ndaj këtij fenomeni, viktimat kishin më shumë guxim të bënin denoncimin, kompetencat gjyqësore për veprat penale të dhunës në familje u shpërngulën nga gjykata e rrethit në atë të qarkut. E pa ndryshuar mbeti kompetenca gjyqësore vetëm në shembullin e paragrafit të 3 të nenit 191 të Kodit penal nga vitit 2008, ku dhuna ushtrohet kundër tjetrit, me të cilin dhunuesi jeton në bashkësi dhe dhuna me atë bashkësi është e lidhur. Ka pasur edhe shumë risi në sanksionet penale, ku të pandehurin përveç dënimit me kusht mund ti përcaktohej edhe mbykqyerje, ndihmë në lidhje me risocializim ndërsa viktimë largohet nga

dhunuesi. Deri në atë kohë, kryesi i dhunës në familje ndiqet penalisht sipas nenit 299 të Kodit Penal të Republikës së Sllovenisë.

Sipas legjislacionit të ri, vepra penale e dhunës në familje ndiqet sipas detyrës zyrtare dhe jo me propozimin e viktimës. Në realitet ndodh, që viktima të bëj denoncimin, kur dhuna në familje është shumë e rëndë ose po kur dhunuesi ka filluar të ushtroj dhunë edhe ndaj fëmijëve, apo nuk mund t'i anashkalojmë shumë fjalë siç janë rrëzime nga shkallët apo u pengova dhe rrash dhe prandaj e kam këtë të nxirë këtu. Këto nuk janë vetëm fjalë të përsërituara shumë herë, por janë ngjarje të vërteta nga jeta e shumë grave të cilat kanë përjetuar dhunë në mënyra të ndryshme, të cilat nuk mund të i'a pranojnë vetes, po aq edhe ma pak të tjerëve se në jetën e tyre po ndodh diçka e gabuar.

Detyra e prokurorit publik është të ndjek penalisht autorët e dhunës. Është detyrë e rëndësishme sepse prokurori duke ndjekur penalisht autorin e dhunës e lehtëson viktimën, që të fillojë vetë procedurat kundër kryesit të veprës.

Detyrat e prokurorit të shtetit në procedurat paraprake dhe në procedurat penale janë: (Nina Obrn, Nasilje nad ženskami, Praktični vodnik po sodnih in upravnih postopkih 2014)

- drejtimi i procedurave paragyqësore
- masat , që janë të rëndësishme për zbulimin e veprave penale (bashkëpunimi me policinë),
- paraqitja e kërkesës për hetim,
 - ngritja e një aktakuze, propozim akuze
- ankesë ndaj gjykimeve jo përfundimtare ose përdorimi i mjeteve juridike të jashtëzakonshme në vendimet përfundimtare.

Kur prokurori publik ka prova dhe kur vlerëson se baza ligjore do të jetë e mjaftueshme për të akuzuar kryesin, ai ngrit një aktakuzë në gjykatën kompetente. Në rast se ai ka nevojë për më shumë prova mundë, që nga gjykata kompetente të kërkojë hetime. Gjyqtari hetues udhëheq hetimin, por i njëjti gjyqtar nuk mund të gjykojë në seancën kryesore. Prokuroria shtetërore ka mundësi, që në rastin e veprës penale për të cilën është paraparë dënimi me burgim deri në tre vjet ose me gjobë, mund të kalojnë në procedurë pajtuese vetëm nëse të dy palët bien dakord si i dyshuari po ashtu dhe pala e dëmtuar. Nëse viktima dhe kryesi bien dakord,

prokuroria shtetërore do të tërheqë ankesën. Të sqaroj edhe diçka se në këtë vit nuk u ritën denoncimet penale, vetëm pse u ndryshu ligji, por shoqëria u informua më shumë, shumë trajnime arsimore u bënë në këtë drejtim ku morën pjesë edhe prokurorë, kriminalist dhe gjykatës ku kishin trajnime të natyrës juridike dhe psikologjike. Vepra penale e dhunës në familje është e rradhitur në veprat penale kundër lidhjes martesore, kundër familjes dhe fëmijëve. Dhe për këtë vepër penale parashihet dënimi deri me pesë vjet burg, dhe nëse autori i dhunës ushtron dhunë ndaj një personi me të cilin ka jetuar në bashkësi martesore ose në ndonjë lidhje tjetër, e cila është zgjidhur më parë dënohet me burgim deri në tre vjet. Ky dallim në dënim është i pa nevojshëm, sepse në praktikë shpeshherë ndodh që dhuna pas divorcit shëndrohet me format tjera të dhunës në familje, siç janë përndjekja apo edhe kalon në dhunë ende më të tmerrshme, ku për viktimën mund të jetë edhe shkatërruese.

2.2 Roli i prokurorisë maqedonase në parandalimin e dhunës në familje

Prokuroria Publike përcaktohet si organ i vetëm dhe i pavarur shtetëror që i ndjek autorët e veprave penale dhe të veprave të tjera të dënueshme me ligj, e po ashtu kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj⁷⁵. Kallzimi penal mund të bëhet në disa mënyra edhe atë nëpërmes pajisjeve elektronike, me shkrim në mënyrën verbale te prokurori si dhe nëpërmes telefonit. Kallzimi penal kur bëhet përmes pajisjeve elektronike, atëherë duhet të mbahet evidencë e kallzimit penal në regjistrin përkatës. Edhe në mënyrën tjetër me shkrim dhe dorëzim prokurori publik së pari ka për detyrë t'ju tërheq vërejtjen për pasoja juridike parashtruesve për kallzim të rrejshëm penal, ndërsa për raportet në mënyrë me gojë prokurori publik harton procesverbal dhe evidentohet në regjistrin e kallzimit penal. Ndërsa në rastet kur bëhet kallzimi penal nëpërmjet telefonit prokurori publik në këtë rast harton shkresë zyrtare dhe edhe kjo shkresë evidentohet në regjistër për kallzime penale. Në kallzimet penale kur paraqiten dhunë në familje, veprojnë prokurorët e prokurorive të trajnuar dhe të cilët kanë njohuri adekute për këtë fushë. Kështu që në pajtim me Ligjin për Procedurë Penale për veprat penale të cilat ndiqen në mënyrë zyrtare kanë për detyrë t'i dorëzojnë të gjithave organeve shtetëror, institucioneve publike. Me dorëzimin e kallzimit parshtruesit do t'i

⁷⁵ <https://jorm.gov.mk/sq/organizimi-i-prokurorisë-publike-te-republikes-se-maqedonise-se-veriut/>

theksojnë dëshmitë e njohura dhe do të ndërmarrin masa për ruajtjen e gjurmëve të veprës penale.

Në lëndët e veprave penale, për të cilat parashihet përndjekje sipas detyrës zyrtare, prokurori publik (PP):

- i udhëzon veprimet e organeve kompetente në drejtim të zbulimit dhe kallëzimit të veprave penale dhe autorëve të këtyre,
- propozon ose jep urdhër për të ndërmarrë masa të posaçme të hetimit, me kushte dhe mënyra të përcaktuara me LPP-në,
- jep urdhër dhe e realizon procedurën e hetimit,
- propozon, gjen dhe siguron dëshmi,
- përfaqëson dhe dorëzon padi para gjykatës përkatëse,
- nga mundësitë, që ka në dispozicion ndërmerr edhe veprime tjera të parapara me ligj.

Prokurori publik e drejton procedurën parahetimore, gjatë së cilës e ka në dispozicion policinë gjyqësore, mirëpo edhe vetë mund t'i ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për zbulim të veprës penale, gjegjësisht zbulim dhe përndjekje të autorit të veprës, për çka është i autorizuar me ligj. Bashkëveprimi në mes të Prokurorit dhe viktimës së dhunës në familje zakonisht vjen në shprehje në procesin e mëvonshëm të raportimit. Prokurorët i vlerësojnë rastet e dhunës në familje dhe shkeljet e urdhërave mbrojtës për të përcaktuar nëse ka prova të mjaftueshme për t'i ndjekur kryesit e dhunës në familje⁷⁶.

3. Roli i gjykatave në parandalimin e dhunës në familje

3.1 Roli i gjykatave sllovene në parandalimin e dhunës në familje

Gjykata është subjekt themelor i procedurës penale. Ajo në këtë procedurë e ushtron funksionimin e gjykimit dhe në punën e saj është e pavarur dhe vendos në bazë të ligjit. Në Republikën e Sllovenisë kemi këto lloje të gjykatave edhe atë: Okrajno sodišče(44) – Gjykata

⁷⁶ <https://abgj.rks.gov.net/assets/cms/uploads/files/Publikimet%20ABGJ/Procedurat%20Standarte%20të%20Veprimit%20për%20Mbrojtje%20nga%20Dhuna%20në%20Familje.pdf>

e rrethit, Okrožno sodišče(11) – Gjkata e Qarkut, Višje sodišče – Gjkata e Lartë, Vrhovno sodišče – Gykata Supreme dhe Specializirana Sodišče – Gjkata të specializuara. Ligji mbi parandalimin e dhunës në familje i vitit 2008 u miratua edhe për vënien e bashkupnimit të organeve dhe organizatave të ndryshme të trajtimit të dhunës në familje. Ky ligj rregullon kuptimin e dhunës në familje dhe rregullon ato marëdhënije mes njerëzve të cilat janë më të të ndieshme dhe njëkohësisht deri diku edhe të natyrës konfliktuaoze. Prandaj këtu gjatë shqiptimit të masave gjykata duhet të ketë kujdes të madh kur të peshojë provat se cilat sjellje do të konsideroheshin si vepra penale dhe cilat jo. Nenet 19, 21 dhe 22 të Ligjit për parandalimin e dhunës në familje përcaktojnë masat, që gjykata do t'i shqipton dhunuesit. Sipas paragrafit të parë nenit 19 të Ligjit mbi parandalimit të dhunës në familje gjykata shqipton këto masa:

- ndalon hyrjen në banesë, ku jeton viktimja;
- ndalon që të qëndrojë në afërsi të caktuar banesës ku jeton viktimja
- ndalon qëndrimin dhe afrimin vendit ku zakonisht viktimja lëviz (p.sh. punon, shkolla, çerdhja ...)
- ndalon të gjitha kontaktet me viktimën në të gjitha mënyrat, përfshirë edhe kontaktet me mjetet e komunikimit nga largësia apo edhe përmes personit të tretë;
- ndalon çdo lloj takimi me viktimën;

Këto masa nga paragrafi i parë gjykata mund ti shqiptojë edhe kur:

- nëse dhunuesi i ka kërcënuar viktimën se do ta dëmtojë
- nëse dhunuesi ka hyrë në mënyrë të kundërligjshme në banesën ku është viktimja, ku punon dhe jeton;
- nëse dhunuesi e përngjek viktimën, në mënyrë fizike apo nëpërmjet mjeteve të komunikimit; (Paragrafi i dytë i nenit 19 LPDHF të Republikës së Sllovenisë Uradni list)

Dhe në këtë mënyrë gjykata shqipton masën e ndalimit sipas paragrafit të parë me kohëzgjatje prej 12 muajshë (paragrafi i tretë i LPDHF). Në nenin e 20 të këtij ligji kemi të bëjmë me masat për sigurimin e fëmijës edhe atë masat që përcakton janë këto:

- ndalon kalimin e kufirit shtetërorë fëmijës, vetëm në raste me personin e caktuar ose me organin ose me organizatën;
- propozon marrjen e dokumentit të identitetit në pajtim me ligjin;
- ndalon lëshimin e dokumentit në bazë të kërkesës vetëm nga ana e njërit prind, të dy prindërve apo të personit të tretë;
- ndalon dhënien e dokumentit personal të fëmijës njërit apo të dy prindërve ose po personit të tretë;
- vendos për kontrollat dhe intervenimet mjekësore të fëmijës.

Në nenin 21 dhe 22 të Ligjit mbi parandalimin e dhunës në familje përcakton në rastin e divorcimit bashkëshorti apo viktima nëse dhunuesi kau shtruar dhunë edhe ndaj fëmijëve të kërkojë që dhunuesi të ja lë në përdorim banesën ku jetojnë gjegjësisht kanë jetuar bashkë. Gjykata e kufizon masën për një kohëzgjatje 6 muajshe me të drejtë vazhdimi edhe për 6 muaj tjera. Bashkshortit nëse i lihet banesa në përdorim atëherë ai i paguan vetë të gjitha shpenzimet në lidhje me banesën. Dispozitat e këtij neni vlejné edhe për partnerët jashtëmartesor. (LPDHF neni 21 dhe 22 i RS ZPND Uradni list št.54/17z dne 29. 9. 2017) ⁷⁷

Procedura hetimore

Në qoftë se prokurori ose prokurorja publike vlerësojnë se për akuzën ju nevojiten edhe më shumë dëshmi, atëherë ajo propozon procedurën e hetimit. Në këtë procedurë do të bëhet dëgjimi ku viktima e dhunës në famije mund të keni pranë personin, që i besoni më shumë, por nuk guxon të jetë personi si dëshmitar në procedurën penale e njëjta vlen edhe për seancën kryesore, ku në prezenc mund të jenë: mbrojtësi, mbrojtësi i dhunuesit dhunuesi dhe prokurori/prokurorja. Në këtë dëgjim përshkruhet ngjarja si ka ndodhur dhe pas dëgjimit mund të kontrolloni shkresën që është shkruar. Pas mbarimit të procedurës hetimore gjygtarja apo gjyqtari hetues ja dërgojné dosjen prokurorit ose prokurores publike dhe ata pastaj janë të detyruar që më së voni bernada 4 muajve të paraqesin aktakuzën në gjykatë, propozon plotësimin e hetimit ose deklaron, që të tërhiqet nga ndjekja. Dhe gjithashtu lajmërohet mbi masat, që janë marrë në lidhje me akuzën e personit që ka parashtuar atë.

⁷⁷ (LPDHF neni 21 dhe 22 i RS ZPND Uradni list št.54/17z dne 29. 9. 2017)

Masat kufizuese

Kur gjykata e shqyrton kërkesës dhe shqipton masat mbrojtëse për parandalimin e dhunës në familje, që mbrojnë personin që i është ekspozuar dhunës, duke i mënjeluar rrethanat që ndikojnë apo mund të ndikojnë në kryerjen e veprave tjera. Te masa mbrojtëse e ndalimit të afrimit viktimës së dhunës në familje, mund ti shqiptohet personit të cilit ka kryer dhunë në familje nëse ekziston rreziku që të kryej dhunë përsëri. Tek urdhri me të cilin shqiptohet kjo masë, gjykata cakton vendin, regjionin, dhe largësinë në metra, brenda të cilës kryesi nuk guxon ta shkel. D.m.th. nuk guxon t'i afrohet viktimës së dhunës në familje. Nëse e shke, atëherë gjykata do të përcaktoj paraburgimin. Viktima ka për detyrë që ta njoftoj gjykatën për çdo shkelje nga ana e dhunuesit, gjithashtu edhe viktima nuk guxon ta shkel këtë urdhër sepse në qoftë se viktima e shkel këtë urdhër atëherë gjykata do ta dënojë me dënim me të holla. Ky ndalim i lëshuar në pajtim me Kodin e procedurës Penale nuk e ndalon komunikimin apo përndjekjen nëpërmjet mjeteve të komunikimit siç endlon Ligji i policisë (ZNPPol) dhe ndalimi sipas veprave penale të dhunës sipas Ligjit mbi parandalimin e dhunës në familje. Masën e ndalimit personit apo vendit të caktuar e cakton gjyqtari/gjyqtaria hetuese me propozimin e prokurorit apo prokurores shtetërore. Masa zgjat një muaj, nga dita kur ka filluar të vlejë dhe mund të zgatet edhe më së shumti për dy muaj. Nëse gjatë rrjedhës së procedurës për vepër penale ku dënimi me burgim mund të jetë mbi 5 vite masat mund të zgjaten edhe për tre muaj. Nëse palët kanë fëmijë atëherë kujdestaria i besohet përkohësisht viktimës së dhunës në familje, ndërsa kryerësit të dhunës i hiqet përkohësisht e drejta prindërore. Masat mund të jenë: thirrja, urdhërarresti- shoqërimi, paraburgimi, arresti shtëpiak, ndalimi personit të caktuar ose vendit, dorëzania dhe masa tjera të cilat janë të përcaktuara në Kodin e procedurës penale dhe në Ligjin mbi parandalimin e dhunës në familje. Tabela 2: Ndalimi i afrimit dhe paraburgim sipas Ligjit mbi procedurën Penale

(Burimi marr nga doracaku Nasilje nad ženskami 2014 DNK)

KUSH PROPOZON	E	PROKURORI PROKURORJA SHTETËRORE/I/ E DËMTUARA
PROCEDURA	E RREGULLT	E SHKURTUAR

KUR CAKTOHET	Para parashtrimit të akuzës	Pas parashtrimit të akuzës	Para se të parashtrohet propozimi për akuzën	Pas parashtrimit të propozim akuzës
SA KOHË ZGJATË	Një muaj vazhdimi edhe për dy muaj (për vepra penale mbi pesë vite mund të zgjatet edhe për tre muaj d.m.th gjithsej gjashtë muaj)	2 vite	15 ditë	2 vite
KUSH PËRCAKTON	E Gjyqëtarja/gjyqëtari hetues	Gjykata, që e shqyrton këtë çështje	Gjyqtari/gjyqtare e vetme	

Seanca paraprake

Në seancën paraprake, i pandehuri ka mundësi të shpreh qartësinë dhe nëse e pranon fajsinë gjykatësi menjëherë cakton mbledhjen për shpalljen e sanksionit ndërsa gjykata pastaj shpall aktgjykimin e fajësisë. Por nëse i pandehuri nuk e pranon fajsinë atëherë procedura vazhdohet në shqyrtimin kryesorë.

Shqyrtimi kryesorë

Kur prokurori i shtetit gjykon se ka prova të mjaftueshme për fajësinë e të pandehuri vendos, që të dërgoj çështjen në gjykatë. Dhe për këtë qëllim ai përpilon aktakuzën në të cilën tregohen të dhënat personale të të pandehuri dhe të dhënat personale të të dëmtuarit nga vepra penale. Aktakuza, paraqitet pas përfundimit të hetimit. Për fillimin e shqyrtimit gjyqësor thirren i akuzuari, mbrojtësi i tij, paditësi, i dëmtuari, përfaqësuesi ligjor, përfaqësuesi i autorizuar dëshmitarët dhe ekspertët si dhe përkthyesi nëse është nevoja. Shqyrtimi kryesorë si zakonisht është publik, që do të thotë mund të marr pjesë çdokush, që i përket moshës

madhore. Raste të rralla janë kur gjykata vendos përjashtimin e publikut. Gjykata më së pari e thëret të pandehurin e vërteton identitetin e tij si dhe ja sqaron të drejtat e tij. Pastaj prokurori ose prokurorja e paraqet aktakuzën i pandehuri mund vetëm të përgjigjet në lidhje me të. Nëse don që të deklarohet gjykata e dëgjon. Pastaj e dëmtuara merret në pyetje në të njëjtën mënyrë së pari pyetet për të dhënat personale, ashtu si në procedurën hetimore mundet që gjyqtarit apo gjyqtares ti thoni se doni që adresa e juaj të mbetet e pa zbuluar për qëllime sigurie. Nëse nuk mundeni të shprehni lirshëm sepse është prezent edhe i pandehuri mund gjykata të urdhërojë që i pandehuri të largohet nga salla e gjyqit për një kohë të shkurtër. Dhe i pandehuri kur kthehet gjykatësi apo gjykatësja do të ia lexon atë çka keni deklaruar ju ose do të dëgjohej incizimi nëse deklarimi është incizuar. Për ardhjen në gjykatë gjykata ju paguan shpenzimet e rugës dhe ato mund menjëherë ti merrni pas mbarimit apo ndonjë ditë tjetër. Por atëherë kur personi i cili deklarohet në gjykatë dhe nuk është i moshës 18 vjeçare duhet vazhdimisht ta ketë pranë gjatë gjithë rrjedhës së seancës personin e autorizuar afër. Nëse gjatë zbulimit të të dhënave tuaja pëson rrezik serioz për jetën dhe trupin tuaj, apo ndonjë të afërmit tuaj atëherë gjykata ndaj propozimit tuaj mund të përcaktojë ndonjëherë nga masat mbrojtëse:

Fshirjen e të gjitha apo të ndonjëherë nga të dhënat e tuanga shkresat penale,

Shënimi i të gjithave apo të disave të dhënave për sekret zyrtar,

Urdhëron të pranishmit që duhet të ruajnë në fshehtësi veprime apo të dhëna,

Përcakton pseudonime të dëshmitareve,

Dëgjimin e bën nëpërmes mjeteve teknike sidomos ndryshimi e zërit(deformimin e zërit)

Përndryshe ligji nuk e lejon që dëshmitari të jetë në përgjithësi anonim, vetëm në rastet kur është dëshmitarë kundër të akuzuarve për vepra të rënda apo shumë të rënda penale.

Pas procedurës së provave gjykatësi ju jep fjalën të gjithëve me rradhë: së pari të dëmtuarën mbrojtësin e të pandehuri prokurori, prokurorja dhe më në fund të pandehurit.

Aktgjykimi

Aktgjykimi në procedurën penale është akt formal kryesor që e nxjerr gjykata ku me të cilin zgjidhet çështja e caktuar. Si vendim gjyqësor aktgjykimi nxiret në emër të popullit dhe nga momenti që merr formën e prerë ka fuqinë e ligjit në lidhje me çështjen konkrete.

Gjykata pas barimit të shqyrtimit kryesorë shpall aktgjykimin. Të pandehurin e mund ta shpall fajtor, të pafajshëm ose mund ta liroj nga akuza ose akuzën e refuzon. Nëse i pandehuri shpallet fajtor, gjykata dënon me dënim me burgim ose dënim me të holla dhe ndalimi i drejtimit të automjetit. Sidoqoftë, në raste të caktuara, të pandehurit mund t'i jepet një dënim me kusht. Por gjatë kësaj kohe fajtori nuk duhet të kryej asnjë tjetër vepër penale dhe kjo periudhë mund të zgjasë më pak një vitë dhe më së shumti pesë vite. Gjykata gjithashtu do të vendosë që fajtori do të jetën nën kontrollin, që parasheh ndihma profesionale që do ti afrohet tij dhe këto detyra përmbajë:

Shërim në entin profesional me pajtim të shërimit nga drogat apo mvarshmëritë nga alkooli dhe substancat e tjera;

Vizitim i mjekëve profesional, që ju ofrojnë ndihmë njerëzve në këtë gjendje;

Trajnim për një profesionapo edhe ndihma, që i ofrohet për një punësim adekuat, që ju përgjigjet aftësive të fajtorit;

Ndalimi i afrimit viktimës apo ndonjë personi tjetër;

Ndalimi i shoqërimit me personat e caktuar;

Ndalimi i hyerjes në vende të caktuara.

Tabela:

VIKTIMA	- Denoncimi penal
POLICIA	- Ndalimi i afrimit, kontrolli i masës - Mbledhja e të dhënave - Denoncimi penal - Ekzekutimi i veprimeve hetimore
PROKURORIA	- Aktakuzë direkte - Kërkesë për hetim - Denoncimin penal ja kthen policis për përmbushje - Hedh poshtë denoncimin penal
GJYKATA	- Mbledhja paraprëgatitore - Shqyrtimi kryesorë - Gjykimi - Ankimi

Pasqyrim nga paraqitja e veprës penale mbi dhunën në familje deri te vendimi i gjykatës⁷⁸

3.2 Roli i gjykatave maqedonase në parandalimin e dhunës në familje

Gjykatat i shqyrtojnë mirë rastet e dhunës në familje. Këto raste trajtohen nga gjykata në procedurë civile apo penale varësisht nga natyra e rastit. Në raste të rralla gjykatat janë ofruesit e parë të shërbimeve që ballafaqohen me viktimën e dhunës në falmije. Edhe pse gjykata nuk inicon procedurat lidhur me rastet e dhunës në familje, nuk është pasive në obligimet e saj ndaj rasteve të dhunës në familje. Gjykatat, kanë përgjegjësinë e trajtimit të palëve dhe individëve që shfaqen para tyre, në mënyrë të paanshme, dinjetoze dhe me

⁷⁸ Doracaku Nasilje nad ženskami 2014 DNK

respekt, duke siguruar mbrojtje adekuate për të gjitha palët e përfshira në procedurë. Në procedurë civile, gjykatat shqyrtojnë kërkesën për urdhër mbrojtje ose urdhër mbrojtje emergjente dhe shqiptojnë masat mbrojtëse të parapara me ligj. Në procedurë penale, Organet hetuese janë kompetente të vendosin për rastet e ndjekjes penale të kryerësve të dhunës në familje, të cilët kanë shkelur urdhërin për mbrojtje, ose personat që kanë kryer veprë penale në marrëdhëniet familjare. Gjykatat kanë për obligim që t'i njoftojnë të gjitha palët në procedurë për të drejtat që i përkasin atyre, si dhe pasojat e mosveprimit të tyre.

4. Roli i organizatave joqeveritare

4.1 Roli i OJQ sllovene në parandalimin e dhunës në familje

Që nga fundi i viteve 1980, dhuna ndaj grave dhe fëmijëve, si viktimat më të shpeshta të dhunës në familje dhe viktimat e dhunës në përgjithësi, është trajtuar kryesisht nga organizatat joqeveritare, të cilat kanë qenë të parat që kanë ofruar forma të posaçme të ndihmës. Dhuna në familje nuk ishte një temë klasike e institucioneve të mirëqenies sociale deri në mes të viteve 1990 shteti filloi financimin e këtyre programeve përmes tenderëve të rregullt publik për mbrojtjen sociale dhe sot i financon ato në masën e parashikuar nga Rezoluta për programin kombëtar të mbrojtjes sociale 2006-2010. Shteti financon 10 dhjetë shtëpi amnore, 13 shtëpi të sigurta dhe tre qendra krize. Në këto qendra ofrohen edhe disa programe të ndihmës psikosociale dhe telefonat e krizës për viktimat e dhunës dhe një program i veçantë për këshillim adekuat autorit të dhunës. OJQ-të në fushën e parandalimit të dhunës merren me forma dhe lloje të ndryshme të dhunës: me dhunën psikologjike, fizike, seksuale, ekonomike, dhunën në familje, në marrëdhëniet me partnerët, në marrëdhëniet farefisnore, dhunën në punë, ngacmimet seksuale në vendin e punës, dhuna nga kolegët, dhuna ndaj të moshuarve, dhunën kundrejt personave me aftësi të kufizuara, dhunën ndaj personave me çrregullime të shëndetit mendor, me dhunën e trafikimit të njerëzve si dhe me lloje të ndryshme të diskriminimit.

OJQ-të për parandalimin e dhunës ofrojnë ndihmë dhe mbështetje psikosociale viktimave të dhunës në zgjidhjen e problemeve të shkaktuara nga përjetimi i dhunës, personat që shkaktojnë dhunë. Ata paraqesin raporte në emër të viktimës ose dëshmitarit të dhunës dhe

japin këshilla drejtuese në lidhje më shqyrtimin e rasteve individuale të dhunës. Ata zbatojnë programe këshillimi nëpërmjet telefonit, ofrojnë ndihmë juridike dhe këshillim personal për të drejtat, detyrat dhe si të mbrohet, aftësive sociale për kryerësit e dhunës.

Ata organizojnë dhe kryejnë veprimtari parandaluese për edukim, informim dhe ndërgjegjësimi të publikut profesional dhe më gjerë (leksione, punëtori, tryeza të rrumbullakëta, konferenca, konsulta me ekspertë, fushata të ndërgjegjësimit për media).

Ata bashkëpunojnë profesionalisht me institucionet shtetërore dhe OJQ-të e tjera në bazë kurative nivelin, në trajtimin e rasteve individuale të dhunës, si në nivelin parandalues, në organizimin dhe kryerjen e takimeve profesionale dhe aktiviteteve parandaluese për publiku. Ata botojnë materiale edukative dhe informuese dhe botime profesionale me sferat e parandalimit të dhunës ndaj grave, fëmijëve dhe familjes.

Ato gjithashtu luajnë një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në zhvillimin dhe hartimin e programevendihma, legjislacioni dhe politika në fushën e dhunës ndaj grave, dhunës ndaj fëmijëve dhe dhuna në familje.

Organizatat joqeveritare nga fusha e parandalimit të dhunës në familje dallohen nga puna praktike e tyre që bëjnë, lloji i ndihmës që ofrojnë. Përparsitë e tyre janë se ata mund të specializohen për një fushë, ku institucionet shtetërore, që punojnë në fushën e parandalimit të dhunës në familje, mbulojnë një numër shumë të madh problematikave tjera. Ndër Organizatat Joqeveritare më të njohura në Slloveni që viktimave të dhunës ju ofrojnë ndihmë psikosociale janë:

- **Društvo SOS telefon za ženske in otroke/žrtev nasilja (Shoqata Društvo SOS telefoni për fëmijë dhe gra – viktimat të dhunës në familje), (<http://www.drustvo-sos.si/>)**
- **Društvo Ženska svetovalnica(<http://www.drustvo-zenska-svetovalnica.si/> Shoqata Zhenska svetovalnica,**
- **Mirovni inštitut (<http://www.mirovni-institut.si/>),**
- **Društvo za nenasilno komunikacijo (<http://www.drustvo-dnk.si/>) Shoqata për komunikim jo të dhunshëm**

- Zavod EMMA,(<http://www.zavod-emma.si>),Enti Emma – qendra për ndihmë viktimave të dhunës,
- Združenje proti spolnemu zlorabljanju (<http://www.spolna-zloraba.si>), Bashkimi kundër keqtrajtimit seksual,
- Društvo Kjuč/ Center za boj proti trgovini z ljudmi <http://www.drustvi-kljuc.si>),Shoqata Ključ – qendra për luftën kundër tregtimit me njerëz,
- Svetovalni center za otroke, mladostnike in starše (<http://www.scoms-lj.si>) Qendra këshillimore për fëmijë të rritur dhe prindër,

Društvo Center za pomoč mladim v stiski (<http://www.cpm-drustvo.si>) Shoqata Qendra për ndihmë të rijëve në shqetësim.

Strehimoret ofrojnë shërbime të specializuara për viktimat e dhunës, që së pari viktimave ju mundësojnë mbrojtjen, rehabilitimin dhe riintergrimin si dhe janë shumë të suksesshme në punën e tyre gjatë ndihmës që ju ofrojnë grave për largimin nga marrdhëniet e dhunshme. Janë si shtëpitë e zakonshme, por që dallohen me masat të cilat zbatohen për sigurimin dhe ruajtjen e banuesve në ato shtëpi dhe lokacioni nuk është publik, që do të thotë adresa e tyre qëndron rreptësisht anonime.

Strehimoret për ofrim ndihme dhe këshillimi janë të hapura çdo ditë në javë si dhe gjatë vikendeve dhe festave. Ndhimojnë shumë në vetëdijesimin e grave, sepse gratë në strehimore kujdesen vetë për fëmijët për veten e tyre, si dhe mësohen që të mbajnë përgjegjësi për vendimet e veta, në këto strehimore mund të qëndrojnë prej periudhën një vjeçare, pastaj duhet të dalin nga këtu, ekzistom mundësia e vazhdimit por ajo mvaret nga natyra e rastit sa i komplikuar është, në këto strehimore zakonisht janë të punësuar vetëm gra.

Strehimoret financohen nga Ministria e punës , familjes dhe e çështjeve sociale, ku ajo hap konkurs ku mund të paraqiten strehimoret, në fillim lidhet kontrata për një vit, pastaj pas tre viteve programi vazhdohet për pesë vite. Ministria financon shpenzimet e rogave të këshilltareve si dhe një pjesë të harxhimeve të strehimorëve, të arrdhurat tjera ata i marrin nga kontrata që i kanë lidhur me komunat dhe nga donatorët.

Në strehimore ju ofrohet ndihmë të gjithëve që kanë nevoj, e sidomos edhe shtetaseve të huaja të cilat nuk kanë shtetësi sllovene. Sidomos, edhe atyre që nuk e kanë të rregulluar

statusin. Shtetaseve të huaja strehimora mund t'ju ofrojë kurse gjuhe pa pagesë, dhe nuk mund të ju ofrojë ndihmen juridike pa pagesë. Nëse e kanë të rregulluar vendqëndrimin e përkohshëm ose të përhershëm dhe gëzojnë të drejtën për të marrë ndihmë sociale atëherë i gjithë qëndrimi në strehimore është më i lehtë.

Shoqata Drushtvo SOS telefoni për fëmijë dhe gra – viktimë të dhunës në familje

Shoqata Sos filloi aktivitetet e saj e ka filluar në vitin 1989 si Sos telefoni. Kjo Shoqatë Sos ka statusin e një organizate joqeveritare, jofitimprurëse dhe humanitare, punon në interesin publik në fushën e mbrojtjes sociale. Qëllimi i shoqatës është t'u ofrojë personave, veçanërisht grave dhe fëmijëve që përjetojnë dhunë, mbrojtje dhe mbështetje në ndryshimin e jetës së tyre.

Shoqata Sos ka për qëllim të edukojë, të lehtësoj dhe të rrisë ndërgjegjësimin në lidhje me dhunën dhe papranueshmërinë e saj. Veprimtaria kryesore e kësaj shoqatë bazohet në programin Strehimi për gratë dhe fëmijët- viktimë të dhunës dhe grupe të veprimtarive të ofrimit të vetëndihmës për gratë, që përjetojnë dhunë. Qëllimi kryesorë i këtij programi është largimi përfundimtarë i viktimës nga marrëdhënia e dhunshme. Shoqata kryen aktivitetet e saj për njerëzit që janë të pambrojtur, të disavantazuar dhe në gjendje të vështirë sociale për shkak të përvojave të tyre të dhunës, diskriminimit dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut, dhe kërkon zgjidhje të mundshme me ta, pavarësisht nëse ata janë anëtarë të saj apo jo.

Shoqata për komunikim jo të dhunshëm

Shoqata për komunikim jo të dhunshëm funksionimin e vetë e filloi në gusht 1996, duke kryer aktivitete parandaluese dhe punë këshilluese me autorët meshkuj të dhunës. Edhe kjo shoqatë është një organizatë jo-qeveritare, jofitimprurëse dhe humanitare. Qëllimi i Shoqatës për komunikim jo të dhunshëm është parandalimi i dhunës në shoqëri dhe përhapja e parimeve për komunikimit jo të dhunshëm. Kjo shoqatë i ka për bazë 3 deyra kryesore:

- Të zvogëlojë tolerancën ndaj dhunës në familje dhe dhunës në përgjithësi;
- Të ju ndihmojë perovane të cilët përjetojnë dhunë;

- Dhe ju ofron ndihmë autorëve të cilët ushtrojnë dhunë në përmisimin dhe ndryshimi e sjelljes së tyre.⁷⁹

Qëllimi i Shoqatës për komunikim jo të dhunshëm është, që problemin e dhunës ta zgjedh në përgjithësi, ta parandaloj në kohë dhe të zvogëlojë pasojat e saj në bazë të programeve me personat të cilët dhunën e kanë përjetuar. Sidomos organizojnë edhe programe për informimin e mbarë shoqërisë në lidhje me paraqitjen dhe njohjen e dhunës. Ata janë gjithashtu organizat e parë joqeveritare që ofron një program pune për kryerësit e dhunës.

Në Shoqatën për komunikim jo të dhunshëm ekzistojnë 3 parime kryesore edhe atë:

Parimi i parë: Detyrim i të gjithëve është, që të punohet në parandalimin e dhunës dhe të punohet sa ma shumë që të jetë e mundur në mbrojtjen e viktimës së dhunës në familje,

Parimi i dytë: Për dhunë është përgjegjës, ai i cili dhunën e shkakton,

Parimi i tretë: Dhuna është sjellje e mësuar, çdokush mund të mësojë komunikimin jo të dhunshëm.⁸⁰

Shoqata Zhenska svetovalica

Shoqata Zhenska svetovalnica, e cila ekziston që nga viti 1993 ose zyrtarisht, që nga viti 1994 ajo ka punuar vullnetarisht dhe në fushën e ndihmës psikosociale dhe vetë-ndihmës për gratë, viktimat të dhunës dhe çrregullimeve të të ngrënit. Ata ofrojnë këshillim falas, avokim, informacion mbi kompetencën e shërbimeve publike dhe ndihmë në organizimin e grupeve të vetë-ndihmës për gratë në nevojë.

Veprimi i tyre publik merr formën e tërheqjes së vëmendjes ndaj rrethanave shoqërore, të cilat shpesh shkaktojnë shqetësime të grave, duke luftuar forma të ndryshme të diskriminimit ndaj grave dhe duke mbrojtur të drejtat e grave. Ofrojnë dhe strehimin e viktimave të dhunës në vende anonime dhe të sigurta japin këshillime 24orë gjatë javës. Edhe kjo Shoqatë ka parimet e veta të cilat janë:

Parimi i parë: Anonimiteti,

⁷⁹ Marr nga faqa zyrtare e Shoqatës për komunikim jo të dhunshëm

⁸⁰ Marr nga faqa zyrtare e Shoqatës për komunikim jo të dhunshëm

Parimi i dytë: Përshtatja e punës dhe kohës nevojave të grave

Parimi i tretë: E respektojnë dhe e vlerësojnë çdo individ

Parimi i katërt: Konfidencialitet i plotë i të dhënave ⁸¹

Enti Emma

Enti Emma është një organizatë jo-qeveritare dhe jofitimprurëse. Ajo u themelua në vitin 2000 në Ljubljana dhe qëllimi i tij është të sigurojë lëvizje profesionale dhe të lirë për fëmijët, adoleshentët dhe gratë që janë viktimat e dhunës. Ato ofrojnë ndihmë profesionale psikosociale për viktimat e dhunës dhe janë gjithashtu aktive në fushën e parandalimit. Instituti beson se vetëm veprimi gjithëpërfshirës mund të çojë në rezultatet e dëshiruara, përkatësisht një shoqëri me tolerancë zero ndaj dhunës në shoqëri. Pika fillestare themelore e institutit është të sigurojë ndihmë dhe mbrojtje për individët që kërkojnë ndihmën e tyre. Aktivitetet e institutit janë kryesisht në fushën e dhunës në familje, abuzimit seksual, ku hasin në me rastet konkrete të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut në të gjitha nivelet duke filluar nga ato më intime personale nëpërmjet familjes dhe të institucionet dhe më në fund edhe nga konteksti shoqëror

Shtëpitë me mbykqyerje

Shtëpitë me mbykqyerje janë shtëpi apo strehimore të sigurta ku mund të gjejnë strehim gratë e moshës nga 18 vjeçe e më lart, me ose pa fëmijë, të cilat në vendbanimin e tyre gjenden në një mjedis të rrezikuar nga dhuna. Strehimore për gratë dhe fëmijët - viktimat të dhunës, e cila operon nën kujdesin e Shoqërisë SOS telefon, gjithashtu ofron mundësinë e akomodimit për gratë me aftësi të kufizuara dhe fëmijët të cilët janë duke përjetuar dhunë.

Në Slloveni ka afër 16 shtëpi të sigurta, që pranojnë gratë dhe fëmijët e tyre nga e gjithë Sllovenia, pa marrë parasysh vendbanimin e tyre. Shtëpia e sigurta ofrojnë akomodim, profesional asistencë, këshillim, avokim shoqëror dhe shoqërim në institucione. Pranimi në një shtëpi të sigurt kërkon rregullim paraprak. Qëndrimi në një shtëpi të sigurt mund të zgjasë me një kohë maksimumi 12 muaj, për të cilin paguhet një kontribut mujor në para, ndërsa për gratë pa mjete jetese, është e mundur të qëndrojnë falas. Kjo periudhë vjen në shprehje të vazhdohet nga afati 12 muajsh, por shkaqet duhen të jenë të asaj natyre që të vërtetojnë një

⁸¹ Të dhënat e marra nga faqja zyrtare e Shoqatës

vazhdim të banimit në strehimore. Këta strehimore janë vende të sigurta, të fshehta, ku një grua me ose pa fëmijë mund të banojë duke u larguar nga dhuna që i shkaktohet në familje. Këta strehimore janë në disponim çdo ditë dhe ofrojnë shërbime 24 orë. Ekzistojnë 3 qendra krizash në Slloveni që pranojnë gratë dhe fëmijët e tyre nga të gjitha vendet e Sllovenisë, pavarësisht nga vendbanimi i tyre.

Qendrat e krizave

Qendrat e krizave janë të parapara për fëmijët dhe të rritë dhe gratë viktime të dhunës në familje. Këto qendra krize për fëmijë dhe të rinjë ekzistojnë në këto qytete të Sllovenisë: Lubjanë, Celje, Maribor, Murska Sobot, Slloven Gradec, Kresnicka në Gorenjskë, në Krško, në jug të bregdetit Marelicna Hisha, Qendra e krizes 10- she në Veri të bregdetit.

Ndërsa Qendrat për gratë dhe fëmijët viktime të dhunës në familje janë në Maribor dhe në Veri të bregdetit.

Qendrat e krizës për fëmijë dhe gra viktime të dhunës në familje

Këto qendër gjenden në adresa anonime, ku gratë me fëmijë ose pa fëmijë gjejnë strehim urgjent e cila është në mënyrë të vazhdueshme viktimë e dhunës në familje. Kjo qendër punon 24 orë çdo ditë. Në këtë qendër mund të strehohen për kohën një muajshe apo deri sa të gjendet një zgjedhje për në strehimore diku me afat më të gjatë. Në këtë qendër pranohen gratë me fëmijë edhe nëse nuk kanë asnjë të ardhur financiare për jetesë. Kështu lloje të qendrave ka në Maribor dhe në Jug të bregdetit.⁸²

Qendra e krizës për fëmijët parashkollorë

Qendrat e krizave janë të parapara për fëmijët dhe të rritë nga mosha 6. deri më 18 vjeç dhe të cilët duhet, që urgjentisht të largohen nga vendi në të cilin banojnë. Ndërsa në Grosuplje është qendër krize ku mund të strehohen fëmijët e moshës nga 0 deri më 6 vjeçarë të të cilët paraqiten të tilla rrethana, që nuk mund të përballohen dot pa largimin në këto qendra si p.sh. dhuna fizike, seksuale apo abuzimet e ndryshme nga ana e prindërve apo e ndonjërit nga anëtarët e familjes. Shërbimet në këto qendra ofrohen 24 orë në çdo ditë të javës dhe vendosja në këto qendra bëhet për 3 javë dhe ekziston mundësia e vazhimit të qëndrimit.

⁸² Marrë nga faqja zyrtare e Entit për sigurim social

Një individ pranohet në një qendër krize edhe nëse ai ose ajo nuk ka të ardhura për të mbajtur veten. Këto qendra krize për fëmijë dhe të rinjë ekzistojnë në këto qytete të Sllovenisë: Lubjanë, Celje, Maribor, Murska Sobot, Slloven Gradec, Kresnicka në Gorenjskë, në Krshko, Në jug të bregdetit Marelicna Hisha, Qendra e krizes 10- she në Veri të bregdetit⁸³

Qendra e krizave për të rinjtë

Qendra e Krizave Rinore është menduar për të gjithë fëmijët dhe adoleshentët

nga 6 deri në 18 vjeç që e gjejnë veten në ankth akut, gjë që e bën të domosdoshme përjashtimin nga ambienti në të cilin ata banojnë.

Qendra e Krizave Rinore është e hapur çdo ditë, 24 orë në ditë. Ka 10 organizata krize në Slloveni qendrat rinore, të gjitha që veprojnë brenda QPS. Detyrat e Qendrës së Krizave Rinore:

Sigurimi i ndihmës së parë sociale dhe ndihma personale për të rinjtë në nevojë që do të përfshihen ;pritja dhe kujdesi për fëmijët dhe të rinjtë derisa të zgjidhen problemet e tyre, por jo më shumë se tre javë me mundësinë e zgjatjes; sigurimi i strehimit për të rinjtë që kanë nevojë për largim të shpejtë dhe të përkohshëm nga familjet; përgatitja e masave për ⁸⁴ kthimin e një të mituri në familje; bashkëpunim me QPS-të kompetente, autoritetet shtetërore dhe organizatat kompetente për trajtimin e të miturve. Përveç sigurimit të akomodimit në qendrën e krizës për të rinjtë, ata gjithashtu ofrojnë qëndrim një ditë dëgjim ligjëratarash, intervista informuese dhe intervista këshilluese. Fëmijët dhe të rinjtë,që janë ata mund të marrin pjesë nuk kërkohet asnjë marrëveshje paraprake për pranim.⁸⁵

Strehimoret (Matrerinski Dom)

Këto strehimore janë menduar për nënat me fëmijë të mitur deri në 14 vjeç, për gratë shtatzëna dhe gratë beqare apo të vetmuara dhe që nuk kanë se ku të banojnë për një kohë më të gjatë. Edhe këto strehimore janë me adresë anonime dhe lejojnë akomodimi të shpejtë dhe ofron si ndihmë për të trajtuar shqetësimet e përkohshme, ashtu edhe ato afatgjate ofrojnë ndihmë dhe mbështetje profesionale për banueset, dhe ndihmën për të rregulluar veten e tyre sa më shpejt që të jetë e mundur që të vazhdojë të përvetshohet për jetën jashtë

⁸³Marrë nga faqja zyrtare e Entit për sigurim social

⁸⁴ Marrë nga faqja zyrtare e Entit për sigurim social

⁸⁵ Marrë nga faqja zyrtare e Entit për sigurim social

strehimores, hartimin e përbashkët të një plani individual; ndihmën në kujdesin dhe edukimin e fëmijëve; dhe mbështetje në kontaktet me institucionet. Në Slloveni ka 10 strehimore. Aplikantët që vijnë vetëm ose për t'u pranuar mund të pranohen në këto strehimore, që janë të propozuara nga shërbime të tjera profesionale. Aplikanti duhet të paraqesë një kërkesë me shkrim. Banuesit mund të qëndrojnë në strehimore për një periudhë prej një viti dhe mund të zgjatet vetëm në rastet e veçanta. Përdoruesi paguajnë kontribut për qëndrim në strehimore.⁸⁶

Akomodimi për viktimat e trafikimit

Shoqata Ključ - Qendra për Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore ofron viktima të trafikimit të qenieve njerëzore dy forma akomodimi: akomodimi në krizë dhe

akomodim në një hapësirë të sigurt

4.2 Roli i OJQ maqedonase në parandalimin e dhunës në familje

OJQ-të janë të familjarizuar me problemin e viktimës së dhunës në familje dhe janë të njoftuara mirë për trajtimin e tyre. Ato mund të parashtrojnë një kërkesë për urdhër për mbrojtje dhe urdhër për mbrojtje emergjente.

Aktiviteti i sektorit jo-qeveritar në luftën kundër dhunës në familje zë një vend të rëndësishëm në RMV. Madje, puna dhe aktiviteti i hershëm i tyre, atëherë kur edhe shteti nuk kishte një kornizë ligjore për të trajtuar këtë çështje, ishin mbrojtja e vetme për gratë, viktima të dhunës në familje. Ishin pikërisht OJQ-të ato që fillimisht trajtuan çështjen e dhunës në familje, bënë hulumtime të ndryshme nga kjo sferë, hapën strehimoret e para për viktimat dhe publikuan një sërë dokumentesh për këtë problematikë⁸⁷.

OJQ-të që veprojnë në vendin tonë ishin dhe janë shtytësit kryesorë për veprime konkrete të organeve shtetërore për sensibilizimin e opinionit publik për dhunën në familje, për inkurajimin e viktimave për denoncimin e dhunës në familje, për ndryshimet ligjore nga

⁸⁶ Marrë nga faqja zyrtare e Qendrës për punë për sociale në R.S

⁸⁷ Ratkoceri V, 2012. -Mbrojtja ligjore dhe institucionale e viktimave të dhunës në familje – punim magjistraure – Universiteti Shtetëror i Tetovës – Tetovë - RMV

kjo sferë si dhe për ofrimin e mbrojtjes për viktimat e dhunës në familje. Këto organizata janë partneri kryesor i Republikës së Maqedonisë për luftimin e dukurisë së dhunës në familje në vend⁸⁸.

Organizata jo-qeveritare që merren me mbrojtjen e të drejtave të grave dhe me domenin e dhunës në familje në vendin tonë kemi shumë. Unë do të ndalem pak te puna dhe aktiviteti i:

- UNDP-së;
- Asociacionit për emancipim, solidaritet dhe barazi të grave në RM,
- Qendra maqedonase për të drejtat e grave – Shelter qendra dhe
- Ambasada e parë e fëmijëve Megjashi.

5 Roli i qendrave për punë sociale

5.1 Qendra për punë sociale në Slloveni

Në Slloveni funksionojnë 62 Qendra për punë sociale dhe detyra kryesore e tyre është organizimi dhe zhvillimi i parandalimit të dhunës në familje si dhe të zgjedh vështirësitë e individëve familjeve dhe grupeve të veçanta, të koordinojë dhe përshtas aksionet sociale në mjedisin lokal në bashkëpunim me zbatuesit e organeve qeveritare dhe joqeveritare që janë bartës të programeve të mbrojtjes sociale. Qendra për punë sociale është gjithashtu edhe bartës i autoritetit publik, me të cilin shteti e autorizon, që në bazë të ligjit të vendos në mënyrë autonome për disa të drejta të caktuara me qëllim të mbrojtjes së fëmijëve dhe të rriturve të cilët vetë nuk mund të kujdesen për interesat e tyre. Në çdo qendër në Slloveni mund të merren informacione dhe të aplikoni për këto forma e mbështetjes:

- Ndhimja sociale financiare,
- Ndhimja e jashëzakonshme financiare,
- Ndhimja për kujdesin,
- E drejta për të paguar një kontribut për sigurimin bazë shëndetësor,

⁸⁸ Po aty.

- E drejta për të mbuluar diferencën në vlerën e plotë të shërbimeve shëndetësore,
- Ëmimet e ulta të kopshtit,
- Vakti dhe dreka të subvencionuara, Subvencionet e qirasë, Ndihma financiare në rast të të ardhurave të ulta,
- Ndihma e parë sociale,
- Konsulencë për familjet dhe fëmijët.

Ndërsa Qendra për punë sociale te parandalimi i dhunës në familje funksionon në mënyra të ndryshme, së pari merr informata mbi të, se çka ka ndodhur në familjen në fjalë, dhe se kur e hetojnë se në atë familje ushtrohet edhe dhuna, këtë fakt e analizojnë dhe e vërtetojnë mirë. Dhe kur vijnë në përfundim se në familjen në fjalë është prezente dhuna ata informojnë policinë dhe fillojnë të kryejnë detyra sias Ligjit mbi parandalimin e dhunës në familje. Bashkë me vikimën do ta sheshojë rrezikshmërinë e problemit për ju dhe fëmijët tuaj të mitur. Punëtorët profesional të Qendrës për punë sociale do të hartojnë planin se si të ju strehojnë në një vend tjetër të sigurtë larg ambientit të dhunës. Me ju bisedon për thelbin e problemit dhe njëkohësisht ju informon me të drejtat që ju takojnë. Pastaj zhvillojnë bisedë edhe me autorin e dhunës dhe atë e informojnë për pasojat e sjelljes së dhunshme. I tregojnë se ekziston mundësia në inkuadrime në programeve të ndryshme për përmisimin e sjelljes së dhunshme. Nëse autori i dhunës inkuadrohet në programe, që i ndihmon të ndryshojë sjelljen e dhunshme punëtori social e mbykqir me kujdes autorin e dhunës i ven re në ndryshimet e sjelljes në çdo ndryshim të sjelljes së tij. Në vazhdim punëtori profesional do të përpilojë në formën me shkrim vlerësimin e rrezikshmërinë në bazë të informatave mbi sjelljen e dhunshme të autorit të dhunës gjendjen psikike e fizike të viktimave të dhunës. Vlerësimin e rrezikshmërinë duhet ta bëj, sepse sipas Ligjit mbi parandalimin e dhunës në familje për fitimin e ndihmës juridike pa pagesë edhe pse mund të jeni mirë me të ardhurat financiare. Në vazhdim punëtori/punëtorja profesionale me vetiniciativë do të mbledh ekipin multidiciplinar, nëse gjykon se është më e mirë për zgjidhjen e problemit në fjalë dhe ofrimin e ndihmës është shumë e rëndësishme bashkëpunimi i të gjitha institucioneve siç janë policia, çerdhet, kopshtet, institucionet e kujdesit shëndetësorë, komunat, qendrat e këshillimit, dhe organizatat joqeveritare. Nismën për mbledhjen e një ekipi multidiciplinar, mund ta bëni edhe

ju vetë, nëse e shihni të nevojshme që këmbimi i informatave në mes institucioneve do të ndihmonte për një organizim më të efekshëm për ndihmën dhe sigurinë tuaj.

Ndihmat që ofron Qendra për punë sociale janë: bisedat, terapitë, ndihma financiare, shpërngulja e viktimës nga ambienti i dhunshëm dhe ndihma që i ofrohet deri te strehimi i ri. (Olga Bezenšek Laič Odzivanje socialin delavk in delavcev na nasilje v družini, Društvo SOS telefon za ženske in otroke- žrtve nasilja, Ljubljana, 2009)⁸⁹.

Prezentimi i Qendrës për punë sociale të Mariborit

Qendra për punë sociale në Maribor është ent publik i cili merret me shërbimin e mirëqenies sociale brenda shërbimit publik. Kjo qendër veprimtarinë e vetë e zhvillonë qysh në vitin 1982 bazë të Ligjit të mirëqenies sociale dhe në bazë të kompetencave që i dikton ligji. Kjo qendër është përgjegjëse për këto komuna edhe atë : në Miklavž na Dravskem Polju, Duplek, Rače-Fram, Starše, Hoče-Slivnica, Pesnica, Lenart, Sveta Trojica, Sveta Ana, Crkvenjak, Benedikt, Sveti Jurij v Slovenskah Gorica, Slovenska Bistrica, Makole, Poljčane, Oplotnica, Ruše, Lovrenc na Pohorje, Selnica ob Dravi, Kungota dhe në Šentilj. Drejtuesja e Qendrës për sigurim social është drejtori i punonjësve social dhe ka //////////////// punonjës të profesioneve të ndryshme. Qendra drejton //////////////// punë rajonale edhe atë:

- Qendra e krizës për fëmijë dhe adoleshent
- Shërbimi i ndërhyrjes në fushën e dhunës (përbëhet nga këto Qendra për sigurim social numëro)
- Telefoni për ankth për të rinjë,
- Koordinimi për trajtimin e dhunës në familje,
- Koordinimi për trajtim të komunitetit,
- Koordinimi për trajtimin e dënimeve alternative me burgim,

Shërbimi rajonal rajonal për koordinim dhe ndihma viktimave

⁸⁹ Olga Bezenšek Laič (Odzivanje socialin delavk in delavcev na nasilje v družini, Društvo SOS telefon za ženske in otroke- žrtve nasilja, Ljubljana, 2009)

Ligji mbi parandalimin e dhunës në familje parashikoi krijimin e shërbimeve rajonale për koordinim dhe ndihmë për viktimat në Qendrën e sigurimit social të cilat janë caktuar me një vendim nga Ministria e punës, familjes dhe çështjeve sociale dhe shanseve të barabarta.

Shërbimin regjional përfshinë koordinatorin për parandalimin e dhunës në familje, shërbimin e ndërhyrjes si dhe qendrën e krizës.

Koordinatori për parandalimin e dhunës në familje dhe detyrat e tij janë:

- Ndihma në organizimin dhe mirëmbajtjes së zbatuesve të programeve për parandalimin e dhunës në familje,
- Këmbimi i njohurive të reja përmes trajnimit të profesionistëve,
- Ndikimi i publikut në lidhje me format e ndryshme dhe shtrirjen e dhunës,
- Duke analizuar gjendjen e dhunës,
- Koordinimi i programeve për autorët dhe viktimat e dhunës, përgatitja dhe vendosja e mundësive të reja për strehim afatshkurtër,
- Planifikimi dhe përmbytja e zbatimit të detyrave të shërbimit të ndërhyrjes

Në nenin 16 të rregullores për bashkpunimin e organeve dhe funksionimin e Qendrës për sigurim social, ekipeve multidisciplinare dhe Shërbimeve rajonale në trajtimin e dhunës në familje (Neni 16 i Rregullores Gazeta zyrtare e R. Së Sllovenisë 42/2017)⁹⁰ thotë se, shërbimi regjional duhet të mbledhet në një takim pune të paktën një herë në vit. Në takim të diskutohen çështjet të mundshme të bashkpunimit të ndërsjellë dhe të planifikohen nevojat e përbashkëta të programit.

Shërbimi i intervenimit

Situatat e jetë që kërcënojnë sigurisë dhe jetën e njerëzve nuk pushojnë dhe në të shumtën e rasteve nuk presin, kryesorja është që Qendra për punë sociale të ofroj ndihmë pa parrë parasysh se a është ditë pushim, vikendi apo feste. Prandaj shërbimet e ndërhyrjes luajnë një rol të rëndësishëm sepse njerëzit të cilët kanë nevojë për ndihmë duhet të mbrohen dhe të strehohen në vende të sigurta, qoftë gjatë natës, fundjeve apo gjatë pushimeve. (Jasna Murgel

⁹⁰ Gazeta zyrtare e R. Së Sllovenisë neni 16 i Rregullores për bashkëpunim të organeve të QPS dhe ekipeve multidisciplinare 42/2017

2010:124)⁹¹. Qëllimi i shërbimit të ndërhyrjes është që të kontaktohet me viktimën sa më shpejtë që të jetë e mundur me qëllim që ti ofrohet ndihma përkatëse.

Në paragrafin e 2 të nenit 17 të Aktit nënligor mbi bashkpunimin të organeve dhe të qendrës për punë sociale, ekipeve multidisiplinare dhe shërbimeve regjionale në shqyrtimin e dhunës në familje thuhet se: për zbatimin e shërbimit në regjionin e caktuar përgatitet lista e punëtorëve profesional dhe koordinatori regjional me ata punëtorë profesional organizon punën e shërbimit të intervenimit. Në listën e punëtorëve profesional për zbatimin e shërbimit të intervenimit regjistrohen ata punëtorë profesional të atyre Qendrave për punë sociale, të cilat i përkasin atij regjioni, kanë pesë vite përvojë pune dhe njohuri të duhura për zgjedhjen e detyrës së shërbimit të intervenimit. Orarin e punëtorëve profesional të Qendrës për sigurim social për zbatimin e shërbimit të intervenimit në regjionin e caktuar e përgatit koordinatori i regjionit. (Gazeta zyrtare e R. së Sllovenisë, 42/2017)⁹².

Punëtori profesional i Qendrës për sigurim social është i disponueshëm dhe në gatishmëri të vazhdueshme e cila aktivizohet kur telefonon policija. Pas marrjes së njoftimit ai duhet të vlerësojë situatën dhe të marr masat e nevojshme. Pas ndërhyrjes ai shkruan një raport me shkrim të cilën i'a paraqet Qendrës për sigurim social kompetente, ditën e parë e cila është ditë pune.

Shërbimi i intervenimit ndërhyr në të gjitha rastet urgjente sidomos kur janë në pyetje këto raste:

- Kur fëmija i mitur kërcënohet ose mbetet pa prindër,
- Viktima e dhunës në familje,
- Për personin e moshuar, i cili është pa të afërm dhe nëse humbet,
- Personi i cili është privuar nga puna ose e drejta e zgjatur prindërore dhe mbetet pa mbrojtje dhe kujdes (Jasna Murgel 2010: 124)⁹³

Në situatat e krizës, ku është e nevojshme që një person të largohet nga ambienti i dhunshëm, shërbimi i ndërhyrjes duhet të gjej mënyrën më të përshtatshme për akomodim. Kështu që,

⁹¹ Jasna Murgel 2010:124

⁹² Gazeta zyrtare e R. së Sllovenisë, 42/2017

⁹³Jasna Murgel 2010: 124

mundësitë për komodim mund të jenë të ndryshme p.sh. Në rast se duhet të largohet fëmija atëherë ai vendoset një qendër krize ose në njënjë ent të edukimit nëse fëmija është autor i dhunës. Në qoftë se duhet të largohen nga ambienti i dhunës gratë, atëherë ata duhet të strehohen në qendrat e krizës për persona madhorë apo në strehimore. Ndërsa kur është fjala për pleqtë ata atëherë mund të akomodohen në shtëpitë e pleqve. Nëse Punëtori profesional i cili është në punë dhe i cili nuk mund të kujdeset për sigurimin e viktimës dhe të vetin për ndihmë mund ta lusë policinë. (Jasna Murgel, 2010 124-125)⁹⁴

Qendra e krizës

Rrjeta e qendrave të krizës përbëhet nga qendra krizash për të rij dhe adoleshent 19=1 qendra krizash për fëmijë dhe qendra krizash për të ritur viktima të dhunës. Baza ligjore bazohet në Ligjin për mbrojtje sociale dhe Ligjin për parandalimin e dhunës në familje. Qendra e krizës për fëmijë dhe adoleshent në Maribor punën e vetë e ka filluar prej vitit 2003 dhe është përgjegjëse për këto regjione në Shtaersk. Kjo qendër punon çdo ditë punë 24 orë. Të punësuar janë /////// punëtorë profesional, që punojnë me katër ndrime. Kjo qendër është e caktuar për fëmijët e moshës prej 6 deri më 18 vjeç të cilët kanë hasur në rrethana që duhet të largohen nga ambienti i dhunës ose po ambienti në të cilin jetojnë nuk është i përshtatshëm për jetesën e tyre. Në këtë qendër fëmijët mund të vijnë vetë ose po të jenë të shoqëruar nga punënjësit e institucioneve të ndryshme siç janë: polici, punëtori profesional i qendrës për punë sociale, mësuesi etj.

Në këtë qendër fëmijët mund të qëndrojnë 21 ditë dhe nëse brenda këtij afati nuk gjendet një zgjedhje për një strehim afatgjatë, në bazë të shkaseve të arsyeshme mund të vazhdohet qëndrimi edhe për 21 ditë tjetër. Kur paraqitet fëmiju atje, kjo qendër është e detyruar që të informojë brenda 24 orëve prindërit dhe Qendrën për punë sociale kompetente. Dhe në këtë qendër për fëmijët dhe adoleshentët ka disa rregulla që duhet tju përmbahen edhe atë rregullat janë:

- Pjesëmarrja aktive në zgjedhjen e problemeve të tyre,
- Përdorimi i përgjegjshëm ndaj aparateve dhe pajisjeve,
- Duhet të ndjekën udhërat e punëtorëve profesional,

⁹⁴ Po aty.

- Ndalimi i konsumimit të duhanit, konsumimi i pijeve alkoolike dhe substancave të tjera të ndaluara,
- Përbushjen e detyrimeve shkollore (varet nga rrethanat e rasis),
- Vizita me lejen e punëtorëve profesional,
- Daljet me lejen ose në shoqëri të punëtorit profesional.

Ekipet multidisciplinare

Qendra për punë sociale të rastet e dhunës në familje funksionon me qëllim të sigurimit sa më të mirë të viktimës të parandalojë dhunën në vazhdim si dhe të motivojë viktimën në inkuadrimitin e ndihmës dhe gjithashtu fton autoritetet dhe organizatat të marrin pjesë në një ekip multidisiplinar (EMD) . Këtë ekip e përbëjnë një grup profesionistësh që kanë qëllimin e rrojtjes së viktimës në fjalë. Punëtori profesional i cili e ka në duar çështjen dhe filon me planifikimin e planit ndihmës për viktimën dhe i fton edhe organet tjera në bashkëpunim. ku i duhen edhe ndihmat shtesë nga organet e tjera vendos edhe një antar tjetër i cili mund të jetë koordinator rajonal i parandalimit të dhunës në familje. Organet e tjera duhet që patjetër t'i përgjigjen Qendrës për punë sociale dhe të kenë të vendosur antarin se cili do të prezantojë organin e vet. Ekipin e udhëheq punëtori social i cili e ka çështjen në duar.(neni 8 i RRegullores mbi bashkpunimin e organeve dhe shërbimeve të qendrës për punë sociale dhe ekipeve multidisciplinare dhe punëve rajonale mbi parandalimin e dhunës në familje).⁹⁵

Detyrat dhe funksionimi i EMD janë:

- shkëmbimi i informacionit për të sqaruar rrethanat e nevojshme për mbrojtjen e viktimës nëpërmjet telefonit;
- të njoftojë viktimën në lidhje me të gjitha ndihmat të cilat mund ti ofrohen
- ofrim i mbrojtjes adekuate viktimës
- përpilimin e një plani të ndihmës,

⁹⁵ neni 8 i RRegullores mbi bashkpunimin e organeve dhe shërbimeve të qendrës për punë sociale dhe ekipeve multidisciplinare dhe punëve rajonale mbi parandalimin e dhunës në familje

- si dhe pranimin e vendimeve me qëllim të zbatimit të ndihmës.⁹⁶(neni 8 i RRegullores mbi bashkpunimin e organeve dhe shërbimeve të qendrës për punë sociale dhe ekipeve multidisiplinare dhe punëve rajonale mbi parandalimin e dhunës në familje).

Në nenin 10 të kësaj rregullore thuhet se plani i pranuar për dhënien e ndihmës viktimës me vëmendje të madhe përpilohet nëse në familje ka edhe fëmijë të mitur dhe atë së pari vihen në pah sigurimi i fëmijës, sa do të zgjatë ndihma që do ti ofrohet fëmijës dhe familjes në përgjithësi për ndryshimet. Ekipi në çdo mbledhje e vëzhgon punën dhe suksesin e vendimeve. Të gjithë antarët e ekipit shkëmbejnë informacionet në mes vetë dhe të dhënat duhet t ruajnë dhe puna përfundon kur viktimës i ofrohet ndihmë e garantuar dhe njoftohen të gjithë organet pjesëmarrëse⁹⁷ (Neni 10, 11, 12, i RRegullores mbi bashkëpunimin e organeve dhe shërbimeve të Qendrës për punë sociale dhe Ekipeve multidisiplinare dhe punëve rajonale mbi parandalimin e dhunës në familje).

Qendrat e krizës për fëmijë dhe të rinj

Kjo qendër është në disponim për fëmijët nga mosha 6 deri në moshën 18 vjeç që gjenden në shqetësimet të vazhdueshme, ku medojt se largimi nga rrethi i dhunës është një hap i rëndësishëm dhe urgjent. Vendosja në këtë qendër është e mundshme 21 ditë, por mund që edhe të zgjatet më së shumti deri në 3 muaj.⁹⁸ Faqja zyrtare e Qendrës për punë sociale

Qendra e krizës për fëmijët parashkollorë

Kjo qendër është menduar për fëmijët në periudhën parashkollore nga 0 deri në 6 vjeç, në të cilën Qendra për punë sociale e sheh të nevojshme ndihmën e këtyre fëmijëve dhe familjeve të tyre. Strehimi i tyre është i shkurtër dhe garanton qëndrim të sigurtë fëmijëve parashkollorë. Edhe kjo qendër funksiono 24 orë në ditë edhe atë çdo ditë.⁹⁹

⁹⁶ neni 8 i RRegullores mbi bashkpunimin e organeve dhe shërbimeve të qendrës për punë sociale dhe ekipeve multidisiplinare dhe punëve rajonale mbi parandalimin e dhunës në familje).

⁹⁷ Neni 10, 11, 12, i Rregullores mbi bashkëpunimin e organeve dhe shërbimeve të Qendrës për punë sociale dhe Ekipeve multidisiplinare dhe punëve rajonale mbi parandalimin e dhunës në familje).

⁹⁸ Faqja zyrtare e Qendrës për punë sociale

⁹⁹ Faqja zyrtare e Qendrës për punë sociale

5.2 Qendrat për punë sociale dhe roli i tyre në RMV

Qendra për Punë Sociale është institucion publik i nivelit komunal, kompetent për mbrojtjen e qytetarëve në nevojë për shërbime sociale dhe familjare ,në këtë kontekst edhe mbrojtjen dhe ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës në familje deri në ri-integrim të viktimës . Gjithashtu koordinon aktivitetet me akterët tjerë në procesin e mbështetjes së viktimës dhe fuqizimit të saj/tij. Qendra për punë sociale (QPS) ndihmon viktimat e dhunës në familje kur nevojiten shërbimet sociale, mbrojtje, rehabilitim dhe integrim të viktimave në shoqëri. Çdo viktimitë të referuar i caktohet një menaxher i rastit, i cili është zyrtar që emërohet nga QPS për të ndihmuar në identifikimin dhe koordinimin e shërbimeve ekzistuese.

Shtojcë: INTERVISTË

Intervista është zhvilluar pranë Gjykatës së Rrethit në Ptuj të Republikës së Sllovenisë. Anketa është bërë nëpërmjet g-mailit me zonjën Albina Hrnc Pečnik, presidente e Gjykatës së Rrethit në Ptuj. (5. 8. 2021)

1. Cilat urdhra të përkoshëme i shpall gjykata e në procedurat e konflikteve martesore dhe tek konfliktet mes fëmijëve dhe prindërve?

1. Gjykata mund të shpalë të gjitha urdhrat e përkohëshme në pajtim me nenet 162. 163. dhe 165 të Ligjit mbi Familjen.

2. A mund, që për përcaktimin e rrezikshmërisë së fëmijëve gjykata të kërkojë nga Qendra për punë sociale mendim?

2. Mundet dhe e ka patjetër të kërkojë mendim. Gjykata me patjetër në procedura, që zhvillohen për kujdesin dhe sigurinë e fëmijëve para vendimeve, të marr mendimin e QPS kompetenten ë të gjitha rastet, kur QPS nuk është propozuese e procedurës (neni 99 i Ligjit mbi procedurën ligjore).

3. Sa kohë zgjatë urdhri i përkohshëm i konfliktit ligjorë?

3. Urdhëri i përkohshëm shpallet deri te vendimet përfundimtare te çështja në fjalë, gjegjësisht deri te vendimet e ndryshme të gjykatës (kur gjykata vendos para vendimit me vendim të rij të urdhërit). Në rastin, nëse urdhëri i përkohshëm është i shpallur vetëm në bazë të propozimit të lëshimit të urdhërit të përkohshëm para paraqitjes së procedurës për mbrojtjen e fëmijëve (atëherë vetëm propozimi për masë të përkohëshme – masë urgjente) duhet të jetë objekt i propozim për rregullimit e mbrojtjes së fëmijët brenda 7 ditëve, përndryshe gjykata urdhërin e shpall si të pa vlefshëm sipas nenit 166 të Ligjit mbi familjen.

4. Cilat sanksione penale i shpallen autorit të dhunës në familje?

4. Sanksionet i vendos kapitulli 21 i Ligjit penal - KZ-1: Veprat penale kundër martesës, familjes dhe fëmijëve nenet 188 – 195.

5. Kur gjykata shqipton masën për siguri a mund të caktoj edhe udhëzime tjera, sipas asaj se si duhet të sillet i dënuari. Çka duhet të përmbajë ato detyra të gjykatës? (shërim në entitet përkatëse ...)

5. Gjykata mund në bazë të nenit 63 – 67 të Kodit penal 1shqipton masën për siguri në kohën e testimi të të akuzuarit. Në të gjitha rastet është e nevojshme të theksohet periudha e zbatimit të udhëzimeve. Gjykata në përfundimin, konkluzionin e aktgjykimit duhet të paraqes: Tek shërimi në entitet përkatës ose vizitimi i këshillimit përkatës, patjetër gjykata duhet të paraqes se për çka shërohe, ku shërohet, (p.sh. në cilën ambulante) kur, sa gjatë, dhe sa do të zgjasë shërimi (p.sh. një vit, gjashtë muaj, ...), në rastet kur do të viziton këshillimoret, duhet të theksohet se cilën nga këshillimoret e viziton dhe përse (periudha e vizatimeve mund të zgjatet, por mund që detyra të kryhet edhe para kohës së paraparë)

6. Kur gjykata i shpall paraburgim kryesit të dhunës në familje, në propozim të prokurorit publik?

Paraburgimin e shpall gjyqtari hetues në propozim të Propurorit publik sipas kushteve të nenit nga neni 201 i Kodit për procedurë penale në Republikën e Sllovenisë.

7. Kur gjykata i shpall masën e ndalimit afrimit personit dhe vendit të caktuar? Çka bën gjykata nëse e shkel?

7. Gjykata shpall masën sipas Ligjit mbi parandalimin e dhunës në familje nëse është e dëshmuar se propozuesi është viktimë në anën e kundërt të kryesit. Në konkluzionit e vendimit për rast të shkeljes masës së shpallur në pajtim me dispozitën e nenit 22ç të NPDHF kryesit të dhunës në familje i shqiptohet dënim me para bashk me udhëzimin juridik viktimës se duhet të lajmërojë policinë në rastet të shkeljes së masës. (në arsyetimin e vendimit). Nëse vjen deri te shkelja dhe është e evidentuar dhe e shqyrtuar mirë(dëshmitë që e vërtetojnë shkeljen) nga ana e policisë me vendim dënimi i caktuar detyrohet sipas detyrës zyrtare.

8. Kur është e mundur të shpallja e masës pa deklarin e kryesit të dhunës?

8. Shpallja e masës pa deklarin paraprak është e mundur në rastet të cilat janë të caktuara në pajtim me nenin 22 d LPDHF ku e drejta kushtetuese te deklarimi në procedurë sigurohet në procedurën e kundërshtimit- ku kryesi mund paraqet kundërshtimin kundër vendimit në afatin e parashikuar.

9. Cilat janë masat e gjykatës ndaj veprave të dhunës?

9. Masat e gjykatës janë të parapara në nenit 19 deri më nenin 22 të LPDHF të Republikës së Sllovenisë.

10. Çka mund t'i ndalojë gjykata kryesit të dhunës që viktimën e ka dhunuar fizikisht?

10. Gjyka mund të zgjedh njëri nga masat, të caktuara nga neni 19 deri në nenin e 22 të LPDHF në republikën e Sllovenisë.

11. A mund gjykata ti shpall kryesit masa edhe nës e viktimn vetëm e ka kërcënuar?

11. Mundet deri sa janë kushtet e dëshmuara për lëshimin e masës në bazë të procedurës hetimore se kryesi viktimën e ka kërcënuar. Dhuna psikike si formë e dhunës në familje sipas LPDHF janë gjithashtu mbi të tjerat sjellje ku kryesi për viktimën shpërndan informacione ku tek viktima nxisin frikë, nënçmim dhe ndjesinë e vlerësimit të ulët dhe shqetësime të tjera si dhe rastet kur janë të përdorura nëpërmjet mjeteve të komunikimit. (Paragrafi i pesë i nenit të 3 të LPDHF)

12. Në rastet kur autori i dhunës është pronar i banesës a mund ti shqiptohet ndalim i përdorimit të banesës dhe sa kohë zgjatë kjo ndalesë?

12. Gjykata mund ta detyrojë autorin e dhunës të liroj banesën edhe pse është pronarë i saj edhe kjo masë zgjatë më së shumti deri në 6 muaj, por nëse janë që të dy partnerët&bashkëshortët pronarë masa mund të zgjatet më së shumti 12 muaj. Me mundësinë e zgjatjes së masës në propozim të viktimës deri në 6 muaj vjegjësish në 12 muaj në të dy rastet. (neni 22 i LPDHF)

13. Në cilën gjykatë duhet të drejtohem për ndimën juridike pa pagesë? A kanë të drejtë edhe të huajt në ndihmën juridike pa pagesë?

13. Mbi ndihmën juridike pa pagesë vendos kryetari i gjykatës së rrethit gjegjësisht kryetari i gjykatës së specializuar të shkallës së parë. Kryetari i gjykatës mund të autorizojë gjyqtarin tjetër i cili ka pozitën e këshilltarit në gjykatë e specializuar. Të huajt e leje qëndrimi të përhershëm apo të përkohshëm në Republikën e Sllovenisë dhe të huajtë pa shtetësi (apatridi) të cilët ligjërisht banojnë në Republikën e Sllovenisë dhe të huajve të tjerë sipas konventave

ndërkombëtare janë të liruar nga ndihma juridike pa pagesë.(Neni 10 i Ligjit për ndihmë juridike pa pagesë i R.S. ZBPP)

14. Me cilat veprime QPS dhe policija e ndihmojnë gjykatën te parandalimi i dhunës në familje si dhe me cilat veprime i ndihmojnë viktimat gjegjësisht kryerësit, të cilët gjithashtu janë në vështirësi (nëse nuk kanë kulm përmbi kokë, nuk janë të punësuar, nuk i kanë takimet me fëmijët ...)?

14. Qendra për punë sociale luan roli këshilldhënies, i cili në rastin e hetimit të dhunës në familje merr pjesë si propozues i procedurës në pajtim me viktimën. Gjithashtu në procedurën e pjesëmarrjes së organeve jep mendime profesionale në bazë të palëve të lënduar dhe në shikimin e dinamikës familjare. Policia është organ i preventivës dhe i represioneve, që bashkëpunojnë me QPS me ekipet multidisiplinare, ku bëhet plani i ndihmës nga dhuna në familje, shqyrtimet e veprave penale dhe kundërvajtjeje të bëra kundër viktimave të dhunës në familje, përveç kësaj ka mundësi që viktimën ta mbroj me masat policore dhe urdhrat me të cilat autorit të dhunës i ndalon afrimin personit dhe vendit të caktuar, të cilat janë të kufizuara me kohë dhe mund që kryesit t'i paraqes kallëzim penal për veprat penale të ndjekura sipas detyrës zyrtare te prokurori publik. Në rastin e një mase të caktuar tanimë sipas dispozitave të LPDHF ajo përcakton faktet juridike relevante dhe informon gjykatën për shkelje bazuar në raportin e viktimës, e cila pastaj mund të rimar procedurat për gjobën e vendosur.

15. A ka mundësi që viktima të shkel urdhërin e ndalimit të afrimit personit apo objektit?

15. Po, mundet ndodh shpesh në praktikë.

16. A mendoni se Ligji për parandalimin e dhunës në familje është mjet efikas në parandalim të dhunës në familje?

16. Pjesërisht sepse LPDHF është një element kurativ e jo preventiv veçanërisht preventiv në kuptimin e dhunës së mëtejshme, kur dhuna tashmë është kryer dhe propozohet zgjatja e masës së shqiptuar. Deri në shpalljen e masës sipas dispozitave të LPDHF vjen në rastin kur dhuna ndaj vikamës ka qenë e ekzekutuar supozimi procedural për udhëheqjen e procedurës është që viktima patjetër të duhet të bëj propozimin më së voni 6 muaj nga dita e dhunës së fundit nga ana e kryesit. (paragrafi i katërt i nenit 22b të LPDHF)

17. A do të kishit ndryshuar diçka në lidhje me ligjin në fuqi për të mirën e viktimës dhe me këtë të risnit ndjenjën e sigurisë, ndërkaq që ndikimi ndaj kryesit të jetë i qëndrueshëm?

17. Ligji momental është i përshtatshëm ndoshta pak a shumë restriktiv tek emërtimi i dhunës, e vërteton shkallën zero të tolerancës, e cila jep mundësinë e keqpërdorimit në procedurat e divorcit, tek procedurat mbi ruajtjen dhe kujdesin ndaj fëmijëve dhe tek procedurat e ndarjes së pasurisë së përbashkët. Para se gjithash bëhet fjalë për situatat, kur propozuesi me qëllim, vepron ashtu që të shkaktojë elemente të dhunës psikike (me vetëdije shkaktime të situatave konfliktuese të bëra me anë të provokimit verbal të propozuesit, që nxit veprim jo të duhur të palës kundërshtare, si bazë për konfirmim të dhunës psikike) ose po dhunës ekonomike në të cilat më vonë del se propozuesi apo në rastet kur propozuesi është vetë shkaktarë i dhunës dhe veprimet apo eagimet e palës kundërshtare janë përqendruara në vetëmbrojtje.

18. Çka do të vëçonit ju si gjykatëse në punën tuaj si tragjedi më të madhe tek viktima dhe kryerësi i dhunës?

18. Shqetësimin personal të viktimës së dhunës në familje, shpeshherë edhe të kryesit të dhunës (reagimin e dhunshëm si pasojë e mes tyre edhe shkaqet e varësisë nga alkooli dhe substancat e ndaluara, që janë shpeshherë të varura nga gjendja sociale e njerëzve) dhe viktimizimi i viktimës.

Me nderime,

Albina Hrnec Pečnik

Kryetare e Gjykatës së Rrethit Ptuj

PËRFUNDIMI DHE REKOMANDIME

Jetojmë në një shoqëri, ku pavarësisht ndryshimeve pozitive dhe përparimit të arritur, sjelljet stereotipike dhe mendimet që nxisin veprime të dhunshme nuk mungojnë në përditshmërinë tonë. Një fjalë popullore thotë: Çdo fillim është i rëndë, na njerëzit shumë rëndë i ndyshojmë shprehitë tona, shumë rënë ndyshojmë ambientin, jemi konfuz se ndryshimet e reja nuk e dimë se çka do të na sjellin përpara me një fjalë frika i ka sytë e mëdhej. Kjo vlenë për të gjithë, e veçanërisht e vështirë është kur duhet të marrim vendime për të ndryshuar mendimet e grave ndaj të cilave ushtrohet apo është ushtruar dhunë. Në lidhjen ku kanë përjetuar dhunë, autorët e dhunës i bindin se ata janë të pa vlera, se pa ata nuk mund të mbijetojnë dhe tjetër partner nuk mund të kenë. Gradualisht këto fillojnë të besojnë në atë çka ju flet partneri. Është shumë me rëndësi, që viktima e dhunës, kushdo qoftë ajo, duhet të kërkojë ndihmë, që do ta përkrahin dhe motivojnë për në të ardhmen. Sepse në momentin kur viktima vendos ta ndërpres lidhjen që ka dhe në të cilën vuan, vendosën për jetën e vetë, për të jetuar, jetë ku do të marrë respektin që meriton. Sepse dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave, herë të perceptuara si sjellje normale dhe herë si të patpërueshme, renditen ndër shkaqet më kryesore në ndërtimin e jetës së njeriut dhe klasifikohet si shkelje shumë e rëndë e të drejtave të njeriut. Ky problem me që ndodh në gjithë botën gjithashtu edhe diskutohet botërisht dhe secili shtet mundohet që të marrë masat e duhura për njohjen në rradhë të parë të këtij fenomeni problematik, trajtimin e saj si dhe ofrimin e sigurisë së mënjihershme mbrojtjen, riintegrimin dhe rehabilitimin e të gjithë atyre ndaj të cilave ushtrohet dhunë, pa marrë parasysh moshën, gjininë, aftësisë etj. Dhuna në familje është krim. Fusha e trajtimit të dhunës në familje është e rregulluar më mirë në Republikën e Sllovenisë se sa në Republikën e Maqedonisë. Institucionet që merren me dhunën në familje në Slloveni janë më të ndryshme sesa në Maqedoni, nuk flas për teori por për praktik kështu që efektiviteti i masave për të mbrojtur, riintegruar dhe rehabilituar të gjithë ato që përjetojnë dhunë viktimat e dhunës në familje në Slloveni është më i mirë se në Maqedoni. Lidhur me rregulloren ligjore, Republika e Maqedonisë ndjek gjurmët e Republikës së Sllovenisë, përkatësisht mund të konkludojmë nga koha e ligjit të miratuar për parandalimin e dhunës në familje. Në Slloveni, ligji u miratua në vitin 2008, dhe në Republikën e Maqedonisë në vitin 2014. Bazuar në këtë, ne gjithashtu mund të konkludojmë se Sllovenia është e

rregulluar më mirë në fushën e dhunës në familje. Institucionet që merren me dhunën në familje janë më të shumta në Slloveni sesa në Maqedoni, ku vetëm Qendra për Punë Sociale dhe policia janë përgjegjëse për dhunën në familje, ndërsa në Slloveni ka shoqata të ndryshme që merren me të. Pavarësisht se çfarë lloj dhune në familje është: ekonomik psikologjik seksual fizik është padyshim i papranueshëm. Çdo person që kryen çdo lloj dhune duhet të përgatitet dhe të ndëshkohet në përputhje me rrethanat. Autoritetet kompetente duhet të bashkëpunojnë mirë dhe profesionalisht me njëri-tjetrin në mënyrë që të trajtojnë dhe sanksionojnë kryesin sa më shpejt të jetë e mundur. Gjithkush meriton dhe ka të drejtë të jetë i lirë dhe të jetojë i sigurt dhe pa dhunë. Shteti është i detyruar të kujdeset për këtë me ndihmën e institucioneve që merren me parandalimin e dhunës. duhet të sigurojë që viktimat e dhunës të informohen në mënyrë që ata të dinë se ku të drejtohen për ndihmë. Në pjesën teorike të tezës së masterit, ne filluam duke përcaktuar familjen dhe kush e përbën atë. Në vijim, ne vendosëm të përcaktojmë llojin e dhunës që njohim. Më pas kemi analizuar në detaje llojin e dhunës që përcaktohet saktësisht në ligj.

Tema kryesore e tezës së masterit ishte krahasimi i dhunës në familje midis Republikës së Sllovenisë dhe Republikës së Maqedonisë. Këtij studimi i jemi referuar duke trajtuar dhe shqyrtuar në detaje dhunën në të dy republikat në veçanti. Së par kemi studiuar çfarë në realitet mendojnë njerëzit për dhunën në familje në të dy shtetit dhe se si përballen me parandalimin e kësaj dhune. Duke bërë krahasimin erdhëm në përfundim se në Republikën e Sllovenisë i vetmi organ i cili i mban të dhënat statistikore për dhunën në familje është policia, ndërsa në Republikën e Maqedonisë së Veriut të dhënat statistikore i mban përveç policisë edhe Qendra për sigurim social. Në vazhdim kemi studiuar dallimin mbi legjislacionin mes dy shteteve. Krahasimin e kemi bërë në bazë të funksionimit të institucioneve të cilat merren e problematikën e dhunës në familje gjegjësisht të qendrës për sigurim social. Ashtu si në Republikën e Sllovenisë kjo qendër funksionon në një sistem të ngjashëm, por në Republikën e Maqedonisë së Veriut mund të hasim ngecjet në këtë fushë. Shpeshherë ma duhet të bëjmë krahasimin nga vendet e mëdha dhe ato të vogla, ku shqyrtimi i dhunës ende është në zhvillim, dhe se nuk shqyrtohet me serioziteti të madh siç duhet. Sistemi i organizimit, i cili merret me dhunën në familje në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ende është në zhvillim dhe ndjek

hapat e shteteve dhe legjislacioneve evropiane, për atë në kohë të fundit në qytetet e vogla kanë filluar të themelojnë strehimore për viktimat e dhunës në familje.

Edhe në fushën e ligjshmërisë shihen lëvizje të mëdha, sepse ligjet ndryshojnë në bazë të ligjeve evropiane. Kjo më së shumti shihet në bazë të miratimit të Ligjit mbi parandalimin e dhunës në familje i cili u miratua në vitin 2014, ndërsa i njëjti ligj në Republikën e Sllovenisë u miratua disa vite më parë edhe atë në vitin 2008. Edhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut sipas të dhënave statistikore mund të konkludojmë se njerëzit gjithënjë e më tepër kanë filluar të raportojnë dhunën d. m. th. kanë filluar të mendojnë ndryshe kanë filluar të besojnë në institucionet e shtetit që parandalojnë dhunën dhe se çështja e dhunës në familje nuk ngelet si temë tabu. Kjo lloj dhune nuk konsiderohet si e turpshme, por si diçka që duhet të parandalohet dhe autorët të ndëshkohen. Në familje ku është prezente dhuna për një kohë të gjatë kërkon, që me të të merret një njeri i fortë, aktiv dhe i cili me saktësi e di që çka don, di të këmbëngul dhe nuk frigohet të rrezikoj dhe është mjaftueshëm i guximshëm ty “përli dhe duart” Duhet të paranjohë pengesat, ti shoh dhe ti ngjek ngadal ato, të cilat mund të jenë pjesë të ndryshimeve të një kohës së gjatë të jetesës, urgjentisht duhet të dallojm thelbin e problemit. Në asnjë mënyrë nuk duhet ta anashkalojmë nëse dimë se dikund është prezente dhuna apo se vetvetiu do të zhduket nëse ne nuk reagojmë. Dhunës duhet ti themi STOP. Se të gjithë ato vrasje, apo të gjitha ato gra që kanë humbur jetën, nuk kanë ndodhur rastësisht, por ato i ka vrarë heshtja. Njeriu në jetë mundohet të investojë në karrierë, objekte ku të jetë familje e nuk e di se ku, gjithashtu shteti atë organ këtë organ, një tjetër program më të mirë përtë ndihmuar në mënyrë sa më efikase viktimave të dhunës. Unë më së shumti do të kisha veçuar, pa marrë parasysh prej nga vjen njeriu duke filluar nga bindjet e veta familjare, tradicionale, racore e fetare, gjënë më të rëndësishme që duhet të bëjë është, që të investojë në guxim. Në familje njeriu mund të përjetojë lumturi më të mëdha, por mund të përjetojë edhe zhgënjimet më të mëdha. Për shumicën familja paraqet burim të energjisë pozitive ndonjë tjetër e shtrydh më tepër se çdo gjë apo çdo fushë tjetër. Në familje njeriu mund të marr dhuratat më të çmuara, por edhe mund të përjetojë humbjet më të mëdha. Familja shumicën e shpëton, por edhe shumë kënd e ka shkatërruar.

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

1. “Udhëzues për Kodin e Procedurës Penale të Kosovës dhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës”, Jon Smibert, Ambasada Amerikanë në Prishtinë, 2013
2. Anastasi, Aurela & Saraci, Besa & Bozo, Aurela, Raport, “Zbatimi i ligjit ‘Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare’”, Tiranë 2010 QNL,
3. Anastasi, Aurela & Saraci, Besa & Bozo, Aurela, Raport, “Zbatimi i ligjit ‘Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare’”, Tiranë 2010
4. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (UDHR), miratuar dhe shpallur nga Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 217A(III) e 10 dhjetorit 1948.
5. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Organizata e Kombeve të Bashkuara, 1948.
6. Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, SOROS, “Përmirësimi i mekanizmave mbrojtës të të drejtave të njeriut në luftën kundër diskriminimit”,
7. Kanduč Zoran, Korošec Damjan, Bošnjak Marko, Sponost, nasilje in pravo; Ljubljana 1998
8. Karaj, Theodhori: Psikologjia e zhvillimit të fëmijës, Tiranë, 2005;
9. Karta Sociale Europiane – e vitit 1965. Konventa europiane “Për parandalimin e torturës, të trajtimeve çnjerëzore e poshtëruese”, e vitit 1998.
10. Kazenski zakonik
11. Këshilli i Evropës, “Përmbledhje e jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut mbi çështjet e barazisë gjinore”.fq.3.
12. Kodi Civil dhe i Proçedurës Civile i Shqipërisë, të pasuruar me praktikë Gjyqësore dhe e përditësuar me ndryshimet e 2012. Nga shtëpia botuese AlbJuris, 2012.
13. Kodi i Drejtësisë për të mitur në RMV
14. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Maqedonisë së Veriut.
15. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Qendra e Publikimeve Zyrtare, 2010.
16. Konventa e Kombeve të Bashkuara “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave” (CEDAË). Deklarata e Kombeve të Bashkuara e vitit 1963, “Për eliminimin e dhunës kundër grave”.
17. Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, 1989

18. Konventa Europiane (BE) “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore”, e miratuar në vitin 1950, hyrë në fuqi më 1953).
19. Konventa ndërkombëtare “Për të drejtat civile dhe politike, (ICCPR). Konventa ndërkombëtare “Për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore” (ICESCR).
20. Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të amenduara nga Protokollat 11 dhe 14, Këshilli i Europës, 1950
21. Leskovšek Vesna, Kodele Tadeja, Mešel Nina Zaščita otrok pred nasiljem in zanemarjanjem v Sloveniji 2019
22. Ligji për Ndihmë Juridike Falas
23. Ligji për Shërbime sociale dhe familjare
24. Mandro.A & Anastasi.a& Shkurti. E & Bozo.A, “Barazia Gjinore dhe mosdiskriminimi”, Tiranë 2011
25. Mariana Semini-Tutulani, “Konfliktet gjyqësore të punës nën këndvështrimin gjinor”, Botimet Morava, Tiranë 2015
26. Material i prezantuar për OJF-të nga A.Gjurgji (DPPSH), “Dhuna në familje. Masat e marra dhe rezultatet e arritura kundër këtij fenomeni. 2008-2010” Dhuna me bazë gjinore si shprehje e pabarazive strukturore dhe tendencave sociale 225
27. Material studimor “Raport kombëtar i Projektit “Mbështetja për të drejtat e grave në Ballkanin Perëndimor” – 2006 – zbatuar nga 14 OJF shqiptare.
28. Milan Milutinovic, Kriminologjia, Prishtinë, 1982
29. Nisma për të Drejtat e Grave, USAID, Shqipëri, Krijimi i një skuadre për bashkërendimin e reagimit ndaj dhunës në familje në Shqipëri”, 2006.
30. Nuhiu, Armend: Udhëzues për fëmijë dhe prindër-ndëshkimi fizik i fëmijëve, Shkup 2016;
31. Ouaine Bain in Maureen Sanders, Ko pride na dan, Vodič za mlade ki so bili spolno zlorabljeni, Co Libri 1996
32. Praktični vodnik po sodnih in upravnih postopkih, Nasilje nad ženskami, Društvo za nenasilno komunikacijo, Ljubljana 2014
33. Pravilnik o obravnavanju nasilja v družini za vzgojno-izobraževalne zavode
34. Pravilnik o pravilih in postopkih pri obravnavanju nasilja v družini pri izvajanju zdravstvene dejavnosti

35. Pravilnik o prepovedi približevanja določenemu kraju oziroma osebi
36. Pravilnik o sodelovanju organov ter o delovanju centrov za socialno delo, multidisciplinarnih timov in regijskih služb pri obravnavi nasilja v družini
37. Pravilnik o sodelovanju policije z drugimi organi in organizacijami pri odkrivanju in preprečevanju nasilja v družini
38. Pravilnik o standardih in normativih socialnovarstvenih storitev
39. Procedurat Standarte të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë
40. Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2016
41. Ratkoceri V, 2012. -Mbrojtja ligjore dhe institucionale e viktimave të dhunës në familje – punim magistrature – Universiteti Shtetëror i Tetovës – Tetovë – RMV
42. Ratkoceri V, 2016 – Law regulation of domestic violence in Republic of Macedonia from independence until today, II. Türk Hukuk Tarihi Kongresi Bildirileri (2 Cilt - Takım), 617-625, link: https://cdn.istanbul.edu.tr/FileHandler2.ashx?f=law-regulation-of-domestic-violence-in-republic-of-macedonia-from-independence-until-today_vedije-ratkoceri.pdf
43. Tamo, A. dhe Karaj, Th., Dhuna kundër Fëmijëve në Shqipëri, Tiranë, 2005
44. Vasilika Hysi, Kriminologjia, Tiranë, 2014.
45. Vesel Latifi & Agron Beka, Vrasjet, Krimi I organizuar, Terrorizmi, Prishtinë, 2013
46. Vesel Latifi & Haki Demolli, Kriminalistika, Prishtinë, 2019
47. Vesel Latifi, Kriminalistika, Prishtinë, 2014
48. Zakon o brezplačni pravni pomoči
49. Zakon o kazenskem postopku s stvarnim kazalon Vida Jakulina
50. Zakon o naloga in pooblastil policije
51. Zakon o policiji
52. Zakon o pravdem postopku
53. Zakon o preprečevanju nasilja v družini, uvodna pojasnila Katja Filipčič
54. Zakon o varstvu osebnih podatkov
55. Zvonimir Sheparovic, Viktimologija i socijalna patologija, Zagreb, 1986